



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE.

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1

TIRANË

PRILL 2017

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 22/1, datë 09.01.2017.

Auditimi është kryer nga:

1. A. G., përgjegjës grupi
2. D. K., anëtar
3. B. Sh., anëtar
4. A. K., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 09.01.2017.

Auditimi ka përfunduar më datë 24.02.2017.

Periudha e auditimit 01.10.2014-31.12.2016.

Ky raport auditimi mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4100. 149. b), të INTOSAI, Pranuar dhe Sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, dhe strukturuar në “Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë”, botim i KLSH, 2013, Kreu II, Pika 9, 149 b), ii.



PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	3
Hyrje.....	12
Qëllimi dhe procesi i auditimit.....	13
Rezultatet e auditimit.....	14
I. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.....	14
II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	25
III. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar.....	30
IV. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve.....	44
V. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të shoqërisë.....	49
VI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, si dhe zbatimin e këtyre kontratave.....	61
VII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për prokurimet me vlerë të vogël.....	91
VIII. Mbi auditimin me zgjedhje të shpenzimeve të kryera me anë të arkës dhe bankës.....	92
IX. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave dhe arkëtimin e qirave për ambientet e dhëna me qira individëve dhe subjekteve.....	95
X. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	98
XI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.....	104
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	110



Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi shoqërinë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, me periudhë veprimtarie 01.10.2014 deri më datë 31.12.2016, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare. Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit, si dhe transparencja me publikun.

Gjatë viteve të fundit nga auditimi i jashtëm janë konstatuar shkelje, mangësi, parregullsi, veprime të cilat kanë sjellë dëme ekonomike për shoqërinë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë.

Objektivi kryesor për auditimin e shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, ka qenë auditimi i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore përkatëse.

Nga auditimi i kryer për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi, të cilat paraqiten si më poshtë:

I. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të plotë vënë në dispozicion të audituesve të KLSH-së, nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 43 masa organizative nga të cilat 28 janë realizuar, 12 janë në proces dhe 3 nuk janë realizuar, nga 9 masa zhdëmtimi nga të cilat 3 janë realizuar dhe 6 në proces realizimi, nga 4 masa administrative ku janë rekomanduar “Masa disiplinore”, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 3 punonjëse dhe “Vërejtje me shkrim”1 punonjëse, janë realizuar.

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimin e tyre.

-Nuk konstatohet mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu II, pika 6/a.

-Nuk konstatohet programi vjetor i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu III, pika 1.

-Nuk konstatohet mënyra e dërgimit të materialeve dhe raporteve që janë paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu III, pika 4.

-Nuk konstatohen deklaratimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi, në lidhje me pjesëmarrjen në këshill të parë ose të dytë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu V, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Kryetari dhe anëtarët e këshillave mbikëqyrës deklarohen vetë me shkrim në drejtorinë e shoqërisë për shpërblimin për pjesëmarrje në këshillin e parë apo të dytë”.

-Sipas procesverbalit të mbledhjes nr. 1548/1, datë 09.10.2014, konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendim dhe për kërkesës e shoqërisë “...”, për shtesë kontrate për “...”, në rezidencat 11-12, 24-25, 26-27, për problematikën e “...” në urën lidhëse me kollona të hapura anash dhe problematikën e objektit “...”, por këto çështje nuk janë zbardhur në Vendimin përkatës të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu III, pika 5.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Për çështjet e vendosura në Vendimet nr. 739/1 dhe 739/2, datë 13.09.2016, nuk konstatohet procesverbali i mbledhjes, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu III, pika 5.

-Në Vendimin nr. 992, datë 17.11.2016, për emërimin e znj. ... në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë dhe në Vendimin nr. 1092, datë 16.12.2016, për rinovimin e mandatit të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës nuk ka përcaktuar pagën e tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu IV, pika 2.

-Në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, nr. 27004, datë 08.09.2016, është miratuar dhe Statusi i ri i shoqërisë, i cili është i firmosur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Por në këtë vendim nuk është përmendur miratimi i statusit të ri të shoqërisë, ndërsa në paragrafin e fundit të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, nr. 27004, datë 08.09.2016, shprehimisht përcaktohet se: “*Asnjë vendim tjetër nuk u mor në Asambleshën e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila u mbyll në orën 10:00*”.

III. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar.

-Në hartimin e programit ekonomiko-financiar, Drejtoria e Planifikimit Financiar në llogaritjen e të ardhurave nga studentët nuk është bazuar në kapacitetet e plota të godinave duke rezultuar në disa raste me tejkalime mbi 100 %.

-Konstatohet se në vite numri i studentëve që që akomodohen në godina ka ardhur duke u ulur me pasoja zvogëlimin e të ardhurave të shoqërisë dhe thellimin e humbjeve.

IV. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve

-Me shkresën nr. 308/2, datë 03.02.2015 “*Mendim në lidhje me projektprogramet e zhvillimit të shoqërive anonime të “Trajtimin të Studentëve” për vitin 2015*”, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe shoqërisë “Rezenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, z. ... në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera citon se: “*Numri i punonjësve të parashikuar në shoqërinë tuaj, në raportin (1/15) nuk është konform Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003*”.

Me shkresën nr. 10033/1, datë 14.01.2016 “*Mendim në lidhje me projektprogramet e zhvillimit të shoqërive anonime të “Trajtimin të Studentëve” për vitin 2016*”, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe shoqërisë “Rezenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, z. ... në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera citon se: “*Në relacionin mbi parashikimin e projekt programit të vitit 2016 cilësoni se: “Struktura organike do të ndërtohet në funksion të qëllimit kryesor të veprimtarisë së shoqërisë, në shërbim të akomodimit dhe trajtimit të studentëve”, theksojmë se struktura organike duhet përcaktuar edhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 24.4.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimin të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”. Numri i punonjësve të parashikuar në shoqërinë tuaj, në raportin (1/15) nuk është konform Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003. Ruajtja e këtij raporti do të ndikonte në uljen e shpenzimeve për vitin 2016 në zërin “Shpenzime për paga”*”.

Por megjithëse në shkresat e sipërcituara, z. ... thekson se struktura organike e shoqërisë nuk është konform me Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003, në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës:

-Nr. 01, datë 26.01.2015, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, konfirmuar nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës datë 26.01.2015, ka miratuar numrin e punonjësve **403**, numër i cili është më i lartë se raporti i mësipërm (**1/12 për vitin 2015**).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Nr. 12, datë 07.12.2015, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, konfirmuar nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës datë 07.12.2015, ka miratuar numrin e punonjësve **404**, numër i cili është më i lartë se raporti i mësipërm (**1/13 për vitin 2016**).

Për këto veprime mban përgjegjësi z. ... në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës.

Nga krahasimi i numrit të strukturës organike të miratuar, me numrin e punonjësve sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”, sipas të cilit raporti punonjës/student duhet të jetë **jo më pak 1/15**, konstatohet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Nr Studentëve	Nr. i Studentëve i planifikuar	Numri i punonjësve sipas Udhëzimit të MAS	Numri i miratuar i punonjësve në Strukturë	Raporti faktik punonjës/student (a/c)	Diferenca (b-c)	Paga mesatare	Efekt Negativ (e*f*12 muaj)
		a	b	c	d	e	f	g
1	Viti 2015	4,747	316	403	12	-87	35,394	-36,951,336
2	Viti 2016	5,234	349	404	13	-55	36,227	-23,909,820
	Shuma					-142		-60,861,156

Për pasojë, vlera 60,861,156 lekë, që përbëhet nga shumëzimi i numrit të punonjësve mbi Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003, me pagën mesatare vjetore, **përbën efekt financiar negativ për llogari të shoqërisë RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit**. Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës z. ..., z. ... dhe znj. ..., si dhe znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, niveli i pagave konstatohet të jetë miratuar vetëm me vendime të Këshillit Mbikëqyrës, pa marrë më parë miratimin e Ministrit të MZHEHTS, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, germa a, e cila përcakton se: “1. Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës;”. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ..., ..., ..., ..., ... dhe

-Nga auditimi i zbatimit të strukturës organike, u konstatua se për muajt Dhjetor 2014, Janar, Shkurt dhe Prill 2015, numri mesatar i punonjësve është më i lartë se numri i miratuar me vendime të Këshillit Mbikëqyrës. Nga tejkalimi i strukturës organike, janë rënduar kostot e shoqërisë në vlerën **250,797 lekë**, vlerë e cila për shoqërinë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” Sha, Tiranë, përbën **efekt financiar negativ** për llogari të shoqërisë RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit. Për këtë veprim mban përgjegjësi znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.

-Për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, në RSU1 janë punësuar gjithsej 58 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme (dorëheqje, pension shkelje) 69 punonjësve. Për punonjësit e larguar, të cilët nuk kanë pranuar arsyet e largimit, u janë drejtuar gjykatave. Nga proceset gjyqësore të përfunduara për punonjësit të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës, deri më datë 31.12.2016, RSU1 ka paguar vlerën **63,950,316 lekë për 85 punonjës, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ llogari të shoqërisë**



RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit. Nga kjo vlerë, theksojmë se **vlera 4,346,207 lekë, përbëhet nga shpenzime përmbare, për arsye se punonjësit të cilët i fitojnë gjyqet kanë ndjekur përmbaremin për ekzekutimin e vendimit.**

Nëse e ndajmë vlerën e mësipërme sipas periudhave, konstatohet se:

-Vlera 3,587,018 lekë, është paguar për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, në favor të ish-drejtorit të përgjithshëm z. ..., i cili ka fituar gjyqin me Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 193, datë 02.03.2006, dhe pagesat vazhdojnë të kryhen rregullisht, deri në kohën e sistemimit në vendin e mëparshëm të punës.

-Vlera 3,078,986 lekë, përbën pagesën sipas vendimit të gjykatave për 4 ish-punonjës të larguar në periudhën 10.02.2013-20.09.2013. *Për këtë vlerë, mban përgjegjësi z. ... me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën deri më 20.09.2013.*

-Vlera 57,284,312 lekë, përbën pagesën sipas vendimit të gjykatave për 80 ish-punonjës të larguar në periudhën 16.10.2013-14.01.2015. *Për këtë vlerë, mban përgjegjësi znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.*

Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga RSU1 të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, konstatohet se pothuaj të gjithë vendimet janë në favor të punonjësve të larguar (*vetëm një në favor të shoqërisë*), duke cënuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomik-financiar, duke qenë se **vlera 63,950,316 lekë, e paguar si pasojë e vendimeve të gjykatave, përbën afërsisht 25% të të gjithë të ardhurave vjetore të shoqërisë (mesatares së viteve 2014-2016, pa përfshirë të ardhurat nga subvencionet).** Përveç vendimeve të formës së prerë, sipas informacioneve të marra nga drejtoria juridike e shoqërisë, konstatohet se janë edhe 3 proçese gjyqësore për dëmshpërblim page që po zhvillohen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe 8 çështje që po presin gjykimin në Gjykatën e Apelit, *çka në të ardhmen mund të shkaktojë rëndim të situatës financiare të shoqërisë.*

V. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të shoqërisë.

-Shërbimi kontabël në shoqëri, realizon regjistrimet e veprimeve kontabël në Excel, dhe jo me program kompjuterik financiar, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.

-Normat e amortizimit të përdorura nga shoqëria janë përcaktuar nga drejtimi në bazë të VKM Nr. 401, datë 23.10.1989 (i ndryshuar), pjesa "Për amortizimin e ndërtesave dhe instalimet e përgjithshme", ndërsa për të gjitha grupet e tjera të AQT-ve sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar) "Për tatimin mbi të ardhurat".

Për këto norma nuk ka një vendim të Këshillit Mbikëqyrës por janë të përfshira në informacionin që i dërgohet për aprovimin e programit ekonomik. Nëse drejtimi do të përdorte normat fiskale vlera e shpenzimeve të amortizimit do të ishte dy herë më e madhe se sa vlerat aktuale.

Mospërdorimi i normave fiskale ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë duke i ulur shpenzimet e shoqërisë me rreth 40,000,000 lek në vit dhe si rrjedhim rritjen e rezultatit. Përdorimi i këtyre normave ka sjellë një shtrembërim të zërave të aktiveve afatgjata.

-Nga auditimi konstatohet se shërbimi i ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi, është kryer me miratim Asambleja e Aksionarit pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

VI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, si dhe zbatimin e këtyre kontratave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozi” për administratën, viti 2016, KVO ka skualifikuar OE me ofertën më të ulët, me arsyetimin se punët e ngjashme nuk janë të njëjtës natyrë të kërkuar sipas DST, por nga auditimi u konstatua se ky operator e plotëson kriterin kualifikues së punëve të ngjashme, ku madje tejkalon në masë më të madhe se 40 % të përvojës së mëparshme përcaktuar, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 95,388 lekë**. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik” neni 46, pika 1. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga ..., .., Komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga ..., .., si dhe për mos-mbikqyrjen e kësaj procedure zv. Drejtori i Përgjithshëm z. ... dhe Drejtori i Përgjithshëm i RSU1 znj.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie”, Qershor 2015, kontraktori ... ka sjellë mallrat për 6 fatura në vlerë 331,320 lekë, ose në masën 15% të kontratës, pas datës së fundit të afatit të ekzekutimit të kontratës. Për pasojë AK, në zbatim të kontratës nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, neni 22 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”, duhet të llogariste dëme të likuiduara për vonesa në vlerën **416,539 lekë**, vlerë e cila përbën **dëm ekonomik** për llogari të RSU1 dhe Buxhetin e Shtetit. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të kolaudit, ..., .., ... dhe

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie”, Qershor 2015, në kontratën nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, konstatohet se afati i kësaj kontrate është 180 ditë nga momenti i lidhjes deri në momentin e dorëzimit të plotë. Por në dokumentet e tenderit (DT) të publikuara, kreu I “Njoftimi i kontratës”, pika 2.3 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin”, përcaktohet se kohëzgjatja e kontratës do jetë 30 ditë, pra është zgjatur kohëzgjatja e kontratës me 150 ditë (5 muaj) më tepër. Zgjatja e afatit të kontratës me 150 ditë (5 muaj), e kryer në mënyrë të paargumentuar, duke shkelur kështu barazinë midis operatorëve ekonomikë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 59 dhe 60. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK znj.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19”, viti 2014, u konstatua se kolauidimi i punime punimeve është kryer nga OE “...” SHPK, e cila është e njëjta shoqëri që ka kryer hartimin e projektit për “Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19”, realizuar me “Blerje të vogël”. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12, i cili ndër të tjera përcakton se: *“Kolauidimi i objektit kryhet nga kolauidatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolauidim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë”*. Shkelja e dispozitës ligjore ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm të RSU1 znj.

-Në të gjitha rastet (10 raste), nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen procedurës së prokurimit, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56.

-Në 3 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në lidhje me procedurat e tenderit të zhvilluara, nuk janë kryera pagesa për llogari të furnitorëve, për arsye të vështirësive ekonomike që ka AK, specifikuar kjo dhe në pikën 18.1 të kontratës. Por lidhja e kontratës pa patur në dispozicion fondet për këtë kontratë, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se: *“Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor”*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Në 2 raste, në procedurat e zhvilluara, është përcaktuar afati i zbatimit të kontratës 180 ditë. Nga njësia e prokurimit nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së një afati kaq të gjatë (6 muaj) të zbatimit të kontratës, në rastin kur kemi të bëjmë me blerje mallrash, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi i dytë. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

-Në 7 raste, kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK znj.

-Në 7 raste, në urdhrin e titullarit të AK për ngritjen e KVO, është vendosur që zv. Drejtori i Përgjithshëm të mbikqyrë procedurat e prokurimit, kur një detyrë e tillë nuk parashikohet në RrPP, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK znj.

....

-Në 5 raste, KVO nuk ka në përbërje ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 58. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK znj.

-Në 3 raste, AK nuk ka analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurës së anuluar, përpara nisjes së procedurës së re, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 2.

-Në një rast, AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar arsyen e përzgjedhjes së OE të ftuar në procedurën me negociim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 36, pika 4.

-Në 3 raste, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe ai i gjendur në dosjen e prokurimit, nuk konstatohet dokumentacion mbi marrjen dhe dorëzimin e mostrave të kërkuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 22 “Format e komunikimit”.

-Në 3 raste, nga auditimi i procedurave elektronike, konstatohet se “Dorëzimi i ofertave” nuk është mbyllur në datën e fundit të dorëzimit të ofertave, por 2 deri në 11 ditë me vonesë, duke e lënë të hapur mundësinë për dorëzimin e ofertave të tjera pas datës së fundit. Veprim në kundërshtim me “Manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për KVO”, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

-Në procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2016, njoftimi i anulimit është kryer nga anëtari i njësisë së prokurimit ..., pa marrë më parë miratimin e titullarit të AK dhe pa marrë më parë konfirmimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, i cili është i ngarkuar ligjërisht me procesin e vlerësimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pikat 3 dhe 4.

VII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për prokurimet me vlerë të vogël.

-Nga anëtarët e komisionit të prokurimit për blerjet me vlera të vogla nuk janë zbatuar në disa raste nuk është zbatuar Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”.

VIII. Mbi auditimin me zgjedhje të shpenzimeve të kryera me anë të arkës dhe bankës.

-Nga dokumentacioni i arkës, që ju vu në dispozicion grupit të auditimit vihet re një numër i madh veprimesh nëpërmjet arkës me lekë në dorë, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 62-65.

-Janë bërë pagesa për penaltitetet për deklarim, pagesë të vonuar të Sigurimeve Shoqërore në bankën BKT me datë 04.09.2015, në vlerën **4,120,215 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

financiar negativ për shoqërinë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

-Nga faqja on-line e Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1 Tiranë, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, dolën gjoba të regjistruara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në vlerën 330,000 lekë, gjoba të regjistruara për Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi në vlerën 3,400,640 lekë dhe interes i regjistruar në vlerën 526,757 lekë. Në total është vlera **4,257,397 lekë** gjoba dhe interes për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe për Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

IX. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave dhe arkëtimin e qirave për ambientet e dhëna me qira individëve dhe subjekteve.

Nga territori i përgjithshëm prej 248,435 m² në pronësi të RSU1, nga ZVRPP-ja i janë hequr 75,657 m² dhe nuk janë regjistruar në pronësi të saj. Sipas ZVRPP-së ky territor ishte i regjistruar më përpara në pronësi të subjekteve private me vendime gjykate, ALUIZNI apo KKP-së (Komisionit Kthimit Pronave).

Nëse heqim dhe sipërfaqen 1,315.3 m², godinë kjo që kishte në funksionin e saj ambjente kulturore (ish-kinoklubi), ambjente studimi, sallë kinemaje dhe me Vendim nr. 921 dt. 28.12.2010 të Ministrisë së Ekonomisë kaloi në administrimin e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, për fakultet të Drejtësisë, atëherë **sipërfaqja totale që shoqëria RSU1 ka humbur deri më 31.12.2016, është 74,341.7 m².**

Duke e llogaritur me vlerën që ka pasur në për metër katror në bazë të të çmimit mesatar për dy zonat kadastrale zk 8160 dhe zk 8190, të miratuara me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, **vlera e truallit që ka ngelur jashtë pronës së shoqërisë është 3,743,996,695 lekë** (74,341.7 m² x 50,362 lekë/m²), **e cila është vlera e humbur nga kapitali i shoqërisë.**

Ky territor është i zënë nga ndërtime informale përpara viteve 2000 si dhe një pjesë e tij është i lirë por i regjistruar në pronësi të ish pronarëve.

Në këtë vlerë, përfshihet dhe sipërfaqja e legalizuar, për të cilën shoqëria nuk dispononte statistika mbi saktësinë e kësaj vlere. Legalizimi i pronave në sipërfaqen e RSU1, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 39 dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, kreu II, pika 2, gërma c, të cilat përjashtojnë legalizimin në brenda vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike (institucione shtetërore, shkolla e kopshte publike, spitale, qendra shëndetësore publike, kampuse studentore).

X. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Tiranë, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

-nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

-nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

-Nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

-nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

-në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit. Në shoqërinë Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Tiranë, shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike.

-sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

XI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.

-Për të ardhura që realizohen nga dhënia me qira e ambienteve për të tretët, si edhe nga akomodimi i studentëve, edhe pse RSU1 është një shoqëri anonime, nuk aplikon fatura tatimore për shërbimet që kryhen, megjithëse është lënë detyrë dhe nga auditimet e mëparshme të KLSH-së. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 46, nenin 49 dhe nenin 54.

Në zbatim të Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 22/2, datë 13.02.2017, protokolluar në DRTT me nr. 8445, datë 15.02.2017, grupi i auditimit verifikoi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) më datë 15.02.2017, dokumentacionin dhe statusin e shoqërisë. Nga verifikimi i kryer në DRTT, sipas Aktverifikimit nr. 1, datë 17.02.2017, protokolluar në DRTT me nr. 8445/1, datë 17.02.2017, u konstatua se:

-Kërkesa për regjistrim nr. 311, datë 31.03.2015, që shoqëria RSU1 kishte dërguar në DRTT, nuk gjendej në protokollin e shoqërisë për periudhën 31.01.2015-07.04.2015.

-Në dosjen e subjektit ndodhur në arkivën e DRTT nuk u gjenden pasqyrat financiare të shoqërisë, megjithëse vërtetuar nga libri i protokollit të RSU1, pasqyrat financiare ishin dorëzuar dorazi në DRTT, firmosur dhe nga përfaqësuesi i DRTT

-Në sistemin elektronik të tatimeve, konstatohet se shoqëria RSU1 është e regjistruar me kodin 7511 “Aktivitete të administrimit publik”, në kundërshtim me statusin dhe fushën e veprimtarisë së kësaj shoqëria (e cila vepron në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

-Sipas të dhënave të sistemit C@TS, nuk rezultojnë të deklaruara online pasqyrat financiare të viteve 2014 dhe 2015.

-Sipas sistemit elektronik të tatimeve, shoqëria është e regjistruar për përgjegjësinë tatimore: “2200, Tatim mbi të ardhurat nga Punësimi”, “2100, Kontribute shoqërore”, “1900, Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” dhe “1500, Tatim i mbajtur në burim”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Shoqëria nuk është e regjistruar për përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi vlerën e shtuar dhe Tatimit mbi fitimin.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”.

Për këtë gjetje, grupi i auditimit do rekomandonte që Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Financiar, të marrin masa për regjistrimin e shoqërisë pranë organeve tatimore, në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 40 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”. Në zbatim të shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) nr. 13530/42, datë 03.04.2017 “Njoftim për aktivizimin e TVSH dhe Tatim Fitimit”, protokolluar në RSU1 me nr. 213, datë 07.04.2017, DRTT njofton shoqërinë RSU1 që duke filluar nga periudha Mars 2017, janë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore TVSH dhe Tatim Fitimi. Në zbatim të kësaj shkrese, rekomandimi i lënë në Projektraportin e Auditimit nga KLSH, quhet i ezauruar.

-Në lidhje me të ardhurat që krijohen nga akomodimi i studentëve, shoqëria i kategorizon këto të ardhura, si të ardhura nga qiraja. Konkretisht, shoqëria ka lidhur me studentët “Kontrata Akomodimi”, por në bazën ligjore të këtyre kontratave përmend nenet 801, 802 të Kodit Civil, nene që i përkasin Kreut VI “Qiraja”. Por përdorimi i këtyre dispozitave është i gabuar, për arsye se:

-Sipas ekstraktit historik dhe statusit të shoqërisë, objekti i veprimtarisë është “*Trajtimi në fjetore dhe menca i studentëve të Universitetit Tiranë*”, pra kemi të bëjmë me shërbimin e hotelarisë.

-Shoqëria përveç trajtimit në godina, studentëve u ofron dhe shërbime të tjera të sanksionuara dhe në objektin e veprimtarisë dhe statusin e saj, si “*Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambjente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentet. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qera të ambjenteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.*”.

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, SHA, Tiranë, në observacionet e dërguara me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, për efekte të detyrimit të tatimit të vlerës së shtuar (TVSH), pretendon se zbaton Udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “*Qendrat e trajtimit të studentëve që subvencionohen me fonde shtetërore, të cilat funksionojnë posaçërisht për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të studentëve konviktet ose mensat, shërbimi i fjetjes dhe i mensës kur i ofrohet studentëve ose nxënësve është i përjashtuar nga TVSH-ja, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor. Këto qendra duhet të vërtetojnë në çdo rast që shërbimi që ato ofrojnë i është ofruar studentëve dhe jo të tretëve, me rekomandim të universitetit publik. Përndryshe shërbimi i kryer prej tyre është i tatueshëm me TVSH.*”. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, të ardhurat që shoqëria përfiton nga akomodimi i studentëve janë të përjashtuara nga detyrimi për TVSH, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor, ndërsa shërbimi i akomodimit të familjarëve është i tatueshëm me TVSH, **e për të duhet të llogaritet detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)**. Për sa më sipër, shoqëria për vitet 2014, 2015 dhe 2016, edhe pse ka gjeneruar të ardhura nga shërbimet e tatueshme në vlerën 64,994,900 lekë, por për këto të ardhura **nuk ka paguar detyrimin e**



TVSH në vlerën 10,832,483 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ për të ardhurat e Buxhetin e Shtetit.

Gjithashtu, për periudhën 2014-2016, konstatohet se **nuk është zbritur TVSH e rimbursueshme në përpjestim me të ardhurat e realizuara**, për blerjet dhe furnizimet që shoqëria ka kryer për periudhën 01.10.2014-31.12.2016.

-Në lidhje me familjarët e 4 godinave të zëna, shoqëria nuk ka ndjekur përfitimin nga ana e këtyre personave të statusit “Të pastrehë”, që këto persona të përfitojnë strehimin në banesat sociale të ofruara nga Bashkia Tiranë, me qëllim lirim të godinave për studentët.

HYRJE

Ky auditim ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë për periudhën 01.10.2014 deri më datë 31.12.2016. Ky auditim ka marrë në analizë dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje, sipas rastit dhe problematikës së evidentuar gjatë auditimit. Grupi i auditimit është përpjekur në kryerjen e një auditimi të plotë dhe të gjithanshëm të aktivitetit të shoqërisë për këtë periudhë.

Auditimi u realizua në përputhje me: Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”; VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë.

Në këtë auditim është analizuar: Realizimi i rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm; Zbatimi i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre; Hartimi, shqyrtimi, miratimi dhe zbatimi i programit ekonomiko-financiar; Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve; Zbatimi i dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të shoqërisë; Zbatimi i dispozitave ligjore në prokurimet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, si dhe zbatimin e këtyre kontratave; Zbatimi i dispozitave ligjore për prokurimet me vlerë të vogël; Auditimin me zgjedhje të shpenzimeve të kryera me anë të arkës dhe bankës; Zbatimi i dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave dhe arkëtimin e qirave për ambientet e dhëna me qira individëve dhe subjekteve; Zbatimi i ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit; Zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.

Qëllimi dhe procesi i auditimit

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese kanë qenë;



Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin e riskut dhe proceseve të drejtimit;

a. Jep siguri të arsyeshme nëse:

-informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;

-burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;

b.Dhënia e rekomandimeve dhe të kërkesave për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë.

Gjetjet kryesore: Nga auditimi i kryer për zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje që ju vu në dispozicion grupit të auditimit, janë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë. Gjetjet kryesore të konstatuara nga ky auditim lidhen kryesisht me:

-organizimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës,

-plotësimin e pasqyrave financiare (bilancit),

-në pagesat e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës,

- në marrëdhëniet e punës,

-në prokurimin e fondeve dhe zbatimin e kontratave,

-në organizimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit,

-në zbatimin e legjislacionit tatimor.

Parregullsitë, dobësitë dhe shkeljet e vërejtura, tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon të përmirësohet. Në lidhje me këtë, rekomandimi i përgjithshëm për Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin e Përgjithshëm, është që të forcojnë nivelin e menaxhimit, duke pasur objektiv menaxhimin me efektivitetet në funksion të rritjes së fitimit dhe zbatimin e politikave afatgjatë në fushën e përkatëse.

Kriteret e vlerësimit. Në vlerësimin e mekanizmave të kontrollit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve, të cilat mund të ndodhin;

-procedurat e mekanizmave të kontrollit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;

-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të kontrollit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë.

-shpërndarja në kohë dhe intensiteti i gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet, duke përfshirë testimet dhe procedurat që u mendua se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, në përputhje me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

Rezultatet e auditimit

I. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm



Nga auditimi u konstatua se:

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjendja e masave të rekomanduara nga auditimi i mëparshëm është si vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit të plotë vënë në dispozicion të audituesve të KLSH-së, nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 43 (dyzet e tre) masa organizative nga të cilat 28 janë realizuar, 12 janë në proces dhe 3 nuk janë realizuar, nga 9 (nëntë) masa zhdëmtimi nga të cilat 3 janë realizuar dhe 6 në proces realizimi, nga 4 masa administrative ku janë rekomanduar “Masa disiplinore“, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 3 (tre) punonjëse dhe “Vërejtje me shkrim” 1 punonjëse, janë realizuar.

Në vijim u konstatua se me shkresën nr.688/14, datë 15.12.2014, KLSH pas auditimit të kryer për shkëlqet dhe mangësitë e konstatuar ka dërguar Raportin Përfundimtar të auditimit me rekomandimet përkatëse për zbatimin e masave për përmirësimin e gjendjes. Me shkresën nr. 2141, datë 05.01.2015, RSU Nr.1, ka dërguar informacionin në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Drejtorja e Përgjithshme e RSU Nr.1, ka shqyrtuar Raportin e Auditimit me rekomandimet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe e ka paraqitur në Këshillin Drejtues.

a. Janë rekomanduar 43 masa organizative përkatësisht:

a.1. Në lidhje me rekomandimin që, Këshilli drejtues dhe stafi i EKB të marrë masa dhe të sigurojë performancë ekonomike dhe financiare të qëndrueshme, duke marrë masa për të realizuar të ardhurat nga aktiviteti kryesor i saj (financimi, ndërtimi, administrimi dhe shitja e banesave), krahas të ardhurave nga aktivitete të tjera, duke shmangur ndryshimet e programeve ekonomike në fund të vitit për të justifikuar mosrealizimet e disa treguesve apo tejkalimet në zëra të shpenzimeve, si dhe të kryejë analiza të detajuara dhe periodike mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke evidentuar personat përgjegjës dhe propozuar masat për të përmirësuar situatën në të ardhmen.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Këshilli Drejtues i EKB-së me vendimin nr. 14, protokolluar me nr. 3760/1, datë 11.10.2013, pika 2, i ka lënë detyrë Drejtorit të Përgjithshëm të marrë masa për këtë pikë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.2. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të miratuar një rregullore të brendshme, ku të përcaktohet që lidhja e kontratës ndërmjet kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtores së Përgjithshëm, si dhe mbledhjet në Këshillin Mbikëqyrës të jenë të protokolluar dhe procesverbalet të jenë të nënshkruara nga mbajtësja e protokollit të këshillit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rregullorja e brendshme e Shoqërisë është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 04.08.2014. Është lidhur kontrata ndërmjet Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, me nr.prot 2127, datë 30.12.2014 dhe kontrata nr.prot 578, datë 28.12.2015.

Kjo detyrë është realizuar.

a.3. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të zbatuar procedurat e largimit nga puna të punonjësve në zbatim të Kodit të Punës, duke ndjekur me përgjegjësi afatet të përcaktuara sipas shkallëve të gjyqësorit, për paditë gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi është në proces realizimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalin e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve.

a.4. Në lidhje me rekomandimin që, departamenti ekonomik i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për të përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin Mbikëqyrës, projektbuxhetin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

ekonomik të shoqërisë dhe të dërgojë për miratimin në MZHETS dhe në MAS, brenda afateve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 315, datë 8.04.2009.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Në zbatim të Udhëzimit nr.394, datë 21.08.2014 të Ministrit të MZHETS, projektbuxheti 2015, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikqyrës me shkresë nr.prot 1704, datë 30.10.2014 dhe është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës me Vendim nr.21, datë 27.11.2014. Me shkresë nr.prot 1984, datë 27.11.2014 është dërguar për miratim në MZHETS dhe MAS. Projektbuxheti 2016, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikqyrës me shkresë nr.prot 1267, datë 09.11.2015 dhe është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës me Vendim nr.11, datë 13.11.2015. Me shkresë nr.prot 1371, datë 20.11.2015 është dërguar për miratim në MZHETS dhe MAS.

Kjo detyrë është realizuar.

a.5. Në lidhje me rekomandimin që, Departamenti i Bujtinave në bashkëpunim me departamentin ekonomike, të marrin masa për të përgatitur një databaze mbi inventarin e kapacitetin maksimal të dhomave që janë të disponueshme për çdo vit akademik, të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i shoqërisë, me qëllim administrimin e drejtë të tyre, dhe mënjanimin e përdorimit abuziv të dhomave nga administratorët e godinave.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Në bazë të urdhërit nr.316, datë 18.09.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve Studentore, ka përgatitur informacionin, i cili është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm me shkresë nr.prot 98, datë 13.10.2014 ku në bazë të monitorimit të kryer në secilën Rezidencë, është përcaktuar edhe numri i total i dhomave dhe numri i përgjithshëm i studentëve për të cilën Qyteti Studenti është në gjendje të akomodojë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.6. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria e shoqërisë të marrë masa për të aplikuar tarifën për akomodimin e hotelit në godinën 13, të jenë të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Tarifat për rezidencën nr.13 janë të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës me Vendim nr.4, datë 31.01.2013.

Kjo detyrë është realizuar.

a.7. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria e shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për çdo ndryshim në programet ekonomike, qoftë për hapjen apo mbylljen e aktiviteteve të shoqërisë dhe për lidhjen e kontratave për qiratë e objekteve gjatë vitit, të bëhen me miratim nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë, nga MZHETS dhe nga MAS.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Nuk ka pasur ndryshime në programin ekonomik. Për periudhën 2014-2016, të gjitha kontratat për ambjentet e dhëna me qira të tretëve, janë të shoqëruara me vendime të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë. Për aktivitetin “Parkim të makinave”, është miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë me vendim nr. 10 datë, 13.11.2015, ku janë miratuar edhe tarifën përkatëse.

Kjo detyrë është realizuar.

a.8. Në lidhje me rekomandimin që, Këshilli Mbikqyrës dhe organet drejtuese të shoqërisë të marrin masa për të analizuar realizimin e shpenzimeve të shoqërisë, për gjetjen e rrugëve për uljen e zërave të shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, me qëllim për uljen e humbjes nga aktiviteti i shoqërisë. Për këtë organet drejtuese të shoqërisë duhet të paraqesin kërkesa të argumentuara në MZHETS dhe MAS, për rritjen e subvencionit, për të përballuar ndikimin e rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe ujit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Për periudhën 2014-2016, si rrjedhojë e masave të marra, treguesit e shpenzimeve në raport



me periudhat paraardhëse janë në zbritje. Në rezidencat familjare janë instaluar matësat elektrik për çdo dhomë si dhe janë bërë ndryshime në kontratën e qiradhënjes së lidhur me të gjithë familjarët, ku detyrimet për shpenzimet e energjisë elektrike të konsumuar në këto rezidenca paguhen nga vetë familjarët. Shoqëria ka lidhur marrëveshjen (nga muaj Dhjetor 2016) me shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime, Sh.a. Tiranë për të klasifikuar ujin e harxhuar nga këto rezidenca si “kosumator familjar” me tarifë të përgjithshme 56 lekë/m³ nga 170 lekë/m³ që tarifohej si “ent privat”. Në projekt buxhetet e viteve 2015 dhe 2016, janë kërkuar në mënyrë të argumentuar nga MZHETS dhe MAS, rritjen e subvencionit por nuk janë marrë parasysh nga këto institucione.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

a.9. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria të marrë masa në të ardhmen për çdo ndryshim në numrin mesatar të punonjësve dhe në rritjen ose uljen e pagës mesatare, të bëhen vetëm me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, MZHETS dhe MAS, në përputhje me përcaktimet e bëra në statutin e shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Numri mesatar i punonjësve, është miratuar nga Këshillit Mbikëqyrës me vendim nr. 3, datë 14.11.2013, i cili nuk ka ndryshuar. Paga mesatare është në përputhje me atë të përcaktuar në programet ekonomike të miratuar konkretisht për vitin 2015 programuar 36 600 lekë dhe realizuar 35 544 lekë dhe për vitin 2016, është programuar 36 393 lekë dhe realizuar 35 911 lekë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.10. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të marrin masa për të bashkëpunuar me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Palujtshme në Tiranë, për të ndjekur dhe përfunduar procesin e regjistrimit të pasurisë së palujtshme të shoqërisë, dhe rivlerësimin e tyre në Bashkinë e Tiranës.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Një pjesë e pasurisë së palujtshme është regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Palujtshme, procesi ka qenë periodik i cili ka përfunduar në muajin Shtator 2015, ku objektet si dhe trualli në territorin e Qytetit Studenti është pajisur me çertifikatën përkatëse të pronësisë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.11. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, të marrin masa për të bërë një planifikim sa më të studiuar të aktiviteteve që do të kryhen gjatë vitit, me qëllim që të parashikohen dhe të miratohen zërat e shpenzimeve sipas aktiviteteve në programin ekonomik në fillim të çdo viti akademik.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Gjatë periudhës 2015-2016, nuk janë programuar dhe nuk janë kryer shpenzime për aktivitete kulturore. Ndërsa shpenzimet për akomodimin e studentëve janë parashikuar në buxhetet vjetore të viteve respektive.

Kjo detyrë është realizuar.

a.12. Në lidhje me rekomandimin që, Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë dhe drejtoria, të kërkojnë zgjidhjen e menjëhershme ligjore në MZHETS dhe të vazhdojnë të insistojnë në MAS, për të parashikuar fonde nga buxheti i shtetit për të përballuar detyrimin e trashëguar ndër vite për z. ..., me detyrë ish-drejtor, i cili i ka kushtuar shoqërisë me pagesa të barabarta me pagën mujore sa për dy drejtorë të përgjithshëm.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shoqëria është në proces gjyqësor me z..... Ka përfunduar gjykimi në shkallën e parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktualisht çështja po trajtohet në Gjykatën e Apelit.

a.13. Në lidhje me rekomandimin që, drejtoria e shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës, të marrin në analizë punën që kryhet nga departamenti i bujtinave, mbi administrimin e objekteve me



qera nga familjarët, me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe marrjen e masave organizative për të detyruar debitorët të arkëtojnë qiratë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Janë marrë masa nga ana e shoqërisë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga familjarët debitorë. Nuk është realizuar 100%, pasi gjendja e debisë ka qenë shumë e madhe si dhe familjarët që banojnë që nga viti 1992, janë me probleme të theksuara sociale.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

a.14. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare nr.1, SHA, Tiranë, të marrë masat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me miratim të MZHETS dhe MAS, për të aplikuar fatura tatimore me TVSH, për arkëtimin e të ardhurave për akomodimin e studentëve në godinat nën administrim të shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Ky rekomandim nuk është zbatuar. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalin mbi “Zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve”.

a.15. Në lidhje me rekomandimin që, drejtori i përgjithshëm i shoqërisë të marrë masa në të ardhmen për kontratat që do lidh me ekspertët kontabël që do të auditojnë llogaritë kontabël, të përcaktojnë modalitete në lidhje me përgjegjësitë e ekspertëve nëse konstatohen mangësi pas certifikimit të bilancit nga ana e tyre, dhe në përfundim të punës të dorëzojnë një raport të gjatë financiar mbi gjendjet e llogarive kontabël dhe pasqyrat financiare. PAGESA E TYRE TË BËHET PASI TË JETË DOKUMENTUAR PRODUKTI I PUNËS PËR TË CILËN JANË KONTRAKTUAR.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Në kontratat e lidhura me ekspertët kontabël për certifikimin e bilanceve për vitin 2014 dhe 2015, janë përcaktuar se ekspertët janë përgjegjës për mos përmbushjen e funksioneve të tyre.
Kjo detyrë është realizuar.

a.16. Për sa i takon pagesave të ekspertëve për vitin 2013, nga ana e shoqërisë të merren masa që të kryhen veprimet e pagesave pasi ekspertët të dorëzojnë një raport të gjatë financiar për certifikimin e llogarive kontabël për vitin ushtrimor 2013.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Në lidhje me pagesat për ekspertët që kanë audituar llogaritë kontabël për vitin 2013, ato janë kryer pasi kanë dorëzuar raportin e detajuar financiar.

Kjo detyrë është realizuar.

a.17. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të llogarisë provizione për llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra, “Klient për mallra, produkte e shërbime”, në shumën 3,343,014 lekë, për të cilët është i pamundur arkëtimi i tyre për arsye se me urdhër të MZHETS, janë ndërprerë kontratat me familjarët për objektet me qera.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimet janë reflektuar në bilancin për vitin 2014.

Kjo detyrë është realizuar.

a.18. Në lidhje me rekomandimin që, departamenti ekonomik i shoqërisë, të bëjë regjistrimin në llogaritë kontabël me veprime sistemimi për vlerën e projektit dhe pasqyrimin e vlerës fillestare në shumën 1,616,610 lekë si llogari jashtë bilancit, në mënyrë që të mos aplikohet norma e amortizimit, për periudhën derisa të fillojë zbatimi i investimit të parashikuar sipas këtij projekti.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimet janë reflektuar në bilancin për vitin 2014.

Kjo detyrë është realizuar.

a.19. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për të analizuar në Këshillin Mbikëqyrës, menaxhimin e mjeteve monetare të shoqërisë, me qëllim që të mos mbahen



gjendje mjetet monetare në llogaritë bankare por ti jepet prioritet likuidimit të detyrimeve të shoqërisë ndaj furnitorëve për shërbimet ose mallrat e blera.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shumat janë parapagime (pagesat e studentëve në muajn Tetor), dhe shërbejnë për të mbuluar shpenzimet në vazhdim të vitit ushtrimor.

a.20. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të llogarisë provizione për llogaritë aktive “Të pagueshme ndaj punonjësve”, në shumën 192,222 lekë, për të cilat nuk ka mundësi likuidimi nga shoqëria, për arsye se punonjësit kanë shkëputur marrëdhëniet e punë nga kjo shoqëri.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimet janë reflektuar në bilancin për vitin 2014.

Kjo detyrë është realizuar.

a.21. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për të provizionuar detyrimet në shumën 2,362,579 lekë, përkatësisht: për detyrime të trashëguara nga vitit 2004, ndaj ISKSH në shumën 985,762 lekë; detyrime të trashëguara nga vitit 2004 në shumën 1,100,403 lekë, të papaguara ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore që nga vitit 2004; detyrimet në shumën 24,000 lekë, që përfaqëson detyrimet përmbartimore të trashëguara nga vitet të mëparshme ndaj një punonjëse; detyrimet në shumën 252,414 lekë që përfaqëson pagesat e lejeve të zakonshme për punonjësit që kanë shkëputur marrëdhëniet e punës për sasinë e ditëve për lejen e zakonshme, pas datës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimet janë reflektuar në bilancin për vitin 2014.

Kjo detyrë është realizuar.

a.22. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për të derdhur detyrimet ndaj shtetit në shumën 3,824,262 lekë, për kontratat shumëvjeçare të lidhura nga MZHETS për vitin 2012 dhe 2013, si dhe të llogarisë si provizione shumën 306,118 lekë, për një detyrim të shoqërisë të pa derdhur për tatimin e fitimit të pasurisë të trashëguara që para vitit 2004.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Është derdhur në buxhet shuma prej 3,824,262 lekë. Llogaritja si provizione të shumës 306,118 lekë, është kryer me mbylljen e bilancit për vitin 2014.

Kjo detyrë është realizuar.

a.23. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar detyrimin në shumën 1,991,995 lekë, diferencën nga detyrimi i pallogaritur për kontratat që ka lidhur shoqëria për vitin 2012, dhe në shumën 1,739,529 lekë, diferenca nga detyrimi i pallogaritur për kontratat që ka lidhur në vitin 2013, për objektet me qera, dhe të derdhë në buxhetin e shtetit, detyrimin në shumën 3,731,524 lekë, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.06.2011.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shuma është kontabilizuar në bilancin e vitit 2014. Nuk është derdhur në Buxhetin e Shtetit si pasojë e mungesës së likuiditeteve.

Kjo detyrë është realizuar.

a.24. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa të menjëhershme për të përlllogaritur vlerën e dëmit të shkaktuar nga studentët duke zbatuar procedurat ligjore për ndalesat e siguracioneve të studentëve dhe ndalesat nga financa e shoqërisë të bëhen me urdhër zhdëmtimet në përputhje me vlerën e dëmit të shkaktuar nga personat përgjegjës.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Për vitin akademik 2014-2015 dhe 2015-2016, studentët nuk kanë paguar tarifa në formë siguracioni, por vetëm tarifë fjetjeje. Gjatë kësaj periudhe nuk ka humbje të materialeve të cilët studentët i kanë tërhequr sipas “kartelës së marrjes në dorzim të materialeve” apo edhe të ambjenteve të përbashkëta.

Kjo detyrë është realizuar.



a.25. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për të zbatuar me përpikmëri procedurat e inventarizimit të asetëve të shoqërisë dhe të bëjë pasqyrimin e plotë të rezultateve të inventarit në kontabilitet.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Në inventarizimet e kryera për periudhën 2014-2016, janë zbatuar me përpikmëri detyrimet që lindin nga Udhezimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sektorit publik”.

Kjo detyrë është realizuar.

a.26. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të shfrytëzuar gjithë kapacitetet e dhomave që disponojnë për strehimin e studentëve, me qëllim realizimin e të ardhurave nga aktiviteti kryesor i shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shoqëria ka bërë përpjekje për rritjen e numrit të studentëve që strehohen duke marrë masa në krijimin e kushteve më të mira në ambjentet e banimit por edhe në krijimin e lehtësirave në mënyrën e pagesës periodike nga ana e studentëve. Megjithë masat e marra numri i studentëve të strehuar është në ulje.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

a.27. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për të zbatuar tarifat për strehimin e studentëve me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë me qëllim realizimin e të ardhurave të programuara nga akomodimi e studentëve.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Për periudhën 2014-2016, tarifat e aplikuara për regjistrimin e studentëve, janë ato të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.28. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për plotësimin e dosjeve të kontratave me dokumentacionin përkatës ligjor, para nënshkrimit të kontratës me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim e shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Dokumentacionet për marrjen me qera të ambjenteve nga të tretët, janë plotësuar para se kërkesa për dhënie me qera të ambjentit të miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Kjo detyrë është realizuar.

a.29. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen për unifikimin e kontratave me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim të shoqërisë në lidhje me detyrimet kontraktuale të Ujësjiellës Kanalizime SHA dhe me CEZ Shpërndarje.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Subjektet që kanë lidhur kontratë qeraje me Shoqërinë, kanë paraqitur kontratat me shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime, Tiranë dhe OSHEE-n.

Kjo detyrë është realizuar.

a.30. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa në të ardhmen të monitorojë kontratat e qirasë ose enfiteozë, si dhe të mbajë dokumentacionin përkatës të dhënies dhe marrjes në dorëzim, duke ndjekur në vijimësi respektimin e kushteve të kontratës me subjektet të cilat do të marrin me qira hapësira nën administrim të shoqërisë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhërin për ngritjen e komisionit i cili ka kryer monitorimin e kontratave e qirave ose enfiteozës.

Kjo detyrë është realizuar.

a.31. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për procedurat e prokurimit “Negocim pa botim paraprak”(20%), Shtesë Kontrate, të realizohen në mbështetje të bazës ligjore Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, neni 33, Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, pika 5/a dhe VKM-në Nr. 1, datë 10.01.2007



“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, kreu IV pika 5, duke realizuar më parë argumentimet në përputhje të dokumentacioneve ligjore, administrative dhe teknike.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Nuk është kryer asnjë prokurim me procedurë “Negocim pa botim paraprak”.

Kjo detyrë është realizuar.

a.32. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e lejeve zhvillimore e ligjshmërisë për të gjitha investimet që do të realizohen, qofshin ndërtime të reja apo rikonstruksione të ndërtimeve ekzistuese.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Gjatë periudhës 2015-2016, nuk është kryer asnjë investim i ri apo rikonstruksion i ndërtimeve ekzistuese.

Kjo detyrë është realizuar.

a.33. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për përcaktimin e anëtarëve të KVO-së, në plotësim të pikës 2/ç “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Për prokurimet e kryera janë angazhuar specialistët të fushës, të cilët janë alternuar në komisione sipas natyrës së prokurimit të kryer.

Kjo detyrë është realizuar.

a.34. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa që nga ana e KVO-ve të vlerësohen kriteret e kualifikim të pranimit të operatorëve ekonomikë në bazë të pikës 2, të nenin 44, me gërmën ç, të nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me piken 2, të Kreut VII, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.35. Në lidhje me rekomandimin që, Autoritetit Kontraktor të marrë masa, që të bëjë përlllogaritjen e argumentuar të fondit limit nga një grup pune i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me Njësinë e Hartimit të Dokumenteve, në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM-në Nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu II, pika 2,ç.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.36. Në lidhje me rekomandimin që, Autoritetit Kontraktor të marrë masa për çdo rast përcaktimi i drejtuesve teknik në ndjekjen e punimeve të mos bëhen me Urdhëra nga Titullari i institucionit, por në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.37. Në lidhje me rekomandimin që nga ana e Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të caktohen personat apo grup personash për ndjekjen e realizimit të kontratave të lidhura, për të bërë të mundur realizimin e tyre dhe garantimin e cilësisë së punimeve. si dhe për çdo rast të hartohen raporte përmbledhës ku të shprehet mbi ecurinë e monitorimit dhe zbatimit të kontratës.



Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Për çdo kontratë të lidhur për furnizim apo shërbim, janë ngritur komisionet përkatëse për verifikimin për përmbushjen në sasi dhe cilësi të detyrimeve kontraktuale nga operatorët ekonomik fitues në prokurimet e kryera në institucion.

Kjo detyrë është realizuar.

a.38. Në lidhje me rekomandimin që, në çdo rast nga Autoriteti Kontraktor, në kushtet e rinisjes së një procedure të anuluar prokurimi, të nxirret Urdhër Prokurimi sipas dhe në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi është realizuar. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.39. Në lidhje me rekomandimin që, Njësia e Hartimit të Dokumentave të vendosen kritereve të veçanta për kualifikim të operatorëve ekonomik, duke patur parasysh natyrën e tenderit që do të zhvillohet.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.40. Në lidhje me rekomandimin që, Autoriteti Kontraktor për të gjitha rastet e anulimit të procedurave të prokurimit, duhet të analizojë arsyet dhe shkaqet që kanë çuar në anulim, sipas VKM nr.1, datë 10.01.2007, kreu VII, pika 1/b.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi nuk është realizuar. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.41. Në lidhje me rekomandimin që, Komisioni Vlerësimit të Ofertave dhe Komisioni Hartimit të Dokumentave të merrin masa në të ardhmen për të verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomik konform ligjeve dhe akteve ligjorë të dala për to. Gjithashtu, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të konfirmohet, që bilancet kontabël me raportet e eksperët kontabël, të jenë të njëjta me ato të dorëzuara në tatime nga Operatorët Ekonomik pjesmarrës në tendera.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Kjo detyrë është në zbatim. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.42. Në lidhje me rekomandimin që, Trajtimi i Studentëve Nr. 1 SHA, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të forcojë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit, konkretisht në parashikimin e nevojës për prokurim, kërkesë për prokurim dhe miratimi i saj; hartimi dhe miratimi i urdhrat për zgjedhjen e procedurës së prokurimit, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimeve teknike; përgatitja, miratimi dhe hedhja në sistem e dokumenteve të tenderit; ngritja e komisionit dhe vlerësimi i ofertave; miratimi i raportit narrativ përmbledhës; njoftimi i ofertës fituese; përgatitja, miratimi, nënshkrimi i kontratës dhe pagesa e sigurimit të saj, mbikëqyrja e zbatimit të kontratës, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimi i transaksioneve dhe zbatimi i detyrimeve kontraktuale.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

a.43. Në lidhje me rekomandimin që, Trajtimi i Studentëve Nr. 1 SHA, të marrë masat që me përfundimin e procedurave të prokurimit, të kryhen inventarizimi i brendshëm i dosjeve, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3, e 29, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.



Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Rekomandimi në proces zbatimi. Trajtuar më gjerësisht në procesverbalet dhe aktverifikimet e auditimit të procedurave të prokurimit.

B. Masa zhdëmtimi

b.1. Në lidhje me rekomandimin që, Shoqëria të marrë masa për arkëtimin e vlerës së dëmit në shumën 2,523,439 lekë, të shkaktuar nga ish administratori i T.S.Nr.1, SHA, z. ..., për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të T.S Nr.1, SHA.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shoqëria është në pritje të përfundimit të procesit të kallëzimit penal ndaj ish administratorit. *Kjo detyrë është realizuar.*

b.2. Në lidhje me rekomandimin që të merren masa nga NTS Nr.1 SHA, për të arkëtuar nga z. ..., në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, dëmin ekonomik në vlerën 1,735,324 lekë, për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të T.S Nr.1, SHA.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Shoqëria është në pritje të përfundimit të procesit të kallëzimit penal ndaj ish administratorit. *Kjo detyrë është realizuar.*

b.3. Në lidhje me rekomandimin që të merren masa nga NTS Nr.1, SHA, për të arkëtuar nga z. ..., në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm dhe zj. ..., me detyrë juriste në Departamentin e Burimeve Njërëzore dhe Juridike, dëmin ekonomik në vlerën 4,623,519 lekë, për mos ushtrim të kompetencave funksionale për menaxhimin e hapësirave nën administrim të T.S Nr.1, SHA, për ndërprerje të kontratës në mënyrë të njëanshme dhe për mungesën e përfaqësimit në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Zbatimi i këtij rekomandimi është në proces. *Me shkresë nr.prot 28, datë 14.01.2015, nga Drejtori i Përgjithshëm është marrë vendim nr.9, datë 14.01.2015, për shlyrjen e 50% të dëmit nga punonjësja e Shoqërisë zj. Ky vendim nuk është ekzekutuar pasi çështja ka kaluar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Ka mbaruar gjyqi në shkallën e parë të gjyqësorit. Aktualisht procesi po trajtohet në Gjykatën e Apelit.*

Kjo detyrë është realizuar.

b.4. Në lidhje me rekomandimin që, Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 111,971 lekë, të shkaktuar nga Kontraktori “...”, për vonesat të krijuara në zbatim të kontratës për objektin e prokurimit “Hidroizolim tarrace të godinave nr. 4, 12, 13 dhe të Bibliotekës së Qytetit Studenti.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Me subjektin “...”, janë mbajtur korespondenca të vazhdueshme për arkëtimin në mënyrë vullnetare të shumës, gjë e cila nuk është kryer nga ky subjekt. Për këtë arsye me shkresë nr.prot 387, datë 12.10.2016, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, është marrë vendim nr. 94, datë 12.10.2016, që nga shuma e përgjithshme që shoqëria detyrohet për likuidim subjektit “...” (në bazë të kontratës sipërcituar), të kontabilizohet dhe të mos likuidohet vlera e dëmit, dhe me mbylljen e bilancit 2016 të kalojë si e ardhur për Shoqërinë. Urdhëri nuk është lëshuar për veprimin e arkëtimin.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

b.5. Në lidhje me rekomandimin që, Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 1,326,523 lekë, të shkaktuar nga Kontraktori “...”, përfituar padrejtësisht për punime të panevojshme për tu kryer në lyerjen e godinave të studentëve me nr.16,17,22 dhe 23.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Me shkresë nr.prot 387, datë 12.10.2016, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, është marrë



vendim nr. 94, datë 12.10.2016, që nga shuma e përgjithshme që shoqëria detyrohet për likuidim subjektiv “...” (në bazë të kontratës sipërcituar), të kontabilizohet vlera e dëmit, dhe me mbylljen e bilancit 2016 të kalojë si e ardhur për Shoqërinë. Urdhëri nuk është lëshuar në formën për tu arkëtuar.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

b.6. Në lidhje me rekomandimin që, Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 1,040,219 lekë (5,001,053 x 4/1000), të shkaktuar nga kontraktori “...”, për vonesa në zbatimin e kontratës për “Lyerje me gëlqere të godinave 2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,14,16,17,20,21,22,23,24,25,26,27,28 dhe 29 të Qytetit Studenti”.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Me shkresë nr.prot 387, datë 12.10.2016, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, është marrë vendim nr. 94, datë 12.10.2016, që nga shuma e përgjithshme që shoqëria detyrohet për likuidim subjektiv “...” të kontabilizohet vlera e dëmit, dhe me mbylljen e bilancit 2016 të kalojë si e ardhur për Shoqërinë.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

b.7. Në lidhje me rekomandimin që, Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të arkëtuar vlerën e dëmit prej 868.233 (25% x 3.472.932) lekë, të shkaktuar nga kontraktori “...”shpk, si dhe të bëjë konfiskimin e vlerës së sigurimit të kontratës prej 360,000 lekë.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Me subjektin “...” shpk, janë mbajtur korespondenca të vazhdueshme për arkëtimin në mënyrë vullnetare të shumës, gjë e cila nuk është kryer nga ky subjekt. Me shkresë nr.prot 385, datë 12.10.2016, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, është marrë vendim nr. 94, datë 12.10.2016, që nga shuma e përgjithshme që shoqëria detyrohet për likuidim subjektiv “...” shpk (në bazë të kontratës sipërcituar), të kontabilizohet vlera e dëmit, dhe me mbylljen e bilancit 2016 të kalojë si e ardhur për Shoqërinë.

Kjo detyrë është realizuar pjesërisht.

b.8. Në lidhje me rekomandimin që të merren masa nga Trajtimi i Studentëve Nr.1, SHA, për të arkëtuar nga z. ..., në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, dhe nga z. ..., ish-zv/administratori në cilësinë e kryetarit të KVO-së, të dëmit ekonomik në vlerën 10,093,473 lekë, për arsye se; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën +2,010,737 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 582,670 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mobilierie”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 3,845,400 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim muri mbajtës, rrethues mbrapa godinave 22 dhe 23 të Qytetit Studenti ”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 708,792 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 2,698,964 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, nga KVO është marrë në konsideratë dhe është shpallur fitues shoqëria “...”, me vlerë 246,910 lekë, më të lartë nga shoqëria “...”.

Për këtë është rekomanduar të merren masa nga Trajtimi i Studentëve Nr.1, SHA, për të arkëtuar nga z. ..., në cilësinë e ish-administratorit të përgjithshëm, dhe nga z. ..., ish-



zv/administratori në cilësinë e kryetarit të KVO-së, të dëmit ekonomik në vlerën 10,093,473 lekë, për arsye se; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën +2,010,737 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 582,670 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mobilierie”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 3,845,400 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim muri mbajtës, mbrapa godinave 22 dhe 23 të Qytetit Studenti ”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në vlerën 708,792 lekë, në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Lyerje godinave qyteti i studentit”, Autoriteti Kontraktor ka paguar më shumë në kualifikimin e ofertuesve dhe vlerësimin e ofertës fituese në vlerën 2,698,964 lekë; në zbatimin e procedurave të prokurimi dhe zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, nga KVO është marrë në konsideratë dhe është shpallur fitues shoqëria “...”, me vlerë 246,910 lekë, më të lartë nga shoqëria “...”.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Ky rekomandim është në proces. Shoqëria është në pritje të përfundimit të hetimit.

b.9. Për sa më sipër është rekomanduar, Shoqëria të marrë masa për të arkëtuar vlerën prej 252,600 lekë, nga shkaktarët e dëmit, ish-Administratori i përgjithshëm z ... ish përgjegjës i sektorit elektrik z. ..., dhe ish anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla zj. ... dhe znj. ... dhe z. Të arkëtohet në arkën e shoqërisë vlera prej 586,320 lekë, nga shkaktari i dëmit, ish Administratori i përgjithshëm z.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:

Ky rekomandim është në proces. Me shkresat nr.prot 26, 29, 30 dhe 35 datë 14.01.2015, nga Drejtori i Përgjithshëm, janë marrë respektivisht vendimet nr.07, 10, 11 dhe 14 datë 14.01.2015, për shlyrjen e 50% të dëmit nga punonjësijt e Shoqërisë zj. ..., zj. ..., z....., z. Këto vendime nuk janë ekzekutuar pasi çështja kaloi për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Ka mbaruar gjyqi në shkallën e parë të gjyqimit. Aktualisht procesi po trajtohet në Gjykatën e Apelit.

C. Masa disiplinore

Në lidhje me 4 masat disiplinore janë zbatuar të gjitha.

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

II.1. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

Për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, Këshilli Mbikëqyrës e ka ushtruar aktivitetin e tij në bazë të vendimeve të ndryshme që ka marrë. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë zhvilluar kryesisht çdo muaj, si dhe është mbajtur procesverbali përkatës për këto mbledhje.



Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se:

- Nuk konstatohet mënyra e thirrjes së mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu II, pika 6/a.
- Nuk konstatohet programi vjetor i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu III, pika 1.
- Nuk konstatohet mënyra e dërgimit të materialeve dhe raporteve që janë paraqitur në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu III, pika 4.
- Nuk konstatohen deklarimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi, në lidhje me pjesëmarrjen në këshill të parë ose të dytë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu V, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Kryetari dhe anëtarët e këshillave mbikëqyrës deklarohen vetë me shkrim në drejtorinë e shoqërisë për shpërblimin për pjesëmarrje në këshillin e parë apo të dytë”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime si më poshtë:

3 mujori i IV, Viti 2014

Për periudhën 01.10.2014-31.12.2014, Këshilli Mbikëqyrës, përbëhet nga z. ... Kryetar, z. ... dhe znj. ... anëtarë. Për këtë periudhë konstatohet të jenë marrë 3 vendime, si më poshtë vijon:

-Vendimi nr. 20, datë 09.10.2014, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i Rregullores së Brendshme të Shoqërisë,
- Miratimi i projektit të financuar nga shoqëria Eagle-Albtelecom.

Sipas procesverbalit të mbledhjes nr. 1548/1, datë 09.10.2014, konstatohet se Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendim dhe për kërkesës e shoqërisë “...”, për shtesë kontrate për “...”, në rezidencat 11-12, 24-25, 26-27, për problematikën e “...” në urën lidhëse me kollona të hapura anash dhe problematikën e objektit “...”, por këto çështje nuk janë zbardhur në Vendimin përkatës të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu III, pika 5.

-Vendimi nr. 21, datë 27.11.2014, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i Projekt-Programit të vitit 2015 të shoqërisë.

-Vendimi nr. 22, datë 19.12.2014, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i vlerës së nxjerrjes jashtë përdorimi të materialeve të inventarit ekonomik dhe miratimin e procedurës së ankandit publik “Shitje për skrap materiale hekurishte rikupero”.

Ky vendim është miratuar me votën “Pro” të kryetari të KM z. ... dhe anëtares së KM znj. Anëtari i KM z. ... ka votuar kundër me arsyetimin që është kompetencë e asamblesë dhe jo e këshillit, pasi ka të bëjë me zvogëlim të kapitalit. Me shkresën përcjellës të datës 19.12.2014, Kryetari i KM i kërkon drejtorit të përgjithshëm që ky vendim ti kalojë për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme. Por në zbatim të zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë



anonime shtetërore”, Kreu IV, pika 5/c, kërkesa për miratimin përfundimtar të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, duhej përcjellë nga vetë Këshilli Mbikëqyrës dhe jo Drejtori i Përgjithshëm.

Viti 2015

Për periudhën 01.01.2015-31.12.2015, Këshilli Mbikëqyrës, përbëhet nga z. ... Kryetar, z. ... dhe znj. ... anëtarë. Për këtë periudhë konstatohet të jenë marrë 12 vendime, si më poshtë vijon:

-Vendimi nr. 01, datë 26.01.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i ndryshimeve në strukturën organike,
- Miratimi i propozimit për ndryshimin e tarifave në rezidencat familjare, tarifës së larjes së rrobave në minilavanderi dhe tarifës së regjistrimit në bibliotekë,
- Miratimin e kontratës tip të qiradhënies (për ambientet e rezidencave familjare).

-Vendimi nr. 02, datë 09.02.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e draft-kontratës për objektet me qira.

-Vendimi nr. 03, datë 17.03.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin ndryshimeve në projekt-buxhetin e vitit 2015, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 27.11.2014,
- Miratimin e llogaritjes së provizioneve të pasqyruara në bilancin përfundimtar të shoqërisë të vitit 2014.

-Vendimi nr. 04, datë 09.04.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i propozimit të drejtorisë për mendimin e Projekt-Statusit të shoqërisë përsa i përket nenit 2 “Objekti i shoqërisë”,
- Përcjelljen për miratim të Projekt-Statusit me ndryshime, te Asambleja e Përgjithshme (Ministrit të MZHETTS).

-Vendimi nr. 05, datë 13.05.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e marrjes me qira të ambienteve me sipërfaqe 100 m².

-Vendimi nr. 06, datë 30.06.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2014, si dhe përcjelljen e këtij vendimi për miratim përfundimtar MZHETTS.

-Vendimi nr. 07, datë 20.07.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Rikthimin në punë të z. ..., në pozicionin “Drejtor koordinimi dhe planifikimi”, të shoqërisë,
- Ndryshimin e organigramës së shoqërisë dhe tabelës së pagave duke shtuar si pozicion “Drejtor koordinimi dhe planifikimi”.

-Vendimi nr. 08, datë 20.07.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Rinovimin e kontratës me znj. ..., për ambientet me sipërfaqe ndërtimi 39 m², pranë godinës nr. 18.

-Vendimi nr. 09, datë 21.09.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Emërimin e z. ... si Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës.



-Vendimi nr. 10, datë 13.11.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Orientimin e shoqërisë për marrjen e ofertave më të favorshme çmim/cilësi, në përfitim të studentëve, për ushtrimin e aktivitetit me objekt veprimtarie shpërndarje automatike të produkteve të ndryshme dhe dhënien e informacionit Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me përfitimin që merr shoqëria nga shërbimi i ofruar me anë të këtyre pajisjeve shpërndarëse,
- Miratimin e dhënies me qira të ambientit me sipërfaqe 200 m², subjektit ...,
- Miratimin e tarifave të parkimit pranë territorit të rezidencës nr. 18.

-Vendimi nr. 11, datë 13.11.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimi i projekt-programin të shoqërisë për vitin 2016, dhe parashikimin për vitin 2017-2018,
- Projekt-programi i vitit 2016 dhe parashikimi për vitin 2017-2018, ti paraqitet për miratim përfundimtar Ministrisë të MZHETTS.

-Vendimi nr. 12, datë 07.12.2015, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e draft marrëveshjes së bashkëpunimit midis RSU1 dhe shoqërisë “...” SHPK, me objekt dixhitalizimin e bibliotekës ekzistuese,
- Miratimin për krijimin e drejtorisë juridike,
- Miratimin për krijimin e sektorit të ruajtjes së territorit dhe objekteve të shërbimit në drejtorinë e burimeve njerëzore,
- Miratimin e ndryshimeve në strukturën organike të shoqërisë,
- Miratimin e kontratës së huapërdorjes midis RSU1 dhe shoqërisë “...” SHA me objekt huadhënien pa shpërblim të pajisjeve të shërbimit WI-FI.

Viti 2016

Për periudhën 01.01.2016-08.09.2016, Këshilli Mbikëqyrës, përbëhet nga z. ... Kryetar, z. ... dhe znj. ... anëtarë. Pas kësaj date Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga znj. ... kryetare, z. ... dhe z. ... anëtarë. Për këtë periudhë konstatohet të jenë marrë 9 vendime, si më poshtë vijon:

-Vendimi nr. 01, datë 26.01.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e planit vjetor për vitin 2016 të Auditit të Brendshëm të shoqërisë,
- Miratimin e politikave kontabile të shoqërisë,
- Miratimin e rinovimit të kontratës midis RSU1 dhe subjektit ..., për ushtrimin e aktivitetit me objekt veprimtarie shpërndarjen automatike të produkteve të ndryshme,
- Miratimin e rinovimit të kontratës midis RSU1 dhe subjektit ... për marrjen me qira të ambienteve me sipërfaqe 100 m².

-Vendimi nr. 02, datë 15.03.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e ndryshimeve në Projekt-Programin e vitit 2016,
- Ngarkimin e drejtorisë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për kthimin e përgjigjes dhe administrimin e pronës nr. 5/611 në lidhje me “Kërkesën për bashkëpunim, për hapësirat e parkimeve publike të dërguara nga Bashkia Tiranë”, duke zbatuar dhe ndjekur dispozitat ligjore në fuqi.

-Vendimi nr. 03, datë 06.06.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2015,
- Ngarkimin e shoqërisë për përcjelljen për miratim përfundimtar Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Vendimi nr. 05, datë 19.08.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Të mos miratohet kërkesa për ndërprerjen e kontratës së qirasë me subjektin ..., për ambientin me sipërfaqe 200 m²,
- Miratimin e rinovimit të kontratës së qirasë për subjektin ..., me sipërfaqe ndërtimi 39 m².

Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, nr. 27004, datë 08.09.2016, Kryetarit të Bashkisë Tiranë, është vendosur:

1. Lirimi nga detyra i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës z. ... dhe znj. ...
 2. Emërimi i anëtarëve të Këshillit të përbërë nga znj. ..., z. ... dhe z. ...
 3. Ngarkohet znj. ... drejtor i drejtorisë juridike, të kryejë veprimet mbi ndryshimet e bëra sipas këtij vendimi.
- Asnjë vendim tjetër nuk u mor në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila u mbyll në orën 10:00.

Në zbatim të këtij vendimi është miratuar dhe Statusi i ri i shoqërisë, i cili është i firmosur nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Por në paragrafin e fundit të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, nr. 27004, datë 08.09.2016, shprehimisht përcaktohet se: “Asnjë vendim tjetër nuk u mor në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila u mbyll në orën 10:00”.

Vendimet e Këshillit të ri Mbikëqyrës, janë si më poshtë vijon:

-Vendimi nr. 739/1, datë 13.09.2016, me anë të së është vendosur:

- Znj. ... zgjidhet Kryetare e Këshillit Mbikëqyrës.

-Vendimi nr. 739/2, datë 13.09.2016, me anë të së është vendosur:

- Znj. ... emërohet sekretare e Këshillit Mbikëqyrës.

Për çështjet e vendosura në vendimet nr. 739/1 dhe 739/2, datë 13.09.2016, nuk konstatohet procesverbali i mbledhjes, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu III, pika 5.

-Vendimi nr. 992, datë 17.11.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Emërimin e znj. ... në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë,
- Miratimin e kërkesës për vendosjes e antenës nga kompania ...kundrejt pagesës mujore 50,000 lekë me tvsh,
- Miratimin e pagesës së sekretares së Këshillit Mbikëqyrës në vlerën 5,000 lekë/muaj.

Në vendimin për emërimin e znj. ... në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë, Këshilli Mbikëqyrës nuk ka përcaktuar pagën e drejtorit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu IV, pika 2, e cila përcakton se: “Këshilli mbikëqyrës, me 2/3 e gjithë anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, përcakton numrin e anëtarëve të drejtorisë, emëron anëtarët e drejtorisë dhe me miratimin paraprak të Ministrit të METE-s (asamblesë), ngarkon njërin prej anëtarëve të saj me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm. Në vendimin për emërim në detyrë, përcaktohet edhe paga e drejtorit të shoqërisë dhe anëtarëve të tjerë, në përputhje me aktet ligjore për këtë qëllim dhe në varësi të situatës financiare të shoqërisë”.

-Vendimi nr. 1092, datë 16.12.2016, me anë të së cilit konfirmuar dhe me procesverbalin e mbledhjes, është vendosur:

- Miratimin në parim të buxhetit për vitin kalendarik 2017,
- Miratimin e kërkesës për ndryshimin e strukturës së shoqërisë, pa efekte në buxhet e as në numrin e punonjësve të miratuar,



- Rinovimin e mandatit për postin e zëvendës drejtorit për z. ..., z. ... dhe z.

Në vendimin për rinovimin e mandatit të zëvendës drejtorëve të përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës nuk ka përcaktuar pagën e tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, kreu IV, pika 2, e cila përcakton se: “Këshilli mbikëqyrës, me 2/3 e gjithë anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, përcakton numrin e anëtarëve të drejtorisë, emëron anëtarët e drejtorisë dhe me miratimin paraprak të Ministrit të METE-s (asamblesë), ngarkon njërin prej anëtarëve të saj me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm. Në vendimin për emërim në detyrë, përcaktohet edhe paga e drejtorit të shoqërisë dhe anëtarëve të tjerë, në përputhje me aktet ligjore për këtë qëllim dhe në varësi të situatës financiare të shoqërisë”.

II.2. Vendimet e Drejtorisë

Për periudhën objekt auditimi, drejtorja e shoqërisë përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 zëvendës Drejtor të Përgjithshëm.

Në zbatim dhe të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 09.10.2014, veprimtaria vendimmarrëse është kryer nga drejtori i përgjithshëm, kurse zëvendës drejtorët e përgjithshëm kanë patur si objekt veprimtari mbikëqyrëse ndaj strukturave në varësi të tyre sipas përcaktimeve të neneve 5, 6 dhe 7, të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 09.10.2014.

Për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, Drejtori i Përgjithshëm ka funksionuar në bazë të vendimeve (urdhrave) të nxjerra. Këto vendime kanë patur natyrë të ndryshme si:

- Vendime në lidhje me procedurat e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të tillë si urdhra prokurimi, ngritje komisionesh njësi prokurimi dhe vlerësimi, anulime etj.
- Vendime në lidhje me aktivitetin e burimeve njerëzore, si emërim, largime, lëvizje paralele e ngritje në detyrë, dhënie masa disiplinore, mbi zbatimin e strukturës së miratuar paraprakisht nga Këshilli Mbikëqyrës, etj.
- Vendime të aktivitetit të përditshëm si caktimin e tarifave mujore të qirasë (pas miratimit paraprak të Këshillit Mbikëqyrës), vendime në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin (ngritje komisionesh inventarizimi, vlerësimi, nxjerrje jashtë përdorimi, asgjësimi etj), si dhe vendime të ndryshme në lidhje me aktivitetin e përditshëm të shoqërisë të natyrës financiare dhe operacionale, etj.

III. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Projekt programet ekonomik-financiare për vitet 2014, 2015 dhe 2016, janë hartuar bazuar në ligjin nr.9901, 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”. Hartimi i programeve ekonomik-financiar është kryer mbi bazën e realizimit të treguesve të vitit paraardhës, 6 mujorin e parë të vitit në vazhdim dhe realizimit të pritshëm të këtij viti. Projekt programi i çdo viti është miratuar nga drejtorja e shoqërisë dhe pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, është paraqitur për mendim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila miraton subvencionin dhe përfundimisht programi i zhvillimit ekonomik financiar, miratohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Për vitin 2017 ky program është miratuar nga Bashkia Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Për vitin 2014. Projekt buxheti i treguesve ekonomik e financiar të shoqërisë, përgatitur nga departamenti ekonomik në bashkëpunim me departamentet e tjera, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 880, datë 9.11.2013, me vendimin nr.4, datë 14.11.2013 “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2014” është bërë miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës me shkresën nr.940, datë 19.11.2013, dërguar për miratim me shkresën nr.953, datë 19.11.2013, në MZHETS, dhe me shkresën nr.954, datë 19.11.2013, është dërguar në MAS.

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 17.03.2014, është bërë miratimi i programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë dhe treguesve kryesorë ekonomikë dhe financiarë, të ndryshuar pas rishikimit të pasqyrave të programit të zhvillimit ekonomik për vitin 2014, bazuar në relacionin e Departamentit Ekonomik të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë. Me shkresën e MAS nr.925/6, datë 10.02.2014, në lidhje me disa mendime për projektbuxhetin e shoqërisë, shoqëria pasi ka bërë reflektime në programin ekonomik e ka paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr.462, datë 5.03.2014, me shkresën nr.558, datë 19.03.2014, është dërguar në MEZHETS, e cila e ka miratuar dhe dërguar programin ekonomik për vitin 2014 me nr.665, datë 7.04.2014, dhe me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 17.03.2014, ka miratuar programin ekonomik e financiar të shoqërisë, që paraqitet si më poshtë:

Treguesit ekonomik për vitin 2014 në/mln lekë

Emërtimi	Njësia e matjes	Programi i vitit 2014
Të ardhurat gjithsej	Mln/lekë	440.3
Shpenzimet gjithsej	Mln/lekë	462.5
Investimet gjithsej	Mln/lekë	4.8
Numri i Punonjësve	Numri/mesatar	403
Paga mesatare mujore	lekë	38,668
Fondi i Pagave	Mln/lekë	187
Fitimi/humbje	Mln/lekë	-22.2
Numri i studentëve	Nr/mes	5700
Tarifa vjetore e akomodimit studentëve	lekë	45000

Të ardhurat

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, sha, Tiranë, ka si burim për të realizuar të ardhurat respektivisht:

- Të ardhurat nga aktiviteti i shoqërisë.
- Të ardhurat nga subvencioni.

Pasqyra e realizimit të ardhurave sipas zërave për vitin 2014, paraqitet si më poshtë:

N r	Emërtimi	Nj/ m	Fakt 2013	Plan 2014	Fakt 2014	% realizimit	Krahasi mi me 2013
1	të ardhura nga akomodimi studenti në rezidenca	mln	223.20	234.20	210.54	89.90	0.94
2	të ardhura nga akomodimi familjare	mln	13.00	24.20	22.58	93.3	1.74
3	të ardhura akomodimi hoteli, Rezidenca Nr.1	mln	6.30	9.00	9.1	101.11	1.44
4	të ardhura akomodimi hoteli, Rezidenca Nr.13	mln	8.70	9.70	9.43	97.22	1.08
5	të ardhura nga objekte me qera	mln	3.39	1.00	1.35	135.0	0.40
6	të ardhura nga minilavanderia	mln	0.8	0.90	0.78	86.67	0.98
7	të tjera	mln	0.18	0.30	0.6	200.00	3.33
	Totali		255.6	279.30	254.26	91.08	0.94



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Referuar tabelës përmbledhëse të të ardhurave nga aktiviteti i shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sha” realizimi i tyre në total është në masën 91.08% e analizuar si më poshtë vijon:

-Të ardhurat nga akomodimi i studentëve në rezidenca studentore.

Në zbatim të Vendimit Nr.4, datë 31.01.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, “Për miratimin e tarifave të qerave”, tarifa vjetore vjetore e regjistrimit të studentëve për vitin akademik shkollor 2014-2015 është 45000 lekë.

Të ardhurat nga tarifat studentore arkëtohen në përgjithësi parapagim për gjithë vitin akademik. Studentët të cilët kanë paraqitur kërkesën, që për arsye të pamundësisë financiare për pagesë parapagim për kuotë të plotë vjetore, janë pranuar dhe pagesa me këste brenda periudhës së detyrimit. Këto raste janë të gjitha të evidentuar nga Sektori i Buxhetit dhe Administratorët e rezidencave për ndjekjen e pagesës sistematike të tarifave.

Planifikimi i të ardhurave është bërë mbi bazën e numrit të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2013-2014, të ardhurat që krijohen për periudhën e regjistrimit Janar-Qershor 2014 me pagesa pjesore, të ardhura nga tarifat studentore në periudhën e verës si dhe të ardhura të llogaritura me kapacitetin maksimal të vendeve të strehimit për periudhën Tetor-Dhjetor 2014.

Për vitin akademik 2013-2014 janë paguar parapagim në vitin 2013 për llogari të vitit 2014 shuma 155 mln lekë, janë kryer regjistrime pjesore dhe pagesa pjesore për periudhën Janar-Qershor 2014 në shumën 4.1 mln lekë, janë arkëtuar nga studentët e verës shuma 3.1 mln lekë.

-Të ardhurat nga akomodimi i familjarëve

Në zbatim të Vendimit Nr.10, datë 15.01.2014 të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e kuotave të qerave në godinat familjare” dhe numrit të dhomave të shfrytëzueshme për banim në godinat familjare në programin ekonomik është planifikuar 24.2 mln lekë dhe në fakt është realizuar 22.6 mln ose 93.3 %. Ky mos realizim vjen nga mos shfrytëzimi i kapacitetit të planifikuar.

Arkëtimi në fakt i të ardhurave nga akomodimi i familjarëve dhe gjendja e debisë në 31.12.2014

	Emërtimi	Nj/mat	plan kontrata	arkëtimi	debita	% e arketimit
1	Rezidenca Nr.15-a	mln	4.41	4.26	0.15	96.6
2	Rezidenca Nr.15-b	mln	6.66	6.5	0.16	97.6
3	Rezidenca Nr.18	mln	7.57	7.26	0.31	95.9
4	Rezidenca Nr.19	mln	3.94	3.8	0.14	96.4
	shuma	mln	22.58	21.82	0.76	96.6

Nga tabela shihet se realizimi i arkëtimit të të ardhurave familjare është 96.6 %. Arkëtimi i të ardhurave në këto rezidenca ka qënë problematik në vite. Gjithashtu gjatë vitit 2014 është arkëtuar dhe shuma 0.59 mln lekë, debi e mbartuar nga viti 2013.

-Të ardhura nga rezidencat nr.1 dhe nr.13.

Planifikimi i të ardhurave nga dy hotelet për periudhën Janar–Korrik 2014 është bërë mbi bazën e numrit të studentëve të regjistruar për vitin akademik shkollor 2013-2014 dhe për periudhën Tetor–Dhjetor 2014, planifikimi është bërë mbi bazën e kapacitetit maksimal të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

vendeve të strehimit. Të ardhurat në zërin tarifat e hotelit janë realizuar në masën 101 % në rezidencën Nr.1 dhe 97.22% në rezidencën Nr.13. Për arsye të kushte shumë të mira banimi në Rezidencën Nr.1, kërkesat për akomodim janë më të larta, si rrjedhim shrytëzimi i ambjenteve ka qënë afër me kapacitetin. Tejkalimi i të ardhurave vjen se ka pasur shfrytëzim të ambjenteve dhe gjatë periudhës së verës.

Arkëtimi në fakt i të ardhurave nga tarifat e hotelit dhe gjendja e debisë në 31.12.2014

Nr	Emërtimi	Nj/mat	kontrata	arketimi	debita	%
1	Rezidenca nr.1	mln	9.1	9.1	0	100.00
2	Rezidenca nr. 13	mln	9.43	9.43	0	100.00
	Shuma	mln	18.53	18.53	0	100.0

-Të ardhura nga objektet me qera.

Planifikimi i të ardhurave nga objektet me qera është bërë mbi bazën e kontratave të lidhura me subjektet në zbatim të VKM. Nr.529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM Nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Nga tabela nr.1 shohim se realizimi i të ardhurave nga qiradhënia e objekteve është në masën 135 %. Ky tejkalim vjen si rezultat i shtesës gjatë vitit të tre kontratave të tjera analizuar si më poshtë:

Tabela e objekteve me qera, të ardhura dhe detyrimi për vitin 2014

lekë

Nr.	Subjekti	Data e lidhjes të kontratës	afati i kontratës	Detyrimi mujor	Të ardhurat bruto vjetore	detyrimi në buxhet	Të ardhura neto
1	...	23.08.2010	20 vjet	124,000	1,488,000	446,400	1,041,600
2	...	09.05.2014	1 vit	23,400	280,800	84,240	196,560
3	...	08.09.2014	1 vit	7,800	93,600	28,080	65,520
4	09.05.2014	25.09.14	15,600	70,720	21,216	49,504
	Shuma				1,933,120	579,936	1,353,184

Arkëtimi në fakt i të ardhurave nga objektet me qera dhe gjendja e debisë në 31.12.2014

Tabela (në mln lekë)

Nr.	Subjekti	Njësia	Plan	Fakt	Debi
1	...	mln	1.488	1.488	-
2	...	mln	0.280	0.280	-
3	...	mln	0.093	0.085	0.008
4	mln	0.072	0.031	0.041
	Shuma		1.93	1.88	0.4

-Të ardhura nga minilavanteritë.

Për planifikimin e të ardhurave nga minilavanteria është marrë për bazë mesatarisht numri i larjeve që mund të bëhen në një ditë nga një lavatriçe, gjendja teknike e lavatriçeve si dhe tarifa për një larje. Në përdorim janë 12 lavatriçe familjare, të cilat për periudhën Janar-Korrik 2014 kanë qënë të shpërndarë në disa rezidenca studentore dhe për vitin akademik 2014-2015 janë të grumbulluar në lavanterinë qendrore për një shërbim më të mirë larje dhe tharje.

Të ardhurat nga minilavanteria janë realizuar në masën 86.67%.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

-Të ardhura të tjera

Zëri të ardhura të tjera është planifikuar mbi bazën e përvojës së vitit të kaluar. Në këtë zë futen të ardhurat nga vërtetimet e studentëve për dokumentacionin për bursë, të ardhura nga autorizime për makinat që qarkullojnë në territorin e Qytetit Studenti etj, të ardhura nga të tretë për promovime aktiviteti etj.

-Të ardhura nga subvencioni

Burim tjetër i të ardhurave është dhe subvencioni, që për vitin 2014 ishte planifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në masën 154 mln lekë dhe është realizuar në masën 156 mln lekë.

Shpenzimet

Për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë tre janë grupet e shpenzimeve sipas funksionit.

1. Shpenzime për materiale, furnitura dhe shërbime për mirëmbajtje
2. Shpenzime për personelin.
3. Shpenzime për amortizimin.
4. Shpenzime të tjera (vendime gjykatë)

Tabela përmbledhëse e zërave të shpenzimeve.

Nr	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Njësia	Plani viti 2014	Fakti viti 2014	% Realiz.
	Materiale				
1	karburant	mln lekë	1.50	1.5	100
2	materiale elektrike-hidraulike	"	4.00	3.8	95
3	materiale ndërtimi dhe marangozi	"	3.00	2.8	93.3
4	detergjentë pastrimi dhe larje rroba	"	1.30	1.16	89.2
6	lëndë djegëse për kaldajën për godinën 1	"	0.48	0.47	97.9
7	shpenzime gjelbërimi (pleh, farë bari, lule etj)	"	0.30	-	
8	bojë fotokopje dhe printer leter	"	0.40	0.32	80.0
9	shtypshkrime kartela etj	"	0.10	0.06	60.0
	Totali		11.08	10.11	91.2
	Furnitura				
1	shpenzime për energji elektrike	mln lekë	103.00	89.7	87.1
2	shpenzime për ujë	"	68.00	58.7	86.3
3	Internet+telefon (administratë+ bibliotekë)	"	0.30	0.17	56.7
	Totali	"	171.30	148.57	86.7
	Shërbime dhe mirëmbajtje				
1	Paga të Keshillit Mbikëqyrës	"	0.95	0.95	100.0
2	Auditim vjetor i pasqyrave financiare	"	0.70	1.44	205.7
3	pjesë këmbimi për makineri dhe pajisje	"	0.30	0.04	13.3
4	servis makina dhe të tjera shërbime	"	0.48	-	0.0
5	dezinfektim -deratizim i godinave	"	0.80	0.79	98.8
6	Blerje shtypi, abonim vjetor	"	0.10	0.04	40.0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

	Totali	"	3.33	3.26	97.9
	Siguracione dhe taksa			-	
1	sig. i dety, taksa vjetore për makina, taksa vendore	"	0.30	0.11	36.7
	Totali	"	0.30	0.11	36.7
	Të tjera			-	
1	Aktivitete social kulturore	mln lekë	0.20	-	0.0
2	Të tjera	"	0.48	0.22	45.8
	Totali	"	0.68	0.22	32.4
A	Totali i shpenzimeve sipas funksionit	mln lekë	186.69	162.27	86.9
				-	
1	Fondi i pagave	mln lekë	187.00	178.5	95.5
2	sigurime shoqerore	mln lekë	31.30	29.3	93.6
3	trajtime e shpërblime personeli	mln lekë	2.00	0.37	18.5
B	shpenzime personeli	mln lekë	220.3	208.2	94.5
C	vendime gjykate	mln lekë	1.50	10.14	676.0
	vendime gjykate për pagese page ...		1.50	1.48	
	... (ish objekt me qera)			4.6	
	Gjoha nga Bashkia INUK			0.9	
	Shpenzime permbarimore për UKT			1.28	
	vendime gjykate për pagese page ...			0.62	
	vendime gjykate për pagese page ...			1.16	
	vendime gjykate për pagese page ...			0.2	
	TOTALI a+b+c	mln lekë	408.49	380.61	93.2
D	Amortizimi		54.00	45.5	84.3
	TOTALI a+b+c+d		462.49	380.56	82.3

Referuar tabelës përmbledhëse të shpenzimeve të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sha” realizimi i tyre në total është në masën 82.3 % e analizuar si më poshtë vijon:

Analiza e zërave të shpenzimeve nga aktiviteti:

Shpenzime për materiale, furnitura dhe shërbime për mirëmbajtje

Për periudhën vjetore janë planifikuar 11.08 mln lekë për materiale, janë realizuar 10.11 mln lekë. Ky zë është realizuar në masën 91.2%. Kjo ulje është si rezultat i zvogëlimit të blerjeve në masën 6% dhe 2.8% nga mos shfrytëzimi i fondit të planifikuar për sektorin e gjelbërimit. Për vitin 2014 është planifikuar 171.3 mln lekë dhe janë realizuar 148.63 mln lekë si shpenzime për energji elektrike, ujë dhe të tjera. Ky zë në total është realizuar në masën 86.8% ose 22.67 mln lekë më pak. Të gjitha faturat e shpenzimeve për ujë dhe energji janë regjistruar dhe krahasuar me shpenzimet faktike. Në uljen e shpenzimeve për ujë dhe energji kanë ndikuar ulja e numrit të studentëve të akomoduar në krahasim me planifikimin, dhe menaxhimi i shpenzimeve në rezidenca.

Në zërin shërbime të tjera dhe mirëmbajtje janë përfshirë shpenzime për riparimet dhe pjesë këmbimi të makinave të transportit, pagesa e ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare, pagesa e Këshillit Mbikëqyrës etj. Ky zë është planifikuar në masën 3.33 mln lekë dhe është realizuar në masën 3.26 mln lekë ose 97.9%.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Emërtimi	Fakti 2014	Programi 2015	Realizimi2015	Në vlerë	Në përqindje
Akomodim studenti	210,540	203,103	184,435	-18,668	91
Qira familjare	22,580	19,555	20,235	680	103
Akomodim hoteli godina nr1 + godina nr.13	18,530	19,908	19,378	-530	97
Qira objektsh	1,350	1,862	2,140	278	115
Minilavanteri	780	900	731	-169	73
Të tjera	600	600	432	-168	81
Totali	254,260	245,928	227,351	-18,577	92

Shpenzime për personelin.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr.3, datë 14.11.2013 dhe Vendimit nr.9, datë 30.12.2013, shoqëria ka pasur në strukturë numrin mesatar të punonjësve për 403 vetë. Llogaritja e fondit të pagës është bërë mbi bazën e elementëve si paga bazë e miratuar për çdo kategori, shtesa mbi pagën bazë për vjetërsinë e punës deri në 25% për çdo punonjës, pagesa e turneve të II-ta dhe të III-ta dhe ditë feste për kategoritë “ruajtës rezidence dhe “roje ambjenti”.Fondi i pagës i planifikuar për vitin 2014 është 187 mln lekë dhe është realizuar 178.53 mln lekë. Ky mos realizim vjen si rezultat i mos ekzekutimit të pagesës të turneve të dyta të administratorëve të rezidencave, punonjësve të Bibliotekës dhe Sallave të leximit të cilët janë kompesuar me ditë pushimi të pagueshme në vazhdimësi gjatë vitit. Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në varësi të fondit të pagës duke zbatuar ligjet në fuqi.

Shpenzimet “Për trajtime dhe shpërblime personeli” janë planifikuar në masën 2 mln lekë dhe janë realizuar në masën 0.37 mln lekë. Ky fond është përdorur për raste shpërblime për leje të zakonshme të pakryer për punonjës të larguar nga puna.

Investimet.

Investimet e parashikuara për vitin 2014 janë realizuar në vitin 2015 për arsye të afateve të përfundimit të procedurave të prokurimit në fund të vitit 2014.

Shoqëria ka dalë me humbje për vitin 2014 në vlerën 11.2 milion lekë. Megjithëse shoqëria kishte parashikuar një humbje prej 22 milion lekë ka arritur ta ulë humbjen në 50 %.

Për vitin 2015. Projekt buxheti i treguesve ekonomik e financiar të shoqërisë, përgatitur nga departamenti ekonomik në bashkëpunim me departamentet e tjera, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 1704, datë 30.10.2014, me vendimin nr.21, datë 27.11.2014 “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2015” është bërë miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës me shkresën nr.1984, datë 27.11.2014, është dërguar për miratim në MZHETS, dhe me shkresën nr.1984/1, datë 27.11.2014, është dërguar në MAS. Me shkresën 308/2 datë 03.02.2015 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dhënë mendime në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2015. Pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 3, datë 17.03.2015, është dërguar në MZHETTS dhe MAS, Projektbuxheti i vitit 2015, i ndryshuar. Me shkresën nr. 2319/1 datë 15.04.2015 është miratuar nga MZHETTS.

Pasqyra e realizimit të ardhurave sipas zërave për vitin 2015, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Njësia e matjes	Programi i vitit 2015
Të ardhurat gjithsej	Mln/lekë	406
Shpenzimet gjithsej	Mln/lekë	413.1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Numri i Punonjësve	Numri/mesatar	403
Paga mesatare mujore	lekë	36,600
Fondi i Pagave	Mln/lekë	177
Humbje	Mln/lekë	7.1

Të ardhurat nga tarifat e studentëve janë realizuar në masën 91 %. Tarifat mujore nuk kanë pasur ndryshime. Të ardhurat nga tarifat studentore janë arkëtuar parapagim për gjithë vitin akademik dhe për rastet e studentëve që për arsye të gjendjes të vështirë financiare kanë aplikuar pagesa pjesore. Ndjekja e pagesave është bërë në mënyrë sistematike nga departamenti ekonomik.

Planifikimi i të ardhurave është bërë mbi bazën e viteve të mëparshme. Numri i studentëve ka pasur ulje nga 2014 në 2015. Kjo ka ardhur nga ulja e kërkesave për rregjistrim nga studentët për Master, të cilët nuk e frekuentojnë mësimin çdo ditë por dy herë në javë, si dhe kushtet e akomodimit nëpër rezidenca jo të mira.

-Të ardhurat nga akomodimi i familjarëve.

Në bazë të numrit të dhomave të banueshme në godinat familjare, tarifës mujore të akomodimit në rezidencat familjare, në programin ekonomik të shoqërisë për vitin 2015, është planifikuar një shumë 19,555 mijë lekë dhe në fakt është realizuar 20,235 mijë. Arkëtimi i të ardhurave nga akomodimi i familjarëve dhe gjendja e debise më 31.12.2015 është:

	Rezidencat	Nj/mat	Plan	Fakt	Dif(- +)	%
1	Rezidenca nr.15-a	mijë	3,889	4232	+343	109
2	Rezidenca nr. 15-b	mijë	5,603	6061	+458	108
3	Rezidenca nr. 18	mijë	6,448	6407	-41	99
4	Rezidenca nr.19	mijë	3615	3535	-80	98
	Shuma	mijë	19,555	20,235	+680	103

Nga tabela shihet se realizimi i të ardhurave familjare është 103%. Kjo ka ardhur sepse parashikimi është bërë duke mos llogaritur kapacitetet e plota të rezidencave duke sjelle që realizimi të tejkalojë të ardhurat e planifikuara.

Debitor nga akomodimi i familjarëve me 31.12.2015 është në shumën 2,491 mijë lekë. Qera familjare e derdhur në vitin 2015 për llogari të vitit 2014 është në shumën 2,242 mijë lekë

-Të ardhura nga hoteli

Planifikimi i të ardhurave nga dy hotelet për periudhën Janar – Dhjetor 2015 është bërë në bazë të kapacitetit të tyre dhe tarifës përkatëse të miratuar. Po të shohim tabelën nr.3 të ardhurat në zërin akomodim hoteli është realizuar në masën 97 % pra me një mosrealizim prej 3% kjo ka ardhur nga mosshfrytëzimi i kapaciteteve të strehimit.

Arkëtimi i të ardhurave nga akomodimi në hotele dhe gjendja e debisë më 31.12.2015

	Rezidencat	Nj/mat	Plan	Fakt	Dif(- +)	%
1	Rezidenca nr.1	mijë	9,180	9,180	0	100
2	Rezidenca nr. 13	mijë	10,728	10,198	-530	95
	Shuma	mijë	19,908	19,378	0	97



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Në lidhje me Rezidencën nr.1 të ardhurat e realizuar janë 100% me ato të parashikuara por planifikimi nuk është kryer duke pasur parasysh kapacitetin e plotë të tyre por vitet e mëparshme.

Nga sa thamë më sipër për të dy godinat hoteleri, kapaciteti i strehimit është 234 studente dhe në fakte janë strehuar 211 student pra kapaciteti i shfrytëzimit është 90%. Pra në të dy godinat kemi një mos realizim në vlerë relative prej 3% ndërsa në vlerë absolute është 530 mijë lekë e cila vjen nga mos shfrytëzimi i kapacitetit maksimal të tyre

Të ardhura nga objektet me qera

Planifikimi i të ardhurave nga objektet me qera është planifikuar mbi bazën e kontratave të lidhura me subjektet për objektet me qera dhe përcaktimeve të kreut VII-të të VKM. Nr.529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfitoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Shoqëria në plan kishte të ardhura në shumën 1,862,000 lekë por ka realizuar 2,141,000 lekë duke e tejkaluar me 279,000 lekë.

Ky tejkalim i realizuar është se planifikimi ishte bërë për tre kontrata në fuqi ndërsa gjatë vitit 2015 u lidhën dhe dy kontrata të reja.

Në mënyrë analitike objektet me qera për vitin 2015 janë si më poshtë:

Nr	Emertimi i Objekteve të dhëna me qera		Sip.Objektit në m2	Afati kontratës	Data e lidhjes së kontratës	Qeraja mujore
1	...	Ish-menca	545	20 vjet	23.08.2010	124
2	...	Rezid.18	39	1 vit	20.08.2015	23.4
3	...	Amb.Brend	13	1 vit	08.09.2015	7.8
4	...	Ish.komp.sherb.	100	2 muaj	26.05.2015	60
5	...	Amb.Prane.Lav	200	1 vit	19.11.2015	120

Të ardhura nga minilavanteritë.

Të ardhura nga minilavanteria janë planifikuar mbi bazën e numrit të lavatriceve në gjendje pune si dhe tarifës për një larje. Ky zë është realizuar në masën 81%. Ky mos realizim vjen jo nga mos kërkesa për këtë aktivitet, por nga gjendja teknike e lavtriçeve.

Të ardhura të tjera

Zëri të ardhura të tjera është planifikuar mbi bazën e përvojës së vitit të kaluar. Në këtë zë futen të ardhurat nga vërtetimet e studentëve për dokumentacionin për bursë, të ardhura nga autorizime për makinat që qarkullojnë në territorin e Qytetit Studenti etj.

Ky zë është realizuar në masën 72 %.

Të ardhura nga subvencionit

Burim tjetër i të ardhurave është dhe subvencionit, që për vitin 2015 ishte planifikuar 160,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 155,519 mijë lekë pra me një realizim 97% pra me një impakt në të ardhurat e shoqërisë në vlerë absolute në shumën 4,481 mijë lekë me pak.

Realizimi i shpenzimeve

Për zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë për trajtimin dhe akomodimin e studentëve janë planifikuar dhe realizuar për vitin 2015 shpenzimet e funksionit si më poshtë:

Programi dhe realizimi i shpenzimeve në vitin 2015 në/mln lekë

Nr.	Shpenzimet e shfrytëzimit	Program	Fakt	% realiz
-----	---------------------------	---------	------	----------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

1	Materiale	10,78	8,209	76
2	Furnitura (energji+uje)	140,300	141,391	101
3	Shërbime	3,687	3,013	82
4	Paga personeli	177,000	171,889	97
5	Trajtime shpërblime personeli	1,500	158	11
6	Sigurime shoqërore	29,556	28,289	96
7	Tatime taksa,regjistrim pasurie	200	100	50
8	Amortizim	48,000	40,919	
9	Shpenzimet te tjera	580	0	0
10	Vendime gjykate	1,500	39,180	2600
	Totali	413,103	433,148	105

Burimi i të dhënave nga grupi i auditimit të KLSH.

Në vitin 2015, për të pasur një zhvillim normal të aktivitetit të shoqërisë, janë programuar shpenzimet në shumën 413.1 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 433 milion lekë, ose në masën 105 % me një tejkalim prej 20 milion lekë.

Në përgjithësi të gjitha shpenzimet operative përveç energjisë elektrike janë me ulje dhe duke përjashtuar shpenzimet e amortizimit dhe shpenzimet për vendime gjykate janë realizuar në masën 97.1 %.

Realizimin i shpenzimeve **me ulje** në mënyrë analitike sipas zërave janë si më poshtë:

1. Shpenzime për materiale, për vitin 2015, janë programuar në vlerën 10,78 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën 8,2 milion lekë, ose në masën 76%, me një kursim në vlerën 2.6 milion lekë. Në uljen e shpenzimeve ka ndikuar kursimi që ka ardhur nga konkurenca në prokurimet të programuara dhe të realizuara në fakt.

2. Zëri shërbime dhe mirëmbajtje, janë programuar në vlerën 3,68 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën 3 milion lekë, ose në masën 82 %, me një kursim në vlerën 0.67 milion lekë. Në uljen e shpenzimeve ka ndikuar kursimi që ka ardhur nga kryerja e shërbimit për lyerje të godinës dhe riparimet e makinave me pjesë këmbimi me kosto më të ulët, etj.

3. Zëri paga personeli, janë programuar në vlerën 177 milion lekë, dhe janë realizuar në vlerën 171,9 milion lekë, me një ulje në shpenzime në vlerën 5.1 milion lekë, ose 97 %.

Në llogaritje e shpenzimeve bazë ka qenë numri mesatar i punonjësve me 403 persona me një pagë mesatare prej 36,600 lekë, të përcaktuar me vendimin nr.1, datë 26.01.2015 të Këshillit Mbikëqyrës. Nga auditimi i kryer konstatohet se në vitin 2015, për arsye të uljes së numrit të studentëve drejtimi i shoqërisë ka vendosur për një ulje të fondit të pagave me 5 %. Kjo ulje është realizuar duke kompensuar punonjësit për shtesat e pagës për turnet e dyta me ditë pushimi gjatë javës.

4. Zëri shpenzime amortizimi, janë programuar në vlerën 48 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën 40.9 milion lekë, ose 85%. Për llogaritjen e vlerës së amortizimit shoqëria ka aplikuar metodën e amortizimit zbritës sipas normave fiskale për ndërtesat, makineritë e pajisjet mjete transporti etj, në zbatim të vlerës së mbetur sipas SKK dhe jo normat e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës që përdor për pasqyrat financiare.

Kjo metodë nuk është e saktë pasi shoqëria nuk mund të përdor dy standarte për llogaritjen e normave të amortizimit si dhe duhet të kryejë llogaritjen e saktë të kësaj vlere.

5. Zëri trajtime dhe shpërblime personeli, është programuar në vlerën 1.5 milion lekë, dhe është realizuar në vlerën 0.16 milion lekë, ose në masën 11%, ku përfshihen shpërblimet e dhëna për ndihma ekonomike etj.

6. Zëri shpenzime të tjera, janë programuar në vlerën vlerën 0.6 milion dhe nuk është shpenzuar duke pasur një kursim në vlerën 0.6 milion lekë.



7. Në zërin shpenzime siguracione dhe taksa janë planifikuar në shumën 0.2 milion lekë, janë realizuar në shumën 0.1 milion lekë, që përbëhet nga detyrimet e shoqërisë për pagesat për siguracion pasurie, taksa për makina, regjistrim pasurie dhe taksa vendore.

Me tejkalim në shpenzimet paraqiten zërat e mëposhtëm:

1-Furnitura, për vitin 2015, janë programuar 140.3 milion, dhe janë realizuar në vlerën 141.4 milion lekë, me një mbishpenzim në vlerën 1 milion lekë ose 101%. Në zërin e shpenzimeve “furnitura”, janë përfshirë shpenzimet për ujë, energji, telefon dhe internet. Shpenzimi i energjisë elektrike zë 26 % në strukturën totale të shpenzimeve. Kjo gjë vjen dhe sepse i gjithë kompleksi faturohet me tarifat si biznes. Nga ana e shoqërisë janë marrë masa për të kontrolluar shpenzimin e energjisë nga përdoruesit duke përdorur dhe kufizues përdorimi në dhomat e studentëve.

Investimet

Në vitin 2015 nuk janë kryer shpenzime për investime.

Fitimi.

Për vitin 2015, aktiviteti i shoqërisë është programuar me humbje në vlerën 7.1 milion lekë, është realizuar në vlerën 55.4 milion lekë, me një rritje në vlerën 48.3 milion lekë ose në masën 686 %.

Megjithëse shoqëria ka ulur shpenzimet operative, shpenzimet për vendime gjyqësore, tejkalimi për energji elektrike dhe mosrealizimi i të ardhurave ka sjellë në humbjen e mësipërme.

Në programin vjetor, mungon analiza e hollësishme mbi shkaqet e rritjes së humbjes nga aktiviteti i shoqërisë në nivele shumë të larta, faktorët që kanë ndikuar, përcaktimi i zonave me risk më të lartë etj. Nga organet drejtuese të shoqërisë nuk janë bërë analiza mbi shkaqet që kanë çuar në thellimin e humbjes, dhe nuk është analizuar puna e bërë nga ana e departamenteve të shoqërisë, për pasojë nuk janë marrë masa për të përmirësuar të ardhmen, për të gjetur burime të reja për rritjen e të ardhurave.

Për vitin 2016. Projekt buxheti i treguesve ekonomik e financiar të shoqërisë, përgatitur nga departamenti ekonomik në bashkëpunim me departamentet e tjera, është dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës me shkresën nr. 1267, datë 09.11.2015, me vendimin nr.11, datë 13.11.2015 “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2016” është bërë miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës me shkresën nr.1371, datë 20.11.2014, është dërguar për miratim në MZHETS, dhe me shkresën nr.1370, datë 20.11.2015, është dërguar në MAS. Me shkresën 10033 datë 14.01.2016 Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dhënë mendime në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2016. Pasi është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 2, datë 15.03.2015, është dërguar në MZHETTS dhe MAS, Projektbuxheti i vitit 2016, i ndryshuar. Me shkresën nr. 2313/1 datë 18.04.2016 është miratuar nga MZHETTS.

Emërtimi	Njësia e matjes	Programi i vitit 2016
Të ardhurat gjithsej	Mln/lekë	395.5
Shpenzimet gjithsej	Mln/lekë	405.7
Numri i Punonjësve	Numri/mesatar	403
Paga mesatare mujore	lekë	36,600
Fondi i Pagave	Mln/lekë	174
Humbje	Mln/lekë	10.2

Pasqyra e realizimit të të ardhurave sipas zërave për vitin 2016, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Fakti	Programi	Realizimi2016	Në vlerë	Në
----------	-------	----------	---------------	----------	----



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

	2015	2016			përqindje
Akomodim studenti	184,435	198,500	189,045	-9,455	95
Qira familjare	20,235	17,148	13,292	-3,856	77
Akomodim hoteli godina nr1 + godina nr.13	19,378	20,268	20,065	-203	99
Qira objektsh	2,140	3,209	4,075	866	127
Minilavanteri	731	1,000	938	-62	94
Të tjera	432	400	3,411	3,011	853
T o t a l i	227,351	240,525	230,826	-9,699	96

Referuar tabelës përmbledhëse të të ardhurave nga aktiviteti i shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sha” realizimi i tyre në total është në masën 96 % e analizuar si më poshtë vijon:

Të ardhurat nga akomodimi i studentëve në rezidenca.

Shoqëria ka planifikuar për strehim 5000 studentë por deri më 31.12.2016 janë regjistruar 4098 persona, ose në 82 %. Mosrealizimi në vlerë në total për gjithë periudhën është 9,455,000 lekë.

Konstatohet se shoqëria e ka dërguar për rimiratim programin ekonomik në janar 2016 dhe deri në këtë periudhë regjistrimet për pjesën më të madhe janë kryer. Pjesa kryesore e regjistrimeve për vitin akademik kryhet nga tetori në dhjetor. Pra në janar të vitit pasardhës numri i studentëve që do të regjistrohen nuk është më në fazë parashikimi por i realizuar në pjesën më të madhe të tij. Departamenti i Financës këto shifra mund ti marrë nga drejtoritë përkatëse duke e paraqitur programin ekonomik më të saktë dhe të besueshëm.

Të ardhurat nga akomodimi i familjarëve.

Të ardhurat nga qera familjare janë realizuar në masën 77% ose si mosrealizim në vlerën 3,856,000 lekë.

Realizimi i të ardhurave familjare, duke futur dhe arketimet e vitit 2016 për llogari të vitit 2015 (debitor) është 89%. Në këto godina jetojnë familje që janë futur forcërisht në vitin 1991, në vështirësi ekonomike dhe financiare. Mbledhja e detyrimeve për këtë llogari ka pasur vështirësi.

Zëri i debitorëve familjarë më 31.12.2016 është 2,009 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2015 që debitorët janë në shumën 2,491 mijë lekë ka një ulje me vlerën 482 mijë lekë.

Të ardhura nga akomodimi hoteli.

Planifikimi i të ardhurave nga dy hotelet për periudhën 2016 është bërë bazuar në kapacitetin e tyre dhe tarifën përkatëse të miratuar. Shoqëria kishte planifikuar 20,268 mijë lekë dhe ka realizuar 20,065 lekë me një diferencë në 203 mijë lekë.

Në mijë lekë

	Rezidencat	Nj/mat	Plan	Fakt	Dif (- +)	%
1	Rezidenca nr.1	mijë	9,180	9,626	+446	105
2	Rezidenca nr. 13	mijë	11,088	10,439	-649	94
	Shuma	mijë	20,268	20,065	-203	99

Nga sa thamë më sipër për të dy godinat hotelieri, kapaciteti i strehimit është 234 studente. Pra në të dy godinat kemi një mos realizim në vlerë relative prej 1% ndërsa në vlerë absolute është 203 mijë lekë e cila vjen nga levizjet e studentëve gjatë periudhës së planifikuar.



Të ardhura nga objektet me qera.

Planifikimi i të ardhurave nga objektet me qera është planifikuar mbi bazën e kontratave të lidhura me subjektet për objektet me qera dhe përcaktimeve të kreut VII-të të VKM. Nr.529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfitoaze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Nga tabela nr.1 dhe Nr.4 shohim se realizimi në këtë zë është në masën 127 %.

Arkëtimi në fakt i të ardhurave nga objektet me qera dhe gjendja e debisë në 31.12.2016
000/lekë

	Godinat	Nj/mat	plan	fakt	%
1	Të ardhura nga objektet me qira	mijë	3209	4075	127
	Shuma		3209	4075	127

Debitor nga objektet me qera me 31.12.2016 janë dy subjekte. 1-... në shumën 1,800 lekë, dhe 2-... në shumën 1,806 lekë të cilat janë kamatë e pa paguar.

Për vitin 2016 është arkëtuar nga objektet me qera 866 mijë lekë më shumë në vlerë absolute se planifikimi ose në vlerë relative 27% më shumë. Krahasuar me vitin 2015 janë arkëtuar në vlerë absolute 1,921 mijë lekë më shumë ose në vlerë relative 89%. Kjo rritje në krahasim me vitin 2015 është për arsye të shtimit të nr. të kontratave gjatë vitit 2016.

Të ardhurat nga minilavanteria janë planifikuar mbi bazën e numrit të lavatriceve në gjendje pune si dhe tarifës për një larje. Ky zë është realizuar në masën 94%. Ky mos realizim vjen jo nga mos kërkesa për këtë aktivitet, por nga gjendja teknike e lavatriceve. Për vitin 2016 të ardhura nga minilavanteri janë arkëtuar në vlerë absolute 207 mijë lekë me shume se në vitin 2015 ose në vlerë relative prej 128%.

000/Lekë

	Emërtimi të ardhurave	Nj/mat	plan	fakt	%
1	Të ardhura nga minilavanterite	Mijë/leke	1,000	938	94
	Shuma		1,000	938	94

Të ardhura të tjera

Zëri të ardhura të tjera është planifikuar mbi bazën e faktit të vitit të kaluar. Në këtë zë futen të ardhurat nga vërtetimet e studentëve për dokumentacionin për bursë, të ardhura nga autorizime për makinat që qarkullojnë në territorin e Qytetit Studenti, të ardhurat nga ambjentet e përbashkta në godinat familjare si dhe nga biblioteka. Rritja në këtë zë është si pasojë se: Në tetor të vitit 2016 është futur në funksionim parkingu të godina Nr. 18 si dhe Gusht 2016-Shtator 2016 është lidhur një akt marrveshje me UNCHR për akomodimin për një muaj të 400 personave të huaj me tarifën 6500 lekë, në vlerën 2,600 mijë lekë.

Ky zë është realizuar si më poshtë

	Emërtimi të ardhurave	Nj/mat	plan	fakt	%
1	Te ardhura te tjera	Mijë/leke	400	3,412	853
	Shuma		400	3,412	853

Të ardhura nga subvencioni



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Burim tjetër i të ardhurave është dhe subvencioni, që për vitin 2016 ishte planifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit deri në masën 150,000 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 153,117 mijë lekë, ose 102%.

Realizimi i shpenzimeve

Për zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë për trajtimin dhe akomodimin e studentëve janë planifikuar dhe realizuar për vitin 2016 shpenzimet e funksionit si më poshtë:

Në mijë lekë					
	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani i vitit 2016	Fakti i vitit 2016	Realizim i në %	Diferenca realizim-planifikimi
	Materiale	11,692	10,767	92%	-925
	Furnitura	131,250	130,290	99%	-960
	Shërbime dhe mirëmbajtje	3,557	2,915	92%	-642
	Siguracione, taksa vendore	110	100	91	-10
	Të tjera	580	129	22	-451
A	Totali i shpenzimeve operative	147,189	144,201	98	-2,988
	Fond page	174,000	173,665	99.8	-335
	Sigurime shoqërore	29,058	28,631	98	-427
	Trajtime e shpërblime personeli	1,000	29	3	-971
B	Shpenzime personeli	204,058	202,325	99	-1,733
C	Vendime gjyqate (penalitete)	11,500	24,928	217	+13,428
	Vendime gjyqate(...)	1,500	1,500	100	0
	Të tjera (V.Gjyqate)	10,000	23,428	234	+13,428
	TOTALI A+B+C	362,747	371,454	102	+8,707

Shpenzimet

Shoqëria gjatë vitit 2016 ka pasur trendin në uljen e shpenzimeve të planifikuara si për zërat e materialeve, furnizimeve dhe për shpenzimet e personelit. Por vlera e tejkualuar në shpenzimet për gjykatë ka tejkualuar dhe mosrealizimet e shpenzimeve të tjera duke pasur në total një tejkualim në vlerën 8,707 mijë lekë.

Shpenzime për furnitura.

Në planifikimin e shpenzimeve për energji elektrike, ujë, internet-telefoni, në shumën 131,250 lekë është marrë për bazë shfrytëzimi i kapaciteteve të strehimit në rezidencat e studentëve dhe hotele si dhe fakti i vitit 2015. Zëri shpenzime energji elektrike i planifikuar në shumën 75,000 mijë lekë dhe i realizuar në shumën 76,735 ka ardhur si pasojë e një kontrate të rezidencës studentore universitare të faturuar gabim nga ana e OSHEE-se në shumë të konsiderueshme, e cila është reklamuar OSHEE.

Shpenzime, shërbimeve të tjera për mirëmbajtje.

Për vitin 2016 zëri Shpenzime “Shërbime dhe mirëmbajtje” është planifikuar në shumën 3,557 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 2,915 mijë lekë pra me një realizim në vlerë relativë në masën 92% dhe me një mosrealizim në vlerën 642 mijë lekë. Zëri pagat e këshillit mbikëqyrës është planifikuar në shumën 950 mijë lekë dhe në fakt është realizuar në 799 mijë lekë dhe me një kursim prej 151 mijë lekë. Zëri auditim vjetor i pasqyrave financiare është planifikuar sipas kontratës së nënshkruar, orëve të planifikuara, çmimeve përkatëse, mbi bazën e shkresës së MZHETTS për emërimin e ekspertëve kontabël dhe është planifikuar në shumën 1080 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 1,080 mijë lekë. Zëri shpenzime servisi makina dhe të tjera shërbime është planifikuar në bazë të mjeteve në përdorim të shoqërisë si dhe nevojave për mirëmbajtje të tyre në shumën 350 mijë lekë, nuk është shpenzuar. Zëri blerje shtypi abonim vjetor, është planifikuar në shumën 100 mijë lekë, shërbim ky i parealizuar gjatë vitit 2016. Në zbatim të ligjit Nr.7707, datë 17.05.1993 “Për mbrojtjen nga



zjarri”, planifikuar fondi në shumën 277 mijë lekë duke patur parasysh sasinë e fikseve të zjarrit, shërbim ky realizuar gjatë vitit 2016 në shumën 237 mijë lekë me një mosrealizim në shumën 40 mijë lekë. Zëri i shërbimit “dezinfektim dhe deratizim i rezidencave” është planifikuar në masën 800 mijë lekë, duke pasur parasysh sipërfaqet për dezinfektim, deratizim çmimin e tregut, ky zë është realizuar gjatë vitit 2016 në shumën 799 mijë lekë.

Zëri siguracione dhe taksa është planifikuar për vitin 2016 në shumën 110 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 100 mijë me një kursim në vlerë absolute 10 mijë. Zëri të tjera është planifikuar në shumën 580 mijë lekë për vitin 2016 dhe është realizuar në shumën 129 mijë lekë me një kursim në vlerë absolute prej 451 mijë lekë.

Fondi i pagave dhe shpenzime personeli

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, shoqëria ka të miratuar numrin mesatar të punonjësve, si dhe tabelën e pagave bazë për çdo kategori pune, është llogaritur fondi vjetor i pagës. Fondi i pagës në fakt për vitin 2016, është 173,665 mijë lekë nga 174,000 mijë lekë i planifikuar dhe realizuar 99.8% të shpenzimit të planifikuar, me një mosrealizim në shumën 335 mijë lekë. Shoqëria ka planifikuar një fond prej 1,500 mijë lekësh, llogaritur në bazë të Urdhrit të ekzekutimit Nr. 3048, datë 29.05.2006 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor, Tiranë, mbi bazën e të cilit bëhet pagesa në favor të Z. ... ish Drejtor i Përgjithshëm në vitin 2003, i cili ka një vendim gjykate të formës së prerë dhe është realizuar në shumën 1,500 mijë lekë. Ndërsa të tjera vendime gjykate për vitin 2016 janë planifikuar në shumën 10,000 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 23,428 mijë lekë për vendime gjykate në proces, pra këtu te ky zë ka një tejkalim në shumën 13,428 mijë lekë.

Amortizimi

Shpenzimet për amortizimin janë programuar në vlerën 48 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën 40.9 milion lekë, ose 85%. Për llogaritjen e vlerës së amortizimit shoqëria ka aplikuar metodën e amortizimit zbritës sipas normave fiskale për ndërtesat, makineritë e pajisjet mjete transporti etj, në zbatim të vlerës së mbetur sipas SKK dhe jo normat e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës që përdor për pasqyrat financiare.

Kjo metodë nuk është e saktë pasi shoqëria nuk mund të përdor dy standarde për llogaritjen e normave të amortizimit si dhe duhet të kryejë llogaritjen e saktë të kësaj vlere.

Në vijim të periudhave sa më sipër, numri i studentëve ka ardhur duke u zvogëluar me pasoja uljen e të ardhurave të shoqërisë megjithë përpjekjet nga ana e shoqërisë për uljen e shpenzimeve.

IV. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Ndërmarrja “Trajtimi i Studentëve Nr. 1” Sha Tiranë, në pronësi të Ministrisë së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes funksionon në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Me ndryshimet e ndodhura në Statusin e shoqërisë, miratuar me shkresën nr. 3436/1, datë 14.05.2015, të Ministrit të MZHETTS, ndryshohet emërtimi i shoqërisë në “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” Sha Tiranë.

Më pas, me Statusin e shoqërisë të miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 27004, datë 08.09.2016, pronësia e shoqërisë i kalon 100% Bashkisë Tiranë, në zbatim të VKM nr. 335, datë 04.05.2016 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i studentëve nr. 2” sh.a., Tiranë dhe “Trajtimi i studentëve nr. 3” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Objekti i shoqërisë, i përcaktuar dhe në status dhe në ekstraktin e QKB, është “*Trajtimi në fjetore dhe menca i studentëve të Universitetit Tiranë. Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambiente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentet. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qera të ambienteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.*”.

Rregullorja e funksionimit të shoqërisë, është e miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 09.10.2014, vendim i cili i është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë me shkresën nr. 918, datë 12.05.2014.

Marrëdhëniet e punës në RSU1, rregullohen me anë të kontratës kolektive dhe kontratës individuale të punës. Për periudhën objekt auditimi, kanë funksionuar kontratat kolektive dhe individuale, si më poshtë vijon:

-Kontrata Kolektive nr. 436, datë 18.11.2011, me afat 3 vite, është nënshkruar për Ndërmarrjen “Trajtimi i Studentëve Nr. 1” Sha Tiranë nga ish-Drejtori i Përgjithshëm z. ... dhe për Sindikatën e Pavarur të Kimisë, Ushqimit, Tregtisë dhe Turizmit, Presidentja znj. ... dhe nga Kryetari i Sindikatës, Përgjegjësi i departamentit të shërbimeve teknike z.

-Kontrata Kolektive nr. 163, datë 13.03.2015, me afat 3 vite, është nënshkruar për RSU1 nga Drejtori i Përgjithshëm znj. ... dhe për Federatën Sindikale Ndërtim Drurit të Shqipërisë, nga Kryetari ... dhe Kryetari i Këshillit Sindikal

-Kontrata Individuale tip, e miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 133, datë 22.02.2010.

Struktura e shoqërisë ka pësuar ndryshime të shpeshta për periudhën objekt auditimi. Konkretisht, për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, RSU1 ka funksionuar me strukturat si më poshtë vijon:

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 14.11.2013, është vendosur struktura e shoqërisë dhe **numri i total i punonjësve 403**.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 01, datë 26.01.2015, është vendosur struktura e shoqërisë dhe **numri i total i punonjësve 403**.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 07.12.2015, është vendosur struktura e shoqërisë dhe **numri i total i punonjësve 404**.

-Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1092, datë 16.12.2016, është vendosur struktura e shoqërisë dhe **numri i total i punonjësve 404**.

Me shkresën nr. 308/2, datë 03.02.2015 “*Mendim në lidhje me projektprogramet e zhvillimit të shoqërive anonime të “Trajtimin të Studentëve” për vitin 2015*”, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, z. ... në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera citon se: “*Numri i punonjësve të parashikuar në shoqërinë tuaj, në raportin (1/15) nuk është konform Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003*”.

Me shkresën nr. 10033/1, datë 14.01.2016 “*Mendim në lidhje me projektprogramet e zhvillimit të shoqërive anonime të “Trajtimin të Studentëve” për vitin 2016*”, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, z. ... në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndër të tjera citon se: “*Në relacionin mbi parashikimin e projekt programit të vitit 2016 cilësoni se: “Struktura organike do të ndërtohet në funksion të qëllimit kryesor të veprimtarisë së shoqërisë, në shërbim të akomodimit dhe trajtimit të*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

studentëve”, theksojmë se struktura organike duhet përcaktuar edhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 24.4.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”. Numri i punonjësve të parashikuar në shoqërinë tuaj, në raportin (1/15) nuk është konform Udhëzimit nr. 7, datë 24.04.2003. Ruajtja e këtij raporti do të ndikonte në uljen e shpenzimeve për vitin 2016 në zërin “Shpenzime për paga”.

Por megjithëse në shkresat e sipërcituara, z. ... thekson se struktura organike e shoqërisë nuk është konform me Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003, në Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës:

-Nr. 01, datë 26.01.2015, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, konfirmuar nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës datë 26.01.2015, ka miratuar numrin e punonjësve 403, numër i cili është më i lartë se raporti i mësipërm (1/12 për vitin 2015).

-Nr. 12, datë 07.12.2015, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, konfirmuar nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës datë 07.12.2015, ka miratuar numrin e punonjësve 404, numër i cili është më i lartë se raporti i mësipërm (1/13 për vitin 2016).

Për këto veprime mban përgjegjësi z. ... në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës.

Nga krahasimi i numrit të strukturës organike të miratuar, me numrin e punonjësve sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”, sipas të cilit raporti punonjës/student duhet të jetë **jo më pak 1/15**, konstatohet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Nr Studentëve	Nr. i Studentëve i planifikuar	Numri i punonjësve sipas Udhëzimit të MAS	Numri i miratuar i punonjësve	Raporti faktik punonjës/student (a/c)	Diferenca (b-c)	Paga mesatare	Efekt Negativ (e*f*12)
		a	b	c	d	e	f	g
1	Viti 2015	4,747	316	403	12	-87	35,394	-36,951,336
2	Viti 2016	5,234	349	404	13	-55	36,227	-23,909,820
	Shuma					-142		-60,861,156

Theksojmë se numri i planifikuar i studentëve, për vitin 2015 dhe për vitin 2016, janë marrë nga:

-Programi ekonomik i vitit 2015, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 17.03.2015, si dhe miratuar nga Ministri i MZHETTS me shkresën nr. 2319/1, datë 15.04.2015. Për Këshillin Mbikëqyrës, Vendimi është firmosur nga z. ..., z. ... dhe znj.

-Programi ekonomik i vitit 2016, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 13.11.2015, miratuar nga Ministri i MZHETTS me shkresën nr. 2313/1, datë 18.04.2016. Për Këshillin Mbikëqyrës, Vendimi është firmosur nga z. ..., z. ... dhe znj.

Ndërsa paga mesatare është përlogaritur duke pjesëtuar fondin e pagave me numrin mesatar të punonjësve, për çdo muaj të vitit. Në fund vlera është nxjerrë duke shumëzuar diferencën në numrin e punonjësve me pagën mesatare dhe me 12 muaj.

Si konkluzion, vlera 60,861,156 lekë, që përbëhet nga shumëzimi i numrit të punonjësve mbi Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003, me pagën mesatare vjetore, **përbën efekt financiar negativ për llogari të shoqërisë RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit**. Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës z. ..., z. ... dhe znj. ..., si dhe znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.

Me Vendimet e mësipërme, Këshilli Mbikëqyrës përveç numrit të punonjësve, ka miratuar dhe nivelin e pagave për punonjësit e shoqërisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

niveli i pagave konstatohet të jetë miratuar vetëm me vendime të Këshillit Mbikëqyrës, pa marrë më parë miratimin e Ministrit të MZHETTS, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, germa a, e cila përcakton se: “1. Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë:

a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.”. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ..., ..., ..., ..., ... dhe

Në përgjithësi numri mesatar i punonjësve ka qenë i barabartë ose më i ulët se numri i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Përfundim bën periudha sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Muaji	Numri i miratuar	Numri mesatar	Diferenca	Paga mesatare	Efekt Negativ
1	Dhjetor 2014	403	404	-1	36,529	-36,529
2	Janar 2015	403	404	-1	37,241	-37,241
3	Shkurt 2015	403	406	-3	35,742	-107,225
4	Prill 2015	403	405	-2	34,901	-69,802
	Shuma			-7		-250,797

Siç konstatohet dhe nga tabela e mësipërme, për muajt Dhjetor 2014, Janar, Shkurt dhe Prill 2015, numri mesatar i punonjësve është më i lartë se numri i miratuar me vendime të Këshillit Mbikëqyrës. Nga tejkalimi i strukturës organike, **janë rënduar kostot e shoqërisë në vlerën 250,797 lekë**, vlerë e cila për shoqërinë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” Sha, Tiranë, **përbën efekt financiar negativ për llogari të shoqërisë RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit**. Për këtë veprim mban përgjegjësi znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.

Për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, në RSU1 janë punësuar gjithsej 58 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme (dorëheqje, pension shkelje) 69 punonjësve.

Për punonjësit e larguar, të cilët nuk kanë pranuar arsyet e largimit, u janë drejtuar gjykatave. Nga proceset gjyqësore të përfunduara për punonjësit të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës, deri më datë 31.12.2016, RSU1 ka paguar vlerën **63,950,316 lekë për 85 punonjës, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ llogari të shoqërisë RSU1 dhe Buxhetit të Shtetit**.

Nga kjo vlerë, theksojmë se **vlera 4,346,207 lekë, përbëhet nga shpenzime përmbartimore**, për arsye se punonjësit të cilët i fitojnë gjyqet kanë ndjekur përmbartimin për ekzekutimin e vendimit.

Nëse e ndajmë vlerën e mësipërme sipas periudhave, konstatojmë se:

-**Vlera 3,587,018 lekë**, është paguar për periudhën 01.10.2014-31.12.2016, në favor të ish-drejtorit të përgjithshëm z. ..., i cili ka fituar gjyqin me Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 193, datë 02.03.2006, dhe pagesat vazhdojnë të kryhen rregullisht, deri në kohën e sistemimit në vendin e mëparshëm të punës.

-**Vlera 3,078,986 lekë**, përbën pagesën sipas vendimit të gjykatave për 4 ish-punonjës të larguar në periudhën 10.02.2013-20.09.2013. Për këtë vlerë, mban përgjegjësi z. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën deri më 20.09.2013.



-Vlera 57,284,312 lekë, përbën pagesën sipas vendimit të gjykatave për 80 ish-punonjës të larguar në periudhën 16.10.2013-14.01.2015. Për këtë vlerë, mban përgjegjësi znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën 20.09.2013 e në vazhdim.

Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga RSU1 të vendimeve të gjykatave, për dëshmperblimet, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, konstatohet se pothuaj të gjithë vendimet janë në favor të punonjësve të larguar (vetëm një në favor të shoqërisë), duke cënuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomik-financiar, duke qenë se **vlera 63,950,316 lekë, e paguar si pasojë e vendimeve të gjykatave, përbën afërsisht 25% të të gjithë të ardhurave vjetore të shoqërisë** (*mesatares së viteve 2014-2016, pa përfshirë të ardhurat nga subvencionet*). Përveç vendimeve të formës së prerë, sipas informacioneve të marra nga drejtoria juridike e shoqërisë, konstatohet se janë edhe 3 procese gjyqësore për dëshmperblim page që po zhvillohen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe 8 çështje që po presin gjykimin në Gjykatën e Apelit, çka në të ardhmen mund të shkaktojnë rëndim të situatës financiare të shoqërisë.

Në lidhje me proceset gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë (Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë), grupi i auditimit verifikoi me zgjedhje 10 prej tyre. Nga këto 10 vendime, u konstatua se për 2 prej tyre, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesve të RSU1, duke mos e ndjekur çështjen në gjykatë.

Nga auditimi u konstatua se shoqëria nuk ka detyrime për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi, konfirmuar kjo dhe nga llogaria e shoqërisë në faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (www.tatime.gov.al).

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave e shpërblimeve, sqarojmë se observacioni nuk është i argumentuar nga ana dokumentare dhe ligjore, për pasojë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me argumentet si më poshtë:

Së pari, pretendimi juaj mbi tejkalimin e strukturës organike nuk qëndron, për arsye se grupi i auditimit i mori këto të dhëna nga listë-pagesat mujore dhe të dhënat mbi emërimet dhe largime, e në përfundim ka konstatuar se është tejkaluar struktura e miratuar për periudhën e cituar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, sqaruar kjo dhe në përgjigjet e observacioneve të dërguara nga ju për Procesverbalin nr. 10, datë 24.02.2017.

Së dyti, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me numër mesatar vjetor të propozuar në Programin Ekonomik vjetor, por me numrin e punonjësve në strukturën e shoqërisë, të miratuar me vendime të ndryshme të Këshillit Mbikëqyrës.

Së treti, pretendimi juaj respektin e procedurave ligjore në largimet e punonjësve nuk qëndron, për arsye se gjykata me vendime të ndryshme, kanë cilësuar se këto largime nuk janë kryer në përputhje me Kodin e Punës.

Së katërti, pretendimi juaj mbi mos zbatimin e Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”, nuk qëndron për arsye se është një Akt nënligjor i cili është akoma në fuqi, e për pasojë është i detyrueshëm për zbatim nga ana juaj.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, dërguar nga z. ... në cilësinë e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, sqarojmë se observacioni nuk është i argumentuar nga ana dokumentare dhe ligjore, për pasojë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me argumentet si më poshtë:



Së pari, pretendimi juaj se Udhëzimi nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”, është jokohorent, nuk qëndron për arsye se është një Akt nënligjor i cili është akoma në fuqi, e për pasojë është i detyrueshëm për zbatim nga ana juaj.

Së dyti, në shkresat dërguara nga ju me objekt “Mendim në lidhje me projektprogramet e zhvillimit të shoqërive anonime të “Trajtimit të Studentëve”” për vitet 2015 dhe 2016, ju citoni se struktura e kërkuar nga shoqëria është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 24.04.2003.

Së treti, pretendimi juaj mbi tejkalimin e strukturës organike nuk qëndron, për arsye se grupi i auditimit i mori këto të dhëna nga listë-pagesat mujore dhe të dhënat mbi emërimet dhe largime, e në përfundim ka konstatuar se është tejkaluar struktura e miratuar për periudhën e cituar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me numër mesatar vjetor të propozuar në Programin Ekonomik vjetor, por me numrin e punonjësve në strukturën e shoqërisë, të miratuar me vendime të ndryshme të Këshillit Mbikëqyrës.

Së treti, pretendimi juaj respektin e procedurave ligjore në largimet e punonjësve nuk qëndron, për arsye se gjykata me vendime të ndryshme, kanë cilësuar se këto largime nuk janë kryer në përputhje me Kodin e Punës.

Së katërti, pretendimi juaj në lidhje me miratimin e nivelit të pagës nga Këshilli Mbikëqyrës, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, germa a, e cila përcakton se: “1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës;”.

V. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të shoqërisë.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

“Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA, ka si objekt të veprimtarisë ekonomike, trajtimin me fjetore dhe mensa i studentëve, prodhimin dhe furnizimin me avull për ngrohje të gjithë ambienteve të ndërmarrjes edhe për të tretë, furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të papërdorura të Qytetit Studenti, pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të Qytetit të Studentit, krijimin e kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi, shërbim bibliotekar dhe social për studentët, dhe veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qira të ambienteve subjekteve të ndryshme private.

Janë audituar pasqyrat financiare të cilat përfshijnë bilancin kontabël për vitin ushtrimor 2014-2015, pasqyrave e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrat e ndryshimit të kapitalit, fluksi i parave dhe shënimet shpjeguese për këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare (bilanci) janë përgatitur në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2. Veprimet e kryera dokumentohen dhe regjistrohen në librat e kontabilitetit në përputhje me parimet e SKK-ve.

Shërbimi kontabël në shoqëri, realizon regjistrimet e veprimeve kontabël në Excel, dhe jo me program kompjuterik financiar, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimin të veprimeve kontabël. **Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e llogarisë kontabël bëhet duke u bazuar në dokumentacionin përkatës kontabël.

Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë mbajtur dhe plotësuar në mënyrë kronologjike, si ditarët e arkës, bankës, magazinës etj., duke zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit në zbatim të akteve ligjore e nënligjore.

Nga auditimi konstatohet se, pagesat e kryera nga studentët që gjenerojnë të ardhura për strehimin e tyre në rezidenca, procedohet duke plotësuar mandat arkëtimet që në fillim të vitit arsimor (në muajin tetor), dhe efektet reflektohen në bilancin kontabël në mbyllje të llogarive vjetore. Nga auditimi konstatohet se, pagesat e kryera nga studentët që gjenerojnë të ardhura për strehimin e tyre në rezidenca ne pjesën me te madhe te tyre janë pagesa te plota për gjithë vitin akademik dhe pjesa tjetër pagesa pjesore. Raportimet e te ardhurave nga financa, janë bërë bazuar në mandat arkëtimet përkatëse, duke i pasqyruar si të ardhura të vitit ushtrimor të gjitha pagesat që kryen në muajt Janar-Shtator dhe për periudhën Tetor-Dhjetor llogarit dhe bën ndarjen e te ardhurave për shumën qe i takon vitit ushtrimor dhe pjesën tjetër të parapaguar si të ardhur të shtyrë për vitin pasardhës.

Të ardhurat e shtyra në vitet 2014-2015 janë sa më poshtë vijon:

Të ardhura të shtyra nga viti 2014 për llogari të vitit 2015 janë 114,948,400 lekë.

Të ardhura te shtyra nga viti 2015 për llogari të vitit 2016 janë 92,750,860 lekë.

Për të ardhurat e realizuar është plotësuar dokumentacioni për arkëtimin e tyre, dhe janë të regjistruara në kontabilitet gjatë vitit. *Për të ardhura që realizohen nga dhënia me qira e ambienteve si edhe nga akomodimi i studentëve, “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA është një shoqëri aksionare, nuk aplikon fatura tatimore për shërbimet që kryhen, megjithëse është lënë detyrë dhe grupi i auditimit të mëparshëm të KLSH-së.*

Kapitali i rregjistruar në vitin 2015, është në vlerën 7,976,136,000 lekë, dhe zotërohet tërësisht nga Aksioneri i vetëm (MZHETS).

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 335, datë 04.05.2016 për “Transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionere “Rezidenca Studentore nr. 1” sha., “Trajtimi i Studentëve nr. 2” sha dhe “Trajtimi i Studentëve nr. 3” sha, nga MZHETTS te Bashkia Tiranë, si dhe shkresës të Bashkisë me nr. Prot. 14095/3, datë 01.06.2016 “Për ndryshimin e aksionerit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” sha, shoqëria ka kryer veprimet ne QKB dhe ndryshimet janë pasqyruar në ekstraktin e regjistrimit tregtar.

Bilanci i vitit 2014.

Në zbatim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transferimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës nr 315, datë 8.04.2009 “Mbi programet ekonomike të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” si dhe në statutin e Shoqërisë, Departamenti Ekonomike ka përfunduar në datën 20.03.2015, bilancin vjetorë për vitin 2014, të shoqëruar me relacionin përkatës është miratuar në Këshillin Mbikqyrës me vendimin nr. 6 datë 30.06.2015 “ Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2014”, dërguar me shkresën nr. 309 prot., datë 30.03.2015, pranë Degës Rajonale të Tatimeve, Tiranë.

Miratimi i bilancit të vitit 2014, për Sh.a “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, është bërë nga MZHETTS, me shkresën nr. 5578/1 datë 30.07.2015, në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është miratuar humbja e ushtrimit nga aktiviteti në vlerën 11,266,315 lekë, që do të mbartet në bilancin kontabël të vitit 2015.

Bilanci i vitit 2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Departamenti Ekonomik i shoqërisë ka përfunduar bilancin vjetor në datën 30.03.2016, është miratuar në Këshillin Mbikqyrës me vendimin nr. 03, datë 06.06.2016 “Për miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2015”, dërguar me shkresën Nr. 324 Prot., datë 31.03.2016, pranë Degës Rajonale të Tatimeve Tiranë.

Miratimi i pasqyrave financiare të vitit 2015, për Sh.a “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, Tiranë, është bërë nga Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 1, datë 30.09.2016, në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, është miratuar humbja e ushtrimit nga aktiviteti në vlerën 55,428,725 lekë, që do të mbartet në bilancin kontabël të vitit 2016.

Me shkresën nr. 611, datë 22.01.2015 të MZHETTS, është bërë miratimi i dy ekspertëve kontabël të autorizuar ... dhe ..., për kontrollin dhe çertifikimin e llogarisë vjetore 2014, ku është kërkuar që të dorëzohet në MZHETTS-es jo vetëm raporti standard por dhe relacion shpjegues për të gjithë zërat e Bilancit dhe sugjerimet e tyre për vështirësitë financiare të shoqërisë.

Në shkresën me Nr. 176, datë 20.03.2015, është lidhur kontratë shërbimi “Mbi auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2014” midis shoqërisë “RSU Nr. 1 sha” dhe ekspertëve kontabël, ku është përcaktuar programi i punës dhe vlera në shumën 900,000 lekë pa t.v.sh.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, në përfundim të kontrollit të llogarive për vitin 2014, ekspertët kontabël të autorizuar, kanë dorëzuar një raport të zgjeruar mbi auditimin e pasqyrave financiare të “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, sha, Tiranë, me nr. prot. 534, datë 04.06.2016. Nga verifikimi i veprimeve me bankë konstatohet se, pagesat janë bërë në datën 13.10.2015 në BKT, bazuar në dokumentacion shoqërues si, kontrata e misionit të auditimit, letra e angazhimit, dhe faturat tatimore e shitjes për të dy ekspertët e kontraktuar.

Nga auditimi i Bilancit të vitit 2014 mbi rekomandimin e lënë nga grupi i KLSH mbi llogaritjen dhe kontabilizimin drejt të detyrimit ndaj buxhetit të shtetit, për të ardhurat nga kontratat për objektet me qira u konstatua se janë reflektuar në bilanc shumat e detyrimit përkatësisht për vitin 2012 vlera 1,991,995 lekë dhe për vitin 2013 vlera 1,739,529, pra në total shuma 3,731,524 lekë.

Me shkresën Nr. 9183 Prot, datë 27.11.2015 të MZHETTS, është bërë miratimi i dy ekspertëve kontabël të autorizuar ... dhe ..., për kontrollin dhe çertifikimin e pasqyrave financiare viti 2015, ku është kërkuar që të dorëzohet në MZHETTS jo vetëm raporti standard por dhe relacion shpjegues për të gjithë zërat e Bilancit dhe sugjerimet e tyre për vështirësitë financiare të shoqërisë. Me shkresën Nr. 12 Prot, datë 12.01.2016, është lidhur kontratë shërbimi “Mbi auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2015” midis shoqërisë “RSU Nr. 1 sha” dhe ekspertëve kontabël, ku është përcaktuar programi i punës dhe vlera në shumën 900,000 lekë pa t.v.sh. Raporti i ekspertëve është i zgjeruar dhe është dorëzuar në shoqëri me nr. 509/1 Prot., datë 25.05.2016.

Nga auditimi i bilancit të vitit 2014-2015, u konstatua se, çeljet e llogarive në fillim të vitit përputhen me gjendjet e llogarive në fund të vitit, në zbatim të parimit të vijueshmërisë së veprimeve kontabile, duke aplikuar metodën e regjistrimit ditari dhe partitari dhe centralizator përmbledhës.

Nga verifikimi i pozicioneve të llogarive, gjendjet e llogarive kontabël paraqiten si më poshtë:

Gjendja e Aktivit në bilancet për vitet 2014-2015.

Totali i Aktivit në bilancin e viti 2014 të shoqërisë është në vlerën 8,312,910,950 lekë dhe në vitin 2015, vlera e aktiveve në total është 8,258,177,981 lekë, pra me një ulje në vlerën 54,732,969 lekë në krahasim me një vit më parë.

Gjendjet e llogarive sipas zërave të pasqyrave financiare të paraqitura në aktiv janë si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Gjendja e aktiveve monetare, më datën 31.12.2014 dhe 31.12.2015, në arkë dhe bankë, në lekë dhe valutë, janë si më poshtë:

Tabela nr. Gjendja e aktiveve monetare, vitet 2014-2015 në/lekë

Emërtimi	2015	2014
Banka	27,918,541	45,776,968
Arka	0	0
Shuma aktivet monetare	27,918,541	45,776,968

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Sipas tabelës, gjendja e llogarive të likuiditeteve në bankë në vitin 2015, janë ulur në krahasim me vitin 2014. Gjendja e mjeteve monetare të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit dhe konfirmohen me nxjerrjen e llogarive bankare dhe inventarët fizike të monedhave. Veprimet e pagesave shoqëria, në vitin 2014-2015, i ka kryer me BKT në lekë dhe valutë dhe me Veneto Bankë në lekë, dhe me Tirana Bank në lekë, dhe konferma të lëshuara nga këto bankat në fund të vitit konfirmojnë se janë të njëjta me gjendjen e mbetur në fund të viteve 2014, 2015. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, për efekt të pasqyrimin në bilanc janë konvertuar, në bazë të kursit të këmbimit në fund të vitit ushtrimor 2014 dhe 2015, të Bankës së Shqipërisë.

-Gjendja e aktiveve të tjera afatshkurtra, të drejta të arkëtueshme, më datë 31.12.2014 dhe 31.12.2015, të cilat përfaqësojnë kërkesat e arkëtueshme për shoqërinë janë si më poshtë:

Aktive të tjera financiare afatshkurtra, 2014 dhe 2015. Në/lekë

Emërtimi	2015	2014
Klientë për mallra produkte e shërbime	2,493,192	432,820
Te tjera nga persona dhe personeli	7,607	51,410
Shuma të drejta të arkëtueshme	2,500,799	484,230

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Sipas të dhënave të tabelës, konstatohet se në vitin 2015, janë shtuar të drejtat e arkëtueshme, duke i krahasuar me vitin 2014, janë me rritje në vlerën 2,016,569 lekë, përkatësisht:

-Në llogarinë “Të drejta të arkëtueshme”, shumat e paraqitura përfaqësojnë tepricat debitore të kërkesave për klientë, nga qiratë e familjarëve dhe klientë për objekte me qira, përkatësisht gjendja në datë 31.12.2014, është në shumën 432,820 lekë, e përbërë nga klientët familjarë në shumën 385,500 lekë dhe klientë të objekteve me qira në shumën 47,320 lekë që përfaqësojnë detyrimet të paarkëtuara dhe të krijuara gjatë vitit 2014, si: Detyrimi nga qiratë e familjarëve në shumën 385,500 lekë, përbëhet nga detyrimi i pa derdhur brenda vitit 2014 nga 29 familjarë, por që është likuiduar në vitin 2015. Detyrimi i objektit me qira në shumën 47,320 lekë është derdhur në vitin 2015.

-Në llogarinë “Të drejta të arkëtueshme”, shumat e paraqitura përfaqësojnë tepricat debitore të kërkesave për klientë, nga qiratë e familjarëve dhe klientë për objekte me qira, përkatësisht gjendja në datë 31.12.2015, është në shumën 2,493,192 lekë, e përbërë nga klientët familjarë në shumën 2,491,320 lekë dhe klientë të objekteve me qira në shumën 1872 lekë që përfaqësojnë detyrimet të paarkëtuara dhe të krijuara gjatë vitit 2015, përkatësisht:

-Detyrimi nga qiratë e familjarëve në shumën 2,491,320 lekë, përbëhet nga detyrimi i pa derdhur brenda vitit 2015 nga 128 familjarë, por që është likuiduar në vitin 2016 shuma 2,026,500 lekë ku mbetet Gjendja në 31.12.2016 shuma 464,820 lekë.

Kjo vlerë është pa shpresë arkëtimi pasi janë një kategori familjesh me probleme sociale.

Detyrimi i objektit me qira (kamatë vonesë) në shumën 1,872 lekë është derdhur në vitin 2016.

Në zbatim të detyrave të lëna nga grupi i KLSH mbi llogaritjen e provizioneve për llogarinë “Klient për mallra, produkte e shërbime” pa shpresë arkëtimi, kjo detyrë është reflektuar në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Bilancin e vitit 2014 ku konkretisht janë llogaritur provizione për klientë familjarë pa shpresë arkëtimi në shumën 2,851,615 lekë dhe provizione për klientë të objekteve me qira në shumën 349,646 lekë

II Aktive te tjera financiare afatshkurtra		Viti 2015	Viti 2014
(i)	Klientë për mallra e shërbime	2,493,192	3,634,081
	Provizione, Klientë me qira ne godinat familjare	0	(2,851,615)
	Provizione, klientë nga objektet me qira	0	(349,646)
(ii)	Tatimi mbi fitimin	0	736,400
	Provizione, për tatim fitimin	0	(736,400)
(iii)	Të drejta dhe detyrime për zhdëmtim	7,607	51,410
Totali 2		2,500,799	484,230

Nga auditimi i kryer konstatohet se,departamenti ekonomik merr të dhënat për kontratat e lidhura për qiratë nga familjarët, bazuar në informacionin e dërguar nga sektori Juridike dhe Drejtoria e Shërbimeve Studentore, të cilët e përcjellin nëpërmjet protokollit rast pas rasti. Kuadrimi ndërmjet tyre bëhet çdo muaj, për përcaktimin e saktë të debitorëve nga qiratë për familjarët. Ky informacion përcillet te drejtori i përgjithshëm me qëllim marrjen e masave për të ndjekur arkëtimin e detyrimeve debitorëve nga familjarët.

-Gjendja e Inventarit.

Gjendja e inventarit në fillim dhe në fund të ushtrimit 2014-2015: në/lekë

Emërtimi	2015	2014
Lëndët e para	12,055,056	14,240,309
Shuma e Inventarit	12,055,056	14,240,309

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Sipas të dhënave të tabelës, konstatohet se gjendjet e inventarit në vitin 2015, janë më të ulëta në krahasim me vitin 2014. Vlerat e inventarit në lëndë të parë, të paraqitura më sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit. Nga shoqëria janë bërë inventarizimet gjatë çdo viti ushtrimor.

Ky zë përbëhet nga materiale elektrike hidraulike, ndërtimi marangozërie, detergjentë.

-Aktivet afatgjata

Gjendja dhe lëvizja e aktive afatgjata materiale për vitet 2014 dhe 2015, sipas pasqyrave financiare paraqiten si vijon:

Gjendja dhe lëvizja e aktive afatgjata materiale për vitet 2014 dhe 2015 në lek

Aktivet materiale		2014	2015
1	Toka	6,661,102,846	6,661,102,846
2	Ndërtesa	1,361,618,347	1,381,804,604
3	Rrugë të brendshme	18,013,257	18,961,323
4	Instalime nëntokësore, makineri e pajisje	31,780,924	32,429,514
5	Makineri pajisje, kaldaja	102,525,843	107,745,083
6	Mjete transporti	1,568,640	1,960,800
7	Inventar ekonomik	18,428,802	22,918,421
8	Pajisje Informative	584,939	717,650
9	Aktive të tjera afatgjata, pyjet plantacionet	4,427,130	4,633,923
10	Inventar i imët	14,036,247	18,518,669
Totali - aktivet afatgjata		8,214,086,975	8,250,792,833



Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Bazuar në të dhënat e tabelës konstatohet se vlerat dhe klasifikimi në nëngrupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc, janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe inventarizimeve fizike që shoqëria ka kryer në fund të muajit dhjetor 2014 dhe 2015. Për kontabilizimin e vlerave të AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostove, ku vlerat fillestare në momentin e marrjes në inventar janë bërë me kostot e marrjes. Në datat e mbylljes së bilancit, vlerat e AAM-të janë pasqyruar me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Rivlerësimi i aseteve me vlerën e drejtë të tyre është bërë në vitin 2004, kur është kryer transformimi nga ndërmarrje shtetërore në shoqëri anonime.

Gjatë vitit 2015, aktive afatgjata materiale kanë patur ndryshime përkatësisht, shtesa në AAM-ve në shumën 5,348,318 lekë dhe pakësim nga amortizimi dhe daljet jashtë përdorimit në shumën 16,934,806 lekë.

Aktivet afatgjata materiale (AAM) paraqiten me shuma të rivlerësuara minus amortizimin. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e vlerës së mbetur të aktiveve afatgjata materiale, duke ngarkuar pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë.

Normat e aplikuara për vitin 2014 e 2015 janë si më poshtë:

a. Ndërtesa	1.8 %
b. Instalime teknike dhe makineri	2.0 %
c. Mjete transporti	20.0 %
d. Paisje zyre	20.0 %
e. Paisje informatike	25.0 %
f. Instalime nëntokesore	2.0 %
g. Kaldaja	3.7 %

Normat e mësipërme të amortizimit janë përcaktuar nga drejtimi në bazë të VKM Nr. 401, datë 23.10.1989 (i ndryshuar), pjesa ”Për amortizimin e ndërtesave dhe instalimet e përgjithshme”, ndërsa për të gjitha grupet e tjera të AQT-ve sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar) ”Për tatimin mbi të ardhurat”.

Për këto norma nuk ka një vendim të Këshillit Mbikëqyrës por janë të përfshira në informacionin që i dërgohet për aprovimin e programit ekonomik. Nëse drejtimi do të përdorte normat fiskale vlera e shpenzimeve të amortizimit do të ishte dy herë më e madhe se sa vlerat aktuale.

Mospërdorimi i normave fiskale ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë duke i ulur shpenzimet e shoqërisë me rreth 40,000,000 lek në vit dhe si rrjedhim rritjen e rezultatit. Përdorimi i këtyre normave ka sjellë një shtrembërim të zërave të aktiveve afatgjata. Shoqëria ka në asetet e saj impiantin e kaldajave e cila në bilanc vlerën 102,525,843 lekë, vlerë kjo dhe pas rivlerësimeve të kryera. Ky impiant ka rreth 25 vjet, është i amortizuar dhe ka 5 vite që nuk përdoret për arsye se nuk është eficient dhe jashtë normave.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, Gjendja në llogarinë “Aktive afatgjata jo material”, në shumën 1,616,610 lekë, përfaqëson vlerën e projektit për rikonstruksion e godinës nr. 15 dhe për ndërtimin në ujësjellës kanalizime të Qytetit Studenti, projekte të cilat nuk janë vënë në zbatim. Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga grupi i KLSH në bilancin e vitit 2014 nga shoqëria është bërë sistemimi i veprimit të amortizimit të këtij zëri dhe ky zë paraqitet në aktiv me vlerën fillestare të tij.

Gjendja e Pasivit të bilancit për vitit 2014-2015.

Llogaritë pasive të bilancit dhe gjendja e tyre në fund të viteve ushtrimor, janë si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Gjendja e detyrimeve afatshkurtra

Saldot e detyrimeve në fund të vitit ushtrimor 2014-2015, janë në tabelën e mëposhtme:

Saldot e detyrimeve në fund të vitit ushtrimor 2014-2015

Emërtimi	2015	2014
Detyrime afatshkurtra:	94,957,892	66,540,847
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	85,540,418	56,391,208
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>	3,947,797	4,172,034
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	4,056,007	4,677,605
<i>Të tjera të pagueshme</i>	1,413,670	1,300,000
Të ardhura të shtyra	92,893,360	115,414,853
<i>Të ardhura të shtyra</i>	92,893,360	115,414,853
Totali i detyrimeve afatshkurtra	187,851,252	181,955,700

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Bazuar në të dhënat e tabelës, konstatohet se totali i detyrimeve afatshkurtër në fund të vitit 2015, është në shumën 187,851,252 lekë, në krahasim me gjendjen në fund të vitit 2014, kanë një rritje në vlerë 5,895,552 lekë. Analiza analitike e detyrimeve afatshkurtra është si më poshtë:

-Gjendja në llogarinë “Detyrime të pagueshme ndaj furnitorëve”, në fund të vitit 2015, është në shumën 85.4 milion lekë, dhe në vitin 2014, është në shumën 56.3 milion lekë, pra janë rritur detyrimet e shoqërisë të papaguara ndaj furnitorëve në masën 52%, me një vlerë prej 29.1 milion lekë. Nga auditimi i kryer konstatohet se, shumica e detyrimeve ndaj furnitorëve ka ardhur duke u rritur në krahasim me vitet e kaluara, kryesisht detyrimet për energji elektrike, dhe nga rritja e çmimeve të ujit.

Më 31.12.2015, gjendja e detyrimeve ndaj furnitorëve në shumën 85,540,418 lekë, në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

-në shumën 24,972,594 lekë, janë detyrime për energji elektrike ndaj OSHEE bazuar në aktrakordimet;

-në shumën 34,647,670 lekë, janë detyrime për ujin ndaj UKT-së;

-në shumën 6,992,897 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për investime;

-në shumën 13,662,843 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për furnizime materiale të ndryshme;

-në shumën 5,264,414 lekë, detyrime të papaguara ndaj furnitorëve për shërbime të ndryshme

-Gjendja e llogarisë “Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore”, në vitin 2015 është në shumën 3,947,797 lekë, në krahasim me vitin 2014, është 224,237 lekë më pak. Këtu përfshihen detyrimet për sigurimet shoqërore/shëndetësore të muajit Dhjetor 2015 në shumën 3,932,193 lekë të cilat janë paguar në Janar 2016 dhe detyrime të tjera personeli në shumën 15,604 lekë.

Nga auditimi i kryer mbi rekomandimin e lënë nga grupi i KLSH mbi parashkrimin e detyrimeve të pa kërkuara nga ISKSH që nga viti 2004, kjo detyrë është realizuar dhe është pasqyruar në Bilancin e vitit 2014 në shumën 985,679 lekë.

-Gjendja e llogarisë “Detyrime tatimore për TAP-in”, në fund të viteve 2014 - 2015, janë përkatësisht në shumën 386,170 dhe 344,508 që përfaqësojnë detyrimet e muajit Dhjetor të viteve respektive.

-Gjendja në llogarinë “Të drejta dhe detyrime të tjera”, në vitin 2015, janë në shumën 1,413,670 lekë, përfaqësojnë siguracionin e derdhur nga studentët që banojnë në hotele si garanci të likuidimit të plotë të detyrimit të qirasë ose të dëmtimeve të bazës materiale.

-Gjendja në llogarinë “Kreditorë të tjerë”, që përfaqëson detyrimin e shoqërisë për objektet me qira ndaj shtetit, në fund të vitit 2015, është në shumën 3,711,499 lekë, rezulton me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

zbritje të detyrimit në krahasim me vitin 2014, në vlerë prej 579,936 lekë. Detyrimi në shumën 3,711,499 lekë, përfshin detyrimet e vitit 2012-2013.

Për vitin 2015 e në vazhdim shoqëria nuk llogarit detyrim për objektet me qira. Kjo në zbatim të VKM Nr. 735, datë 5.11.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VII-të, pika 6 “ Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira ose enfitozë e pasurive në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, Autoritetit Portual, Durrës, dhe Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve” të përdoren prej tyre për të mbuluar shpenzimet e veta.

Llogaria Detyrime afatgjata

Gjendja e llogarisë “Detyrimet afatgjata”, në fund të vitit ushtrimor 2014-2015, paraqiten si vijon:

;Gjendja e llogarisë “Detyrimet afatgjata”

Emërtimi	2015	2014
1. Grantet dhe te ardhurat e shtyra	98,796,122	103,995,918
Totali- DETYRIMET AFATGJATA	98,796,122	103,995,918

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Sipas të dhënave në tabelës, gjendja në fund të vitit 2015, në llogarinë “Grandet dhe të ardhurat të shtyra”, rezulton të jetë më e ulët në krahasim me vitin 2014, pasi është pakësuar nga rimarrja si e ardhur nga amortizimi i fondit për subvencion për investime të kryera para vitit 2004.

-Gjendja e llogarisë “Kapitali”, për vitet 2014 dhe 2015, është si në tabelën më poshtë:

Gjendja e llogarisë “Kapitali”

Emërtimi	2015	2014
Kapitali aksionar	7,976,136,000	7,976,136,000
Rezerve rivlerësimi	208,273,341	208,273,341
Rezervat e tjera	2,048,469	2,048,469
Fitime të pa shpërndarë (humbje)	(159,498,478)	(148,232,163)
Humbje e vitit ushtrimor	(55,428,725)	(11,266,315)
Totali-KAPITALI	7,971,530,607	8,026,959,332

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Bazuar në të dhënat e tabelës, rezulton se në vitin 2015, gjendja e kapitalit të shoqërisë është në vlerën 7,971,530,607 lekë, në krahasim me vitin 2014, rezulton të jetë zvogëluar në vlerën 55,428,725 lekë, nga ndikimi i humbjes së vitit ushtrimorë të shoqërisë.

Në mënyrë analitike kapitali i shoqërisë paraqitet si poshtë:

-Gjendja e llogarisë “Kapital Aksionar” për shoqërinë në vlerën 7,976,136,000 lekë, në vitin 2015 e 2014 është i njëjtë më atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKT, i ndarë me kuota në shumën 7,976,136 lekë me vlerë nominale 1,000 lekë.

-Gjendja e llogarisë “Rezerva nga rivlerësimi”, në vitet 2014 dhe 2015, është në vlerën 208,273,341 lekë, është i njëjtë me vlerën e përcaktuar që në fillim.

-Gjendja e llogarisë “Rezerva të tjera”, në vlerën 2,048,469 lekë, është i njëjtë në vlerë në vitin 2014 dhe 2015.

-Gjendja në llogarinë “Fitime e pashpërndara”, në vitin 2014, humbje të mbartura është në vlerën 148,232,163 lekë, që përfaqëson humbjet e shoqërisë në vitet të mëparshme dhe në vitin 2015, humbja është në vlerën 55,428,725 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Gjatë vitit 2015, humbja nga aktiviteti i shoqërisë është thelluar më shumë në krahasim me vitin 2014, për një vlerë prej 44,162,410 lekë ose në masën 392 %.

Nga auditimi i kryer në lidhje me pasqyrimin e të dhënave në pasqyrat financiare që shoqërojnë bilancet kontabël në mënyrë analitike janë si më poshtë:

-Fitimi/humbja e vitit ushtrimor.

Rezultati financiar i vitit përcaktohet nga diferenca e të ardhurave të realizuara dhe mbulimi i shpenzimeve të kryera nga aktiviteti i shoqërisë. Të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë të realizuara për vitin ushtrimor 2014-2015, në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e te Ardhurave dhe shpenzimeve, viti 2014-2015

Përshkrimi i Elementeve	2015	2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	229,138,647	256,073,167
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	(161,170,457.3)	(162,219,253)
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	(156,279,426.4)	(157,372,865)
<i>Të tjera shpenzime</i>	(4,891,030.9)	(4,846,388)
Shpenzime të personelit	(200,409,682)	(208,113,938)
<i>Paga dhe shpërblime</i>	(172,120,924)	(178,781,831)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>	(28,288,758)	(29,332,107)
Shpenzime amortizimi	(40,919,113)	(43,786,334)
Të ardhura të tjera	161,321,096	164,907,301
<i>Të ardhura nga subvencioni i ushtrimit</i>	155,519,178	156,020,458
<i>Të ardhura nga rimarrjet e amortizimit nga fondi subvencione për investime</i>	5,199,796	5,452,780
<i>Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur</i>	602,122	3,434,063
Shpenzime financiare	(43,389,216)	(18,127,258)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>	(43,389,216)	(18,127,258)
Fitimi/Humbja para tatimit	(55,428,725)	(11,266,315)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	0	0
Fitimi/Humbja e vitit	(55,428,725)	(11,266,315)

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH.

Vlera 43,389,2016 lekë është shuma e vlerës 39,269,000 lekë pagesa për përmbaruesit në bazë të vendimeve të gjykatave për punonjësit e larguar nga puna dhe 4,120,216 lekë, pagesa të kamatëvonesave për faljen e gjobave në sistemin e tatimeve, datë 14.07.2015.

Bazuar në të dhënat e tabelës, konstatohet se të ardhurat nga shitja në fund të vitit 2014, janë në shumën 256,073,167 lekë, që përfaqësojnë të ardhurat nga akomodimi i studentëve për strehim, nga të ardhurat e qirave nga familjarët, të ardhurat nga qiradhënia e objekteve, të ardhurat nga shërbimi i lavanderisë dhe sallave të lojërave, të ardhurat nga shërbimi për vërtetime, të ardhura nga hoteleria, e **të ardhura të tjera.**

Nr	Emërtimi i të ardhurave nga aktiviteti viti 2014	Vlera(në lekë)
1	Të ardhura nga akomodimi studenti	212,597,932
2	Të ardhura nga akomodimi hoteli	18,561,791
3	Të ardhura nga objektet me qira	1,208,594
4	Të ardhura nga qiratë familjare	22,244,000
4	Minilavanteri dhe te tjera	1,460,850
	Shuma	256,073,167

-Shpenzimet e veprimtarisë kryesore në vitin 2014

Nr	Emërtimi i shpenzimeve viti 2014	Vlera (në lekë)
1	Blerje materiale te para	8,629,162
2	Ndryshimi i gjendjeve materiale konsumi	500,314



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

3	Blerje energji (OSHEE)	89,596,718
4	Blerje ujë (UKT)	58,646,670
5	Te ndryshme (eksp kontabël, dezinfektim etj)	3,622,391
	Pagesa e eksperteve kontabël	1,440,000
	Projekti i investimit ne godinat familjare	120,000
	Dezinfektim Deratizim	792,126
	Ushqimi i studenteve te huaj urdhri i MAS	478,280
	Sigurimi TPL i mak dhe regjistrimi ne QRA	61,000
	Lyerje meremetime, avolzhim dhe te tjera	730,985
6	Personel i jashtëm (Këshilli Mbikqyrës)	947,880
7	Poste telekomunikacion	192,468
8	Komisione bankare	40,686
9	Pagat e personelit	176,724,092
10	Shpenzime page (raporte)	1,508,207
11	Shpenzime page (shpërblim leje dhe te tjera)	549,532
12	Sigurime shoqërore	29,332,107
13	Taksa vendore	42,964
14	vendime gjykate (...)	1,484,412
15	Humbje për mos arkëtim klient	3,937,661
16	Amortizimi AQ	43,786,334
17	Shpenz. Penalitete, vendime gjykate, gjoba	10,122,560
	Shuma	429,664,159

Humbje për mos arkëtim klientësh në vlerën 3,937,661 lekë është e përbërë nga, provizione për klientët familjar pa shpresë arkëtimi të viteve 2012-2013 në vlerën 2,851,615 lekë, provizione për klientë të objekteve me qira viti 2013 në vlerën 349,646 lekë, detyrim i derdhur tepër në Buxhetin e Shtetit i mbartur që nga viti 2004 në shumën 736,400 lekë. Aplikimi i këtyre provizione është lënë si rekomandim në raportin e fundit të KLSH dhe është miratuar nga strukturat drejtuese të shoqërisë.

Të ardhurat në vitin 2015 janë në shumën 229,138,647 lekë duke pasur një ulje nga viti 2014 në vlerën 26,934,520 lekë.

Nr	Emërtimi i të ardhurave nga aktiviteti viti 2015	Vlera (në lekë)
1	Të ardhura nga akomodim studenti	183,995,980
2	Të ardhura nga akomodim hoteli	19,339,943
3	Të ardhura nga objektet me qira	2,153,874
4	Të ardhura nga qiratë familjare	22,516,320
4	Minilavanteri dhe te tjera	1,132,530
	Shuma	229,138,647

-Shpenzimet e veprimtarisë kryesore në vitin 2015

Nr	Emërtimi i shpenzimeve viti 2015	Vlera (në lekë)
1	Blerje materiale te para	5,476,905
2	Ndryshimi i gjendjeve materiale konsumi	2,185,253
3	Blerje energji (OSHEE)	93,165,228
4	Blerje ujë (UKT)	55,452,040
5	Te ndryshme (eksp kontabël, dezinfektim etj)	2,544,681



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

	Pagesa e eksperteve kontabël	1,080,000
	Supervizimi investimit ne godinat familjare	94,800
	Dezinfektim Deratizim	799,965
	Ushqimi i studenteve te huaj urdhri i MAS	300,100
	Sigurimi TPL i mak dhe regjistrimi ne QRA	61,620
	Taksa vjetore të makina, avolzhim e te tjera	208,196
6	Personel i jashtëm (Këshilli Mbikqyrës)	929,142
7	Poste telekomunikacion	201,656
8	Komisione bankare	71,145
9	Pagat e personelit	170,673,117
10	Shpenzime page (raporte)	1,151,074
11	Shpenzime page (shpërblim leje dhe te tjera)	296,733
12	Sigurime shoqërore	28,288,758
13	Taksa vendore	21,040
14	shpenzime(vlera e mbetur e aseteve jasht. përdorim)	1,123,367
15	Amortizimi AQ-ve	40,919,113
16	vendime gjyqate, shpenzime përmbartimore	39,269,000
17	Shpenz. penalitete, gjoba sistemi i tatimeve	4,120,216
	Shuma	445,888,468

Nga sa shihet dhe më sipër shpenzimet kryesore të shoqërisë janë për paga, energji elektrike, ujë dhe shpenzime për çështjet e humbura në gjykatë.

Për vitin 2014 shoqëria ka dalë me humbje në vlerën 11,266,315 lekë dhe në vitin 2015 kjo humbje është thelluar në vlerën 55,428,725 lekë.

-Nga auditimi konstatohet se shërbimi i ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi, është kryer me miratim Asambleja e Aksionarit pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSUI, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Aktverifikimin nr. 4, datë 24.02.2017, të dërguar nga drejtori i përgjithshëm, znj. ..., pretendohet se keni zbatuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit duke pasqyruar me besueshmëri dhe vërtetësi situatën financiare të shoqërisë, sqarojmë se observacioni nuk është i argumentuar nga ana ligjore, për pasojë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Auditimi, për arsye se standardi i kontabilitetit për aktivet afatgjata e përcakton saktë se nuk mund të mbash të regjistruar në aktive një pronë të cilën nuk ke dokumente pronësie. Zëri kontabël aktive afatgjata troje që shoqëria ka në kontabilitet nuk paraqet me besueshmëri situatën financiare reale të RSUI.

Në lidhje me normat e amortizimit të përdorura ju kujtojmë se aprovimi bëhet me vendim nga drejtimi i shoqërisë pas një relacioni të hollësishëm duke argumentuar metodën dhe periudhën e zgjedhur për amortizimin e aktiveve.

Procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve për vitet 2015 dhe 2016

Për vitin 2015.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 74, në të cilin përcaktohet: Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës, shoqëria ka kryer inventarizimet përkatëse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 113, datë 28.08.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, janë ngritur komisione **“Për inventarizimin e bazës materiale ne rezidencat e strehimit të studentëve”**. Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar dhe Drejtoria e Shërbimeve Studentore janë ngarkuar për zbatimin e urdhërit, për vitin 2015, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, dhe të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010. Janë ngritur 5 komisione me nga pesë anëtarë secili e çdo komision do të kontrollojë nga 5 godina. Periudha e përfundimit të inventarit është data 30.09.2015.

Janë mbajtur gjithsej 42 proces-verbale nga periudha 01.09.2015, deri më 30.09.2015. Nga proces verbalet e mbajtura nuk rezultojnë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike. Më datë 01.10.2015, Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar, me shkresën nr. 381/1 i ka dërguar informacion Drejtorit të Përgjithshëm mbi kryerjen e procesit të inventarizimit.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 161, datë 01.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Administratë dhe Bibliotekë”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 29.12.2015. Me urdhërin e brëndëshëm nr. 162, datë 01.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e veglave të punës, materialeve të tjera të inventarit në Sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Bimësisë”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 29.12.2015. Me urdhërin e brëndëshëm nr. 163, datë 01.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Magazinën e Konsumit dhe Kaldajës”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 29.12.2015. Me urdhërin e brëndëshëm nr. 164, datë 01.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Magazinën e Inventarit dhe Rekupero”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 29.12.2015. Nga proces verbalet e mbajtura nuk rezultojnë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike.

Si përfundim për inventarin e kryer gjatë viti 2015, është konstatuar se gjatë procesit, janë kryer brenda afateve të përcaktuara dhe nga këto inventarizime nuk kanë dalë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike.

Për vitin 2016.

Më datë 15.06.2016, drejtori i përgjithshëm ka vendosur me shkresën nr. 49, për krijimin e komisionit për inventarizimin e aseteve themelore të shoqërisë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 08.07.2016. Objekt i inventarizimit janë klasa e godinave dhe mjetet e transportit. Për ndjekjen e këtij vendimi është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar. Me shkresën nr. 170/1, datë 07.07.2016 kjo drejtori i ka dërguar informacion mbi procesin e inventarizimit drejtores së përgjithshme.

Në përfundim të inventarizimit rezultoi se në objektin zdruktari, nuk u krye inventari për arsëye se, objekti ishte zënë nga subjekti privat

Shoqëria është në proces gjyqësor me subjektin për lirim e ambienteve.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 74, në të cilin përcaktohet: Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës, shoqëria ka kryer inventarizimet përkatëse.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 77, datë 05.09.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, janë ngritur komisione **“Për krijimin e komisioneve të inventarizimit të bazës materiale ne rezidencat e strehimit të studentëve”**. Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar dhe Drejtoria e Shërbimeve Studentore janë ngarkuar për zbatimin e urdhërit, për vitin 2016, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, dhe të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Janë ngritur 5 komisione, tre me gjashtë anëtarë secili dhe dy me pesë anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 07.10.2016.

Janë mbajtur gjithsej 44 proces-verbale nga periudha 05.09.2016, deri më 07.10.2016. Nga proces verbalet e mbajtura nuk rezultojnë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike. Më datë 07.10.2016, Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar, me shkresën nr. 262/1 i ka dërguar informacion Drejtorit të Përgjithshëm mbi kryerjen e procesit të inventarizimit.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 104, datë 02.12.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e veglave të punës, materialeve të tjera të inventarit në Sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Bimësisë”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 29.12.2016.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 105, datë 02.12.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Magazinën e Inventarit dhe Rekupero”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 30.12.2016.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 106, datë 02.12.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Magazinën e Inventarit dhe Kaldajës”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 30.12.2016.

Me urdhërin e brëndëshëm nr. 107, datë 02.12.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm, është ngritur komisioni **“Për inventarizimin e bazës materiale në Administratë dhe Bibliotekë”**, me tre anëtarë. Periudha e përfundimit të inventarit është data 30.12.2015.

Nga proces verbalet e mbajtura nuk rezultojnë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike.

Si përfundim për inventaret e kryera gjatë viti 2016, është konstatuar se janë kryer brenda afateve të përcaktuara dhe nga këto inventarizime nuk kanë dalë diferenca nga gjëndja kontabël me atë fizike.

VI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e mallrave, shërbimeve dhe investimeve, si dhe zbatimin e këtyre kontratave.

Nga auditimi u konstatua se:

Duke parë numrin e ulët të investimeve dhe prokurimeve të kryera për periudhën objekt auditimi (7 procedura të realizuara me vlerë totale 16,404,111 lekë), grupi i auditimi i auditori të gjitha këto procedura prokurimi.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë vijon:

1. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje detergjente pastrimi”, Korrik 2016.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 3, datë 01.07.2016	..., kryetare Urdhri nr. 63, datë 01.07.2016
Vlera e përlllogaritur e kontratës 916,000 lekë pa TVSH		
Procedurë “Kërkesë për propozim” Hapja e ofertave datë 11.07.2016		
... SHPK. Vlera 866,100 lekë pa tvsh		
Kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik		
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik Skualifikuar 2 operatorë ekonomik		
Kontrata nr. 232, datë 01.08.2016, me vlerë 1,039,320 lekë me tvsh.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...	Komisioni për përlllogaritjen e vlerës së kontratës:	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

	...	
	...	
	...	

Me Urdhrin nr. 34, datë 13.05.2016, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e komisionit të testimit të tregut për përcaktimin e fondit limit për procedurën “Blerje detergjente pastrimi”, bazuar në kërkesat për materiale nr. 72, datë 10.05.2016 dhe nr. 69, datë 09.05.2016.

Sipas procesverbalit pa numër protokolli dhe pa datë, komisioni i ngritur për përlllogaritjen e vlerës së kontratës, e ka përlllogaritur atë në vlerën 916,000 pa tvsh, duke marrë çmimet më të ulëta të ofertave të administruara si më poshtë:

1. PF ... me vlerë 916,000 lekë pa tvsh, (datë 18.06.2016)
2. ... SHA me vlerë 944,580 lekë pa tvsh (pa datë) dhe
3. ... SHPK me vlerë 952,880 lekë pa tvsh (datë 22.06.2016).

Me Urdhër Prokurimin nr. 3, datë 01.07.2016, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje detergjente pastrimi”, me fond limit 916,000 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim.

Sipas procesverbalit të datës 01.07.2016, njësia e prokurimit ka hartuar DT dhe specifikimet teknike. Afati i zbatimit të kontratës do jetë **180 ditë**. Nga njësia e prokurimit nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së një afati kaq të gjatë (6 muaj) të zbatimit të kontratës, në rastin kur kemi të bëjmë me blerje mallrash, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi i dytë, i cili përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin nr. 63, datë 01.07.2016, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, Kryetare,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të buxhetit dhe
3. ... me detyrë specialiste e sektorit të prokurimeve, anëtare.

Në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO. Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit”. Gjithashtu RPP, nuk parashikon detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: “Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysht në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 11.07.2016, faqe 44. Data e hapjes së ofertave do jetë data 11.07.2016.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 11.07.2016. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës se paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	... SHPK	866,100	Kualifikuar	1
2	... SHPK	908,500	Kualifikuar	2
3	...	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	
4	...	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	

Nga auditimi i procedurës elektronike, konstatohet se “Dorëzimi i ofertave” nuk është mbyllur në datën 11.07.2016, por në datën 13.07.2016, pra 2 ditë me vonesë, duke e lënë të hapur mundësinë për dorëzimin e ofertave të tjera pas datës së fundit. Veprim në kundërshtim me “Manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për KVO”, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik. **Për këtë veprim mban përgjegjësi njësia e prokurimit** (në mungesë të përcaktimit nëpunësit të autorizuar të njësisë së prokurimit).

Sipas Raportit Përmbledhës datë 20.07.2016, KVO vendosi të kualifikojë OE ... SHPK dhe ... SHPK, të skualifikojë OE ... dhe ... për arsye se nuk kanë paraqitur ofertë dhe dokumentacion tjetër, si dhe të shpallë fituese ofertën e OE ... SHPK me vlerë 866,100 lekë pa tvsh.

Formulari i njoftimit të fituesit datë 21.07.2016, është publikuar në buletin e APP datë 25.07.2016, faqe 248.

OE ... SHPK, ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës çelur pranë shoqërisë ... me nr. 21522092, datë 01.08.2016, me vlerë 104,000 lekë.

Kontrata nr. 232, datë 01.08.2016, me vlerë 1,039,320 lekë me tvsh, me afat 180 ditë nga momenti i nënshkrimit, është nënshkruar nga znj. ... për RSU1 dhe z. ... për ... SHPK.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 232/1, datë 01.08.2016, nuk konstatohet te jetë publikuar në buletin e APP, në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2.

Zbatimi i kontratës

Me Urdhrin nr. 6, datë 02.08.2016, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e komisionit të kolaudimit të përbërë nga ... kryetare, ..., ..., ... dhe ... anëtarë. Kolaudimi do kryhet në zbatim të Udhëzimit të titullarit të AK nr. 233/1, datë 02.08.2016.

Kontraktori ... SHPK, ka sjellë mallin e kontraktuar me anë të faturës tatimore nr. 293, datë 14.09.2016, me vlerë 1,093,320 lekë me tvsh, i cili është bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen nr. 342, datë 14.09.2016.

Malli është pranuar nga komisioni i kolaudimit, me anë të Akt-Kolaudimit pa numër, datë 14.09.2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në lidhje me këtë kontratë, nuk është kryer asnjë pagesë për llogari të furnitorit, për arsye të vështirësive ekonomike që ka AK, specifikuar kjo dhe në pikën 18.1 të kontratës. Por lidhja e kontratës pa patur në dispozicion fondet për këtë kontratë, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se: *"Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor"*.

2. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19", viti 2014.

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr. 6, datë 17.09.2014	... Kryetar	...
2. Vlera e përlllogaritur e kontratës: 3,882,632 lekë, pa TVSH (pa fond rezervë 3%)	... Anëtar	...
3. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim"	... Anëtar	...
4. Data e zhvillimit të tenderit: 06.10.2014		
5. Firma Fituese: Pjesëmarrësit janë s'kualifikuar		
6. Procedura është anuluar		
Kanë paraqitur oferta në tender, 3 operatorë ekonomik	Kualifikuar 0 OE S'kualifikuar 3 OE	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Investimi konsiston në kryerjen e instalimeve elektrike në godinat 15, 18, 19 nga dhomat e familjarëve deri tek matësi i konsumit të energjisë elektrike me qëllim vendosjen e matësve të energjisë elektrike. Me shkresën nr. 1810/1 prot. datë 06.06.2014, ..., ka kërkuar plotësimin e dokumentacioneve të nevojshme për aplikimin dhe vendosjen e matësve të energjisë elektrike. Bazuar në preventivin paraprak të investimit vlera e përlllogaritur e projekt zbatimit dhe preventivit përkatës sipas VKM nr. 444, datë 05.09.1994 është 205,616 lekë. Projekt-preventivi i zbatimit është marrë në dorëzim nga institucioni sipas Aktit nr. 64/1, datë 01.09.2014. Projekti dhe specifikimet teknike janë hartuar nga shoqëria "... sh.p.k nga Ing. Elek. ... dhe administrator Ing. Me urdhrin e prokurimit të titullarit nr. 6, datë 17.09.2014, fillon procedura e prokurimit për "Rikonstruksionin e linjave elektrike të godinave 15, 18, 19. Me urdhrin nr. 315, datë 17.09.2014, është ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

- ... me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, Kryetare,
- ... me detyrë drejtor i planifikimit strategjik financiar, anëtar
- ... me detyrë drejtor i shërbimeve mbështetëse, anëtare.

Në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO. Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *"Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit"*. Gjithashtu RPP, nuk parashikon detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga auditimi i kritereve kualifikuese të dokumenteve të tenderit, konstatohet se NJP, në kriteret e veçanta kualifikuese pika **2.3.5** shprehet se *operatori ekonomik duhet të ketë një*



punësim mesatar të paktën 30 persona për periudhën Janar 2013-Korrik 2014, të vërtetuar me:

1) *Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për çdo muaj për periudhën Janar 2012-Korrik 2014*

2) *Listë-pagesat e punonjësve për periudhën Janar 2012-Qershor 2014, të konfirmuar nga administrata tatimore në të cilën duhet të jenë të përfshirë dhe stafi teknik, Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier elektrik.*

Në kriterin kualifikues pika 2.3.6, kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 5 elektrikistë, që të jenë pajisur me dëshmi nga IQT. Në krahasim të dy kriterëve kualifikues 2.3.5 dhe 2.3.6, krijohet konfuzion kriteresh kualifikuese, pasi në të dyja kriteret kërkohet që Inxhinierët dhe elektrikistët të jenë pjesë në stafin teknik të ofertuesit, por për elektrikistët nuk është kërkuar të jenë pjesë në listë-pagesën e punonjësve.

Bazuar kriterëve të mësipërme të DST është krijuar konfuzion ose paqartësi mbi kriteret kualifikuese në lidhje me numrin e punonjësve të stafit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik" neni 23 "Specifikimet teknike", pika 4, citohet se përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, statike dhe funksionale. *Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës.* Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.

-Sipas nenit 46, pika 3 të LPP, kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

Bazuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5, kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

-Vendosja e numrit të punësimit mesatar të paktën 30 persona, nuk është argumentuar për vendosjen e tyre, bazuar grafikut të punimeve, preventivit të punimeve dhe volumit të punës në përputhje me LPP.

-Në kriteret kualifikuese pika 2.3.6 të DST, kërkohet që operatorët ekonomik duhet të kenë në staf 5 elektrikistë, të cilët janë të pajisur me dëshmi nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT). Numri prej 5 elektrikistësh në staf nuk është argumentuar nga NJP, në lidhje me volumin e punës të objektit të prokurimit zvogëlohet konkurrenca e operatorëve pjesëmarrës, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

Sa më sipër u konstatua se mungon procesverbali mbi argumentimin dhe dokumentimin e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim të pikës 2, të nenit 61 të VKM së mësipërme.

Lidhur me këtë konstatim, pika 2, gërma "a" e Kreut V, të VKM së sipërcituar (në fuqi në kohën e kryerjes së procedurës), parashikon se: "Për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në LPP dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Procesverbali i hapjes së ofertave është më datë 06.10.2014. Bazuar auditimit elektronik dhe raportit përmbledhës datë 22.10.2014 të KVO, në procedurë këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik me oferta si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa T.V.SH
1	...	2,729,191 Lekë
2	... sh.a	3,797,198 Lekë
3	... sh.p.k	3,974,255 Lekë

Në përfundim të procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se:

1. Operatori "... " sh.p.k, ka paraqitur të gjitha dokumentet tekniko-ligjore, por i mungojnë 5 elektricistë të certifikuar nga Inspektorati Qendror Teknik.
2. Operatori "... " sh.a ka hedhur të gjitha dokumentet teknike-ligjore, por vërtetimi nga tatimet rezulton me detyrime edhe pse operatori ka një aktmarrëveshje për pagesën me këste të këtyre detyrimeve.
3. Operatori "... " sh.p.k, ka paraqitur të gjitha dokumentet tekniko-ligjore, por i mungojnë 5 elektricistë të certifikuar nga Inspektorati Qendror Teknik.

Duke konstatuar se asnjë nga kompanitë nuk i plotëson kërkesat në DST, komisioni i vlerësimit të ofertave, njësia e prokurimit dhe titullari i AK, miratojnë anulimin e procedurës së tenderimit.

Me shkresën nr. 1617 prot. datë 22.10.2014 titullari i AK njofton Agjencinë e Prokurimit Publik për anulimin e procedurës pasi asnjë nga ofertat e paraqitura nuk është klasifikuar e suksesshme.

Nga verifikimet e dosjes së prokurimit është konstatuar se KVO, nuk ka nënshkruar formularët e konfliktit të interesit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 16 dhe neni 56, i cili citon *se kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi.*

Nga auditimi elektronik në APP, u konstatohet se:

-Operatori "... " sh.p.k, nuk plotësonte 5 elektricistët me certifikatë nga IQT.

-Operatori ekonomik "... " sh.a, nga vërtetimin nr. 1828 prot. datë 01.08.2014, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u konstatua se ka detyrim tatimor në vlerën e shtuar, tatim mbi fitimin, kontribute të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale apo lloje të tjera detyrimesh në shumën 7,450,496 lekë për të cilin subjekti ka Akt marrëveshje për pagesë me këste me nr. 4122 prot. datë 13.06.2014, e cila po respektohet me korrektësi sipas përgjegjësit të sektorit të shërbimit ndaj tatimpaguesve. Në përputhje me DST pikën 2 të kriteve të përgjithshme të kualifikimit ofertuesi duhet të dorëzojë dokument që vërteton: a. Ka plotësuar detyrimet fiskale, b. Ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore. Në përputhje me LPP neni 45 "Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve" pika d), dh) citojnë se ofertuesi s'kualifikohet nëse nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës. Pra operatori "... " sh.a, nuk i ka plotësuar këto kritere dhe është s'kualifikuar nga KVO.

*- Operatori "... " sh.p.k, pas verifikimit elektronik konstatohet se ka paraqitur **16 punonjës me dëshminë e kualifikimit për sigurimin teknik si punonjës elektrik.** Këta punonjës janë*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

kualifikuar dhe kanë kaluar testimet e sigurimit teknik si punonjës elektrik, në përputhje me Udhëzimin e Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, mbi dokumentacionin që duhet plotësuar për tu pajisur me dëshmi kualifikimi në sigurimin teknik si punonjës elektrik, të cilët janë kualifikuar si punonjës elektrik me grupet e njohurive përkatëse si në tabelë:

Nr	Numri specialisteve	Profesioni	Kategoria
1	1	Hidraulik	grupi I
2	8	Karpiertier	grupi II
3	3	Saldator	grupi II
4	1	Elektricitist	grupi II
5	2	Vinçier	grupi II
6	1	Specialist shtresash	grupi II

Bazuar listë-pagesave e kontributeve të sigurimeve shoqërore konstatohet se operatori "... sh.p.k. ka një numër mesatar punonjësish me të paktën 40 punonjës për periudhën e kërkuar, i cili ka në listë-pagesë staf të kompletuar inxhinierik në fushën e zbatimit të objekteve civile. Për periudhën e kërkuar nga AK, operatori "... sh.p.k. ka në listë-pagesë 1 Ing. Elektrik, 2 Ing. Mekanik, 1 Ing. Mjedisi në drejtim energjetik, 2 Ing. ndërtimi, 2 Teknik ndërtimi, në muaj të ndryshëm elektriciste etj.

Operatori "... sh.p.k, ka plotësuar 1 elektricitist dhe nuk plotëson 4 elektricitistë sipas DST, të cilat janë të paargumentuara si kriter kualifikues nga NJP. Bazuar punëve të ngjashme të këtij operatori, të cilat janë goxha më të mëdha dhe komplekse se objekti i prokurimit, bazuar Licensave profesionale, kapaciteteve ekonomiko-ligjore, certifikimet e shumta etj, KVO duhej të merrte në konsideratë këtë operator për mos ta s'kualifikuar nga tenderi, duke i kërkuar dokumentacione shtesë për të bërë të mundur realizimin e kontratës duke përfituar në kohë nga investimi.

Në tenderin e ri-zhvilluar me objekt "Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19" për administratën, viti 2014 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr. 7, datë 28.10.2014	... Kryetar	...
2. Vlera e përlllogaritur e kontratës: 3,882,632 lekë, pa TVSH (pa fond rezervë 3%)	... Anëtar	...
3. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim"	... Anëtar	...
4. Data e zhvillimit të tenderit: 10.11.2014		
5. Firma Fituese: "... sh.p.k		
6. Vlera e kontratës 3,855,500 lekë pa TVSH		
7. Diferenca nga fondi limit 27,132 lekë		
Kanë paraqitur oferta në tender, 2 operatorë ekonomik	Kualifikuar 1 O.E S'kualifikuar 1 O.E	

Nga auditimi i kriterëve kualifikues të dokumenteve të tenderit, konstatohet se DST nuk kanë ndryshuar nga procedura e parë e tenderimit, e cila u anulua pasi nuk kishte asnjë ofertë të suksesshme. Nga njësisë së prokurimit nuk disponohet asnjë argumentim për ri-vlerësimin e dokumenteve të tenderit, pasi procedura e parë u anulua për shkak të kriterit të 5 elektricitistëve të pajisur me IQT, e cila duhej ri-vlerësuar nga NJP, në mënyrë që të nxitej apo rritej konkurrenca e pjesmarrësve në tender në përputhje me nenin 1 të LPP.

Procesverbali i hapjes së ofertave është më datë 10.11.2014, ku në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik me ofertat si në tabelën e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa T.V.SH
1	... sh.p.k	3,444,974 lekë
2	... sh.p.k	3,855,500 Lekë

Bazuar procesverbalit për marrjen e vendimit të klasifikimit datë 13.11.2014 dhe raportit përmbledhës të datës 20.11.2014, KVO ka vlerësuar ofertat ekonomike duke s'kualifikuar operatorin "..." sh.p.k dhe të shpall të suksesshëm operatorin "..."sh.p.k.

Sipas verifikimeve të KVO konstatohet se operatorit "..." sh.p.k i mungon dokumentacioni i mëposhtëm:

-Mungon Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar

-Mungon Licenca profesionale

-Mungon bilanci i vitit 2011 si dhe bilanci i vitit 2012

-Mungojnë taksat vendore të vitit 2013 si dhe taksat vendore të vitit 2014

-Mungon punë e ngjashme në masën 40% të fondit limit

-Mungojnë certifikatat ISO

-Nuk plotëson numrin e punonjësve të kërkuar.

Nga auditimi elektronik i operatorit "..."sh.p.k konstatohet se:

- Ekstrakti i regjistrimit tregtar është paraqitur nga operatori pjesëmarrës

- Bilanci i vitit 2011 si dhe bilanci i vitit 2012, është pakuptim i vlerësuar nga KVO, pasi në DST bilancet e viteve 2011 dhe 2012 nuk janë kërkuar. Operatori pjesëmarrës ka paraqitur bilancin 2013 dhe nuk ka hedhur të vitit 2014.

-Licencat profesionale i mungojnë,

-Taksat vendore të vitit 2013 si dhe taksat vendore të vitit 2014 i mungojnë

-Punë e ngjashme në masën 40% të fondit limit i mungojnë

-Certifikatat ISO, janë të operatorit "..." s.p.a dhe jo "..."sh.p.k, pra ky operator ka hedhur në sistem dokument jo të vërtetë.

-Numri i punonjësve në listë-pagesë përbëhet mesatarisht nga 6 punonjës.

Për arsyet e mësipërme në përputhje me LPP, operatori "..."sh.p.k, nuk plotëson kriteret kualifikuese si ofertë e suksesshme dhe duhej s'kualifikuar, e cila është s'kualifikuar nga KVO. Nga njoftimi i fituesit konstatohet se komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk ka treguar kujdes në vlerësimin e mirë të operatorit "..." sh.p.k pasi Ekstrakti i regjistrimit tregtar është paraqitur në sistem dhe bilanci i vitit 2011 si dhe bilanci i vitit 2012, nuk ka qenë kriter kualifikues.

Nga verifikimi elektronik i operatorit të shpallur fitues "..." sh.p.k, konstatohet se ka plotësuar të gjitha dokumentet tekniko-ligjore. Pra ka plotësuar stafin me 5 elektrikistë të certifikuar nga Inspektorati Qendror Teknik, i cili ishte shkaku i s'kualifikimit në procedurën e parë e cila u anulua.

Punonjësit me dëshmitë e IQT si punonjës elektrik të paraqitur nga ky operator, janë në listë-pagesën e sigurimeve shoqërore, por profesioni i tyre për të cilin ata paguhen nuk është elektrikist por në profesione të tjera. Konkretisht tregohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emri i Punonjësit	Profesioni në Listë-pagesën e "..." sh.p.k
1	...	Janar 2013 - Shtator 2014/ <i>Punëtor i pastrimit të plazhit</i>
2	...	Janar 2013 - Shtator 2014/ <i>Shitës karburantit</i>
3	...	Janar 2013 - Shtator 2014/ <i>Shitës karburantit</i>
4	...	Shtator 2014 / <i>Shitës karburantit</i>
5	...	Janar 2013 - Shtator 2014/ <i>Punëtor mirëmbajtje për ndërtesa</i>

Sa më sipër në përputhje me **nenin 45** të LPP “Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve” pika 2 e), *Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur, është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

Në rastin e mësipërm të 2 operatorët pjesëmarrës kanë dokumentacione të rreme, ku operatori "...sh.p.k me Certifikatat ISO, jo të vërtetë që i përket operatorit "... s.p.a dhe operatori "...sh.p.k në lidhje me profesionin e elektrikistëve. Veprimet ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave dhe bazuar LPP, procedura e dytë e tenderit duhej anuluar.

Nga verifikimet e procedurave të tenderimit për "*Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19*", konstatohet se Autoriteti Kontraktor nuk ka marrë parasysh leverdishmërinë e ofertës së paraqitur nga "...sh.p.k me vlerë 3,275,029 Lekë me TVSH, e cila nuk plotësonte numrin e punonjësve me IQT (si punonjës elektrik, por me profesione të ndryshme), ofertë e cila ishte më e favorshme ekonomikisht për Institucionin. Në tenderin e ri-përsëritur është shpall fitues operatorin "...sh.p.k me vlerë oferte 4,626,600 Lekë me TVSH, i cili ka paraqitur dokumentet e elektrikistëve sipas DST, në *kundërshtim me veprimtarinë e tyre sipas listëpagesës së operatorit fitues, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi KVO.*

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve u konstatua se:

Procedura e hartimit të projektit për "Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19", është realizuar me "Blerje të vogël". Kontrata e hartimit të projektit është nënshkruar me nr. 1124/6 prot. Datë 07.08.2014, midis shoqërisë "...sh.p.k i përfaqësuar nga ... dhe Rezidencën Studentore Universitare Nr. 1, përfaqësuar nga ..., me afat 10 ditor në vlerën 100,000 lekë pa TVSH. Projekt-preventivi i zbatimit është marrë në dorëzim nga institucioni sipas Aktit nr. 64/1, datë 01.09.2014.

-Kontrata e punimeve është lidhur nr. 1408 prot datë 09.12.2014 midis operatorit ekonomik "... sh.p.k me përfaqësues ... dhe RSU nr. 1, me përfaqësues Vlera e kontratës është 3,855,500 lekë pa TVSH, me afat realizimi 50 ditë.

-Kontrata e mbikqyrjes së punimeve është lidhur nr. 1414 prot datë 11.12.2014, midis operatorit ekonomik "... sh.p.k me përfaqësues ... dhe RSU nr. 1, me përfaqësues Investimi është kryer pa leje ndërtimi veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi sektorin e prokurimeve dhe të projekteve.

Njoftimi i fillimit të punimeve, procesverbali i fillimit të punimeve dhe akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit janë mbajtur midis palëve me shkresat pa prot. datë 11.12.2014. Me shkresën e kontraktorit nr. extra prot. Datë 14.01.2015, e pa protokolluar në RSU nr. 1, kërkohet propozimi për miratimin e zërave të rinj të punës që konsistojnë në:

1. Kasetë Metalike 36 Module, pasi ka rezultuar i nevojshëm në godinën 18, pasi duhej të furnizoheshin me energji 90 familje, ndërsa në projekt janë parashikuar 60 familje.
2. F.V Çelës 1 polar 220V 10A, është parë i nevojshëm pasi çelësat ekzistues janë jashtë funksionit
3. F.V kuti suport pllaket 2 modulare, pasi shoqëron çelësat 1 polar 220V 10A. Çmimet e zërave të rinj janë marrë sipas Vendimit nr. 568, datë 27.06.2013 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", të cilat janë miratuar nga mbikëqyrësi dhe Ing. e RSU nr. 1. Punimet e maskuara të objektit konsistojnë në punime prishje mure blloqe betoni, f.v kablli Cu fuqi 6/10 kv, me dimensione të ndryshme. Përdorimi i zërave të rinj, ka bërë të mundur përdorimin e fondit rezervë prej 3% në vlerën 115,665 lekë, të miratuar nga AK më datë 15.01.2015, duke shkuar në vlerën e kontratës 3,970,705 lekë pa TVSH. Ditari i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

objektit fillon të mbahet me datën e fillimit të punimeve 11.12.2014 dhe vazhdojnë deri më 29.01.2015, brenda afatit kontraktual të punimeve. Me shkresat pa prot. datë 29.01.2015 është njoftuar përfundimit i punimeve nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi.

-Procedura e kolaudimit të objektit "Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19", është realizuar me "Blerje të vogël". Kontrata e kolaudimit është nënshkruar me nr. 1440 prot. Datë 31.12.2014, midis shoqërisë "...sh.p.k i përfaqësuar nga ... dhe Rezidencën Studentore Universitare Nr. 1, përfaqësuar nga

Afati i kolaudimit është 5 ditë dhe vlera e kolaudimit është 1000 lekë pa TVSH, e cila është anomalisht e ulët.

Gjatë auditimit të librezës së masave dhe verifikimeve në terren, u konstatua se punimet janë realizuar në përputhje me situacionit përfundimtar të punimeve, në nivele materialiteti të pranueshme.

Akti i kolaudimi i punimeve është realizuar më datë 18.02.2016, përfaqësuar nga kolaudatori, mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve. Akti i kolaudimit është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, **neni 12** ku citohet në mënyrë eksplicite: "*Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë. Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t'ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit". Shkelja e dispozitës ligjore ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm të RSU nr. 1*

3. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje materiale ndërtimi dhe marangozi", Qershor 2016.

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr. 2, datë 06.06.2016	... Kryetar	...
2. Vlera e përlllogaritur e kontratës: 2,083,504 lekë, pa TVSH	... Anëtar	...
3. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim"	... Anëtar	...
4. Data e zhvillimit të tenderit: 16.06.2016		
5. Firma Fituese: "... sh.p.k		
6. Vlera e kontratës 1,980,600 lekë, pa TVSH		
7. Diferenca nga fondi limit 102,904 lekë		
Kanë paraqitur oferta në tender, 3 operatorë ekonomik	Kualifikuar 2 OE S'kualifikuar 1 OE	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 60/1 prot. datë 25.04.2016 nga Drejtoria Juridike, i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm fillimi i procedurës së tenderimit për materialet e planifikuara, bazuar planit vjetor të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Bazuar Vendimit nr. 34 datë 13.05.2016 dhe me shkresën nr. 82 prot. datë 25.05.2016, ngrihet komisioni i testimit të tregut i përbërë nga ..., ..., ..., ..., Për procedurën e përcaktimit të preventivit të kontratës janë zbatuar çmimet për materialet ndërtimore sipas VKM nr. 629 datë 15.07.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", duke përcaktuar fondin limit në vlerën 2,083,504 lekë pa TVSH. Nga verifikimet e dokumenteve standarde të tenderit konstatohet se ato janë përcaktuar në përputhje me LPP.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Me urdhrin nr. 45, datë 06.06.2015, është ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

- ... me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, Kryetare,
- ... me detyrë përgjegjëse sektori në planifikimin strategjik financiar, anëtar
- ... me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve dhe projekteve, anëtare.

Në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO. Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: "*Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit*". Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Bazuar procesverbalit të hapjes së ofertave më datë 16.06.2016, në procedurën e tenderimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik të renditur si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa T.V.SH
1	... sh.p.k	1,901,110 Lekë
2	... & ...	1,980,600 Lekë
3	... sh.p.k	1,988,170 Lekë
4	... sh.p.k	Pa ofertë
5	...	Pa ofertë

Bazuar procesverbalit datë 23.06.2016, për marrje e vendimit për klasifikimin e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin tekniko-ligjor të pjesëmarrësve duke vendosur:

1. Të s'kualifikojë operatorin "...sh.p.k, **për arsye sepse punët e ngjashme nuk janë të njëjtës natyrë të kërkuar sipas DST.**
2. Të kualifikojë operatorët "... sh.p.k dhe "... sh.p.k pasi plotësojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas DST.

Nga auditimi i dosjes së prokurimit konstatohet se dosja nuk është e inventarizuar dhe mungojnë formularët e konfliktit të interesit në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 16 dhe neni 56, i cili citon *se kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysht në emërimin e një nëpunësi prokurimi.*

Me shkresën nr. 597 prot. datë 01.07.2016 operatori ekonomik "...sh.p.k i drejtohet Komisionit të vlerësimit të ofertave, duke u ankuar për procedurën e prokurimit dhe marrjen e masave për anulimin e vendimit nga KVO, duke e kualifikuar këtë operator dhe të shpallet fitues për këtë procedurë pasi oferta e tij është më e leverdishme.

Në deklaratën e hollësishme e fakteve dhe argumenteve nga ofertuesi "... sqarohet:

Në datën 24.06.2016 është njoftuar elektronikisht me klasifikimin e ofertave dhe arsyen e s'kualifikimit të tij nga tenderi, pasi kriteri i punës së ngjashme nuk është i një natyre të njëjtë me atë që është kërkuar. Më tej ky operator sqarohen se ka dorëzuar kontratë si punë e ngjashme një shërbim mirëmbajtjeje të lidhur me ..., Tiranë viti 2015, e cila ka të bëjë me blerjen e mallrave, materialeve dhe vendosjen e tyre në objekt. Në situacionin përfundimtar furnizimet e ngjashme janë më të mëdha se 40 % e fondit limit dhe janë në përpjesëtim me natyrën e kontratës që prokurohet, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik" **neni 46, pika 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Me urdhrin nr. 3 datë 04.07.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të RSU nr. 1, pezullohet procedura e prokurimit dhe ngrihet komisioni për trajtimin e ankesës të operatorit "... " sh.p.k, në shkresën nr. 597 prot. datë 01.07.2016. Në zbatim të urdhrin të titullarit është ngritur grupi i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga ..., ...,

Me shkresën nr. 96 datë 06.07.2016, të komisionit të shqyrtimit të ankesës, drejtuar titullarit të AK, sqarohet se kontrata nr. 3/11 prot. datë 11.03.2015 "Shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore", e paraqitur nga operatori "... " sh.p.k, nuk i plotëson kriteret kualifikuese sipas pikës 2.3, të furnizimeve të ngjashme të njëjtës natyrë dhe s'kualifikimi i KVO, konsiderohet i drejtë.

Me shkresën nr. 597/1 datë 06.07.2016 drejtuar operatorit ekonomik "... " sh.p.k, nga Drejtori i Përgjithshëm znj. ..., i kthehet përgjigje se ankesa e tij nuk merret në konsideratë dhe se vlerësimin e KVO e konsideron të drejtë.

Me raportin përmbledhës të KVO dhe njoftimin e fituesit më datë 18.07.2016, shpallet e suksesshme oferta e operatorit "... " sh.p.k & "... " sh.p.k, me vlerë oferte 1,980,600 lekë pa TVSH.

Nga auditimi elektronik i kontratës së paraqitur nga operatori "... " sh.p.k, si kontratë e ngjashme për procedurën e prokurimit konstatohet se:

Vlera e kontratës së ngjashme është 2,888,928 lekë pa TVSH, me afat rreth 9 muaj dhe përmban plotësisht kriterin kualifikues së punëve të ngjashme, ku madje tejkalon në masë më të madhe se 40 % të përvojës së mëparshme përcaktuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 27, pika 4, Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Kontrata e paraqitur nga "... "sh.p.k, për plotësimin e kriterit kualifikues përfshin:

A. Punimeve ndërtimi, të cilat rrjedhimisht e përfshijnë materialet e ndërtimit,

B. Punime hidraulike,

C. Punime Elektrike,

D. Punime Kanalizime të Ujërave të zeza,

E. Punime Marangozi, të cilat rrjedhimisht e përfshijnë materialet e marangozerie.

Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik "... "sh.p.k, është diskriminuar nga Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1, duke u s'kualifikuar në mënyrë të padrejtë.

Gjithashtu konstatohet se në tenderin e realizuar për administratën 2016 "Blerje materiale elektrike dhe hidraulike", operatori "... "sh.p.k, ka paraqitur po të njëjtën kontratë nr. 3/11 prot. datë 11.03.2015 "Shërbimin e mirëmbajtjes së objekteve ndërtimore", si kontratë e ngjashme dhe është shpall si ofertë suksesshme, ku ka nënshkruar kontratën nr. 268 prot. datë 08.09.2016, për blerje materiale elektrike-hidraulike në vlerën 2,983,580 pa TVSH.

Nga veprimtaria procedurave tenderuese të vitit 2016 në RSU nr. 1, janë përdorur dy standarde të ndryshme kualifikuese, duke diskriminuar operatorin ekonomik dhe më pas duke e favorizuar. Veprime të cilat përbejnë elementet e marrëveshjeve të ndaluara midis operatorëve ekonomik dhe AK.

Për shkeljet të dispozitave ligjore të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke shkaktuar diskriminim të operatorëve ekonomik dhe **dëm ekonomik në vlerën 95,388 lekë** (përfshirë TVSH), nga diferenca midis ofertës së operatorit të s'kualifikuar padrejtësisht "... " sh.p.k në vlerën 2,281,332 lekë me TVSH dhe operatorit që është



nënshkruar kontrata e furnizimit "... & " sh.p.k me vlerë 2,376,720 lekë me TVSH. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga ..., .., Komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga ..., .., si dhe për mos-mbikqyrjen e kësaj procedure zv.Drejtori i Përgjithshëm z. ... dhe Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 1

4. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje materiale elektrike dhe hidraulike", viti 2015.

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 16.06.2015	... Kryetar	...
2. Vlera e përllogaritur e kontratës: 3,416,635 lekë, pa TVSH	... Anëtar	...
3. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim"	... Anëtar	...
4. Data e zhvillimit të tenderit: 26.06.2015		
5. Firma Fituese: Pjesëmarrësit janë s'kualifikuar		
6. Procedura është anuluar		
Kanë paraqitur oferta në tender, 2 operatorë ekonomik	Kualifikuar 0 OE S'kualifikuar 2 OE	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 111 prot. datë 07.05.2015 nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm fillimi i procedurës së tenderimit për materialet e planifikuara, bazuar planit vjetor të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Bazuar Vendimit nr. 69 datë 28.04.2016, ngrihet komisioni i testimit të tregut i përbërë nga ..., .., Çmimet e materialeve elektrike dhe hidraulike janë marrë duke studiuar tregun në 3 operatorë ekonomik, ku është përcaktuar vlera e përllogaritur e kontratës në vlerën 3,416,635 lekë pa TVSH. Nga auditimi i DST, konstatohet se njësia e prokurimit ka kërkuar që operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurë duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në vlerën 68,833 lekë. Lloji i procedurës është kërkesë për propozim mbështetur në LPP, nenin 34, "Kërkesa për propozime" pika 1, ku citon se *Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e kërkesës për propozim për kontrata me vlerë nën kufirin e ulët monetar.*

Bazuar nenit 49, "Sigurimi i ofertës" pika 1. *Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik.*

Në rastin e procedurës së objektit të prokurimit, sigurimi i ofertës nuk është i nevojshëm pasi vlera e përllogaritur e kontratës nuk është mbi kufirin e lartë monetar dhe për rrjedhojë Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës operatorëve ekonomik pasi është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për prokurimin publik", ligjin 182/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Prokurimin Publik" neni 13/1. **Mbi vendosjen si kriter kualifikues të sigurimit të ofertës mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga ..., .., ..**

Me vendimin nr. 91 datë 16.06.2015, nga Drejtori i Përgjithshëm i RSU nr. 1, ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga ..., .., Në pikën 2 të urdhrin të prokurimit është përcaktuar se zv. Drejtori i Përgjithshëm ..., do të mbikëqyrë veprimtarinë e KVO. Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë emëruar 1 specialist në sektorin e prokurimeve dhe projekteve, 1 përgjegjëse sektori, 1 specialist i sektorit të planifikimit financiar, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 58, i cili përcakton se "*Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të AK dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit*", veprim i cili mban përgjegjësi titullari i AK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Bazuar procesverbalit të hapjes së ofertave më datë 13.07.2015, në procedurën e tenderimit kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik të renditur si më poshtë:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa TVSH
1	...	3,390,300 Lekë
2	...	3,399,440 Lekë
3	...	Pa ofertë

Bazuar procesverbalit datë 16.07.2015, për marrje e vendimit për klasifikimin e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin tekniko-ligjor të pjesëmarrësve duke vendosur:

1. Të s'kualifikojë operatorin "...sh.p.k, për arsye se:
 - Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës siç është kërkuar në DST
 - Nuk ka sjellë mostrat e materialeve
2. Të s'kualifikojë operatorin "... sh.p.k, për arsye se:
 - Nuk ka paraqitur kontratë të ngjashme të shoqëruar me faturat tatimore dhe vërtetimin e realizimit të prokurimit nga Autoriteti Kontraktor
 - Certifikata ISO 9001-2008, në internet nuk vërtetohet se kjo shoqëri të jetë pajisur me këtë certifikatë.
 - Certifikata ISO 14001-2004, nuk kanë objektin e prokurimit
 - Nuk ka sjellë mostrat e materialeve

Nga auditimi elektronik dokumenteve të hedhura nga operatorët e mësipërm konstatohet se:

1. Operatorin "... sh.p.k, nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme por vetëm fatura tatimore pa vërtetimin e realizimit. Certifikata ISO 9001-2008, në internet figuron dhe Certifikata ISO 14001-2004, nuk është paraqitur nga operatori ekonomik.
2. Operatorin "...sh.p.k, mbi paraqitjen e sigurimit të ofertës sipas kërkesave të DST, ka paraqitur në ofertë e tij deklaratë bazuar LPP, i cili citon se AK nuk mund të kërkojë sigurim oferte pasi bie në kundërshtim me legjislacionin e LPP.

Në rastin e mësipërm KVO, ka vlerësuar operatorët në përputhje me DST, në të cilën është vendosur kriter kualifikues në kundërshtim me LPP, duke sjellë arsye s'kualifikuese të padrejtë për operatorin ..., veprim që ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

Në lidhje me mostrat që duhet të sjellin operatorët ekonomik, bazuar pikës 2.2.5 "kapaciteti teknik", që citon se dy ditë pas hapjes së ofertave, ofertuesit do të sjellin mostrat e mallit që prokurohet, ku konstatohet se në dosjen e prokurimit nuk disponohet asnjë procesverbal apo dokument tjetër që të vërtetojë mos paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomik. Nga auditimi i dosjes së prokurimit konstatohet se dosja nuk është e inventarizuar dhe mungojnë formularët e konfliktit të interesit nga KVO, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 16 dhe neni 56, i cili citon *se kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi.*

Bazuar raportit përmbledhës datë 27.07.2015 të KVO, asnjë ofertë nuk u shpall e suksesshme dhe me urdhrin e prokurimit nr. 3 datë 03.08.2015 të titullarit të RSU nr. 1 ri-zhvillohet procedura e prokurimit.

Në tenderin e ri-zhvilluar me objekt "Blerje materiale elektrike dhe hidraulike " për administratën, viti 2015 me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Vlerësimit të ofertave	Njësia e Prokurimit
------------------------------	---	----------------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

1. Urdhër Prokurimi nr. 3, datë 03.08.2015	... Kryetar	...
2. Vlera e përlogaritur e kontratës: 3,416,635 lekë, pa TVSH	... Anëtar	...
3. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim"	... Anëtar	...
4. Data e zhvillimit të tenderit: 13.08.2015		
5. Firma Fituese: "... " sh.p.k		
6. Vlera e kontratës 3,235,745 lekë pa TVSH		
6. Diferenca nga fondi limit 180,890 lekë		
Kanë paraqitur oferta në tender, 1 operatorë ekonomik	Kualifikuar 1 OE S'kualifikuar 0 OE	

Nga auditimi i kritereve kualifikuese të dokumenteve të tenderit, konstatohet se DST nuk kanë ndryshuar nga procedura e parë e tenderimit e cila u anulua pasi nuk kishte asnjë ofertë të suksesshme. Nga njësisë së prokurimit nuk disponohet asnjë argumentim për ri-vlerësimin e dokumenteve të tenderit, pasi procedura e parë u anulua për shkak të kriterit të sigurimit të ofertës në kundërshtim me LPP, **e cila duhej ri-vlerësuar nga NJP, në mënyrë që të nxitej apo rritej konkurrenca e pjesëmarrësve në tender në përputhje me nenin 1 të LPP, veprim që ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit.**

Procesverbali i hapjes së ofertave është më datë 13.08.2015, ku në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 1 operator ekonomik me ofertat si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatori Ekonomik	Vlera pa TVSH
1	...	3,235,745 lekë
2	...	Pa ofertë

Bazuar raportit përmbledhës të datës 27.08.2015, KVO ka vlerësuar ofertat ekonomike duke s'kualifikuar operatorin "... " sh.p.k dhe të shpall të suksesshëm operatorin "... " sh.p.k. Nga verifikimet elektronike konstatohet se operatori " ... " sh.p.k i mungon oferta ekonomike dhe operatori "... " sh.p.k, nuk kishte mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor i cili shpallet si ofertë e suksesshme në vlerën 3,235,745 lekë pa TVSH. *Gjithashtu në procedurën e dytë të ri-zhvilluar nuk disponohet asnjë procesverbal apo dokument tjetër që të vërtetojë paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomik.*

5. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, viti 2016.

Procedura e zhvilluar në Qershor 2016

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 1, datë 02.06.2016		
Vlera e përlogaritur e kontratës 3,337,178 lekë pa TVSH		
Procedurë “Kërkesë për propozim” Hapja e ofertave datë 13.06.2016	..., kryetare	
Anuluar
Kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik
Kualifikuar 3 operatorë ekonomik Skualifikuar 0 operatorë ekonomik	Urdhri nr. 41, datë 02.06.2016	
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës:	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

	...	
	...	
	...	

Me Urdhrin nr. 34, datë 13.05.2016, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e komisionit të testimit të tregut për përcaktimin e fondit limit për procedurën “Blerje detergjente pastrimi”, bazuar në kërkesat për materiale nr. 6011, datë 25.04.2016.

Sipas procesverbalit pa numër protokollit, datë 25.05.2016, komisioni i ngritur për përlllogaritjen e vlerës së kontratës, e ka përlllogaritur atë në vlerën 3,337,178 pa tvsh, duke marrë çmimet më të ulëta të ofertave të administruara si më poshtë:

1. ... SHPK Lushnjë,
2. ... SHPK Tiranë,
3. ... SHPK Kukës.

Me Urdhër Prokurimin nr. 1, datë 02.06.2016, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, me fond limit 3,337,178 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim.

Sipas procesverbalit të datës 02.06.2016, njësia e prokurimit ka hartuar DT dhe specifikimet teknike. Afati i zbatimit të kontratës do jetë **180 ditë**. Nga njësia e prokurimit nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së një afati kaq të gjatë (6 muaj) të zbatimit të kontratës, në rastin kur kemi të bëjmë me blerje mallrash, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, pika 2, paragrafi i dytë, i cili përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Me urdhrin nr. 41, datë 02.06.2016, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, juriste, Kryetare,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të buxhetit, ekonomiste dhe
3. ... me detyrë specialiste e sektorit të prokurimeve, inxhinieri agrare anëtare.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO.

-Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit”.

-KVO nuk ka në përbërje të tij ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti fushës”.

-Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: *“Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 22.06.2016, faqe 75. Data e hapjes së ofertave do jetë data 13.06.2016.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 13.06.2016. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës se paraqitur	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	... SHPK	3,006,970	Kualifikuar	1
2	... SHPK	3,128,180	Kualifikuar	2
3	... SHPK &	3,264,180	Kualifikuar	3

Nga auditimi i procedurës elektronike, konstatohet se “Dorëzimi i ofertave” nuk është mbyllur në datën 13.06.2016, por në datën 23.06.2016, pra 10 ditë me vonesë, duke e lënë të hapur mundësinë për dorëzimin e ofertave të tjera pas datës së fundit, ndërsa vlerësimi i ofertave është kryer më datë 13.06.2016. Veprim në kundërshtim me “Manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për KVO”, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik. Për këtë veprim mban përgjegjësi njësia e prokurimit (në mungesë të përcaktimit nëpunësit të autorizuar të njësisë së prokurimit).

Në DT, janë kërkuar mostra për 15 prej materialeve të kërkuara. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe ai i gjendur në dosjen e prokurimit, nuk konstatohet dokumentacion mbi marrjen dhe dorëzimin e këtyre mostrave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 22 *“Format e komunikimit”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Sipas Raportit Përmbledhës datë 01.07.2016, KVO vendosi të kualifikojë të tre ofertuesit, si dhe të shpallë fituese ofertën e OE ... SHPK me vlerë 3,006,970 lekë pa tvsh. Formulari i njoftimit të fituesit datë 01.07.2016, është publikuar në buletin e APP datë 11.07.2016, faqe 80-81.

Më datë 13.07.2016, OE ... SHPK ka sjellë një mesazh në sistemin elektronik të APP, ku njofton se *“Tërhiqemi për shkak të pamundësisë financiare, për shkak se jemi të angazhuar me disa punime të tjera njëkohësisht”*.

Në zbatim të këtij mesazhi, anëtari i njësisë së prokurimit ..., me shkresën nr. 106, datë 18.07.2016, drejtuar titullarit të AK, i propozon anulimin e procedurës, në zbatim të pikës 5, të nenit 58, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, për arsye se diferenca midis ofertuesit të renditur i pari me atë të renditur i dyti, është më e madhe se 2% të fondit limit. Njoftimi i anulimit është publikuar në buletin e APP, datë 18.07.2016, faqe 389.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Në lidhje me këtë anulim, u konstatua se:

-Ky anulim është kryer nga anëtari i njësisë së prokurimit ..., pa marrë më parë miratimin e titullarit të AK.

-Ky anulim është kryer nga anëtari i njësisë së prokurimit ..., pa marrë më parë konfirmimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, i cili është i ngarkuar ligjërisht me procesin e vlerësimit.

-Përderisa ky anulim është publikuar në buletin e APP datë 18.07.2016, atëherë njoftimi për anulim (i cili nuk gjendet në dosjen e procedurës në fjalë), është dërguar para kësaj date, pa marrë më parë miratimin me shkrim të titullarit të AK dhe KVO.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 24, pikat 3 dhe 4, të cilat përcaktojnë se: “3. Në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, autoriteti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit. 4. Autoriteti kontraktor boton njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është botuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit për anulim”.

Për këto veprime mban përgjegjësi anëtari i njësisë së prokurimit

Procedura e zhvilluar në Korrik 2016

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 4, datë 18.07.2016		
Vlera e përlllogaritur e kontratës 916,000 lekë pa TVSH		
Procedurë “Kërkesë për propozim” Hapja e ofertave datë 28.07.2016	..., kryetare	
... SHPK. Vlera 2,983,580 lekë pa tvsh
Kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik Skualifikuar 2 operatorë ekonomik	Urdhri nr. 64, datë 18.07.2016	
Kontrata nr. 268, datë 08.09.2016, me vlerë 3,580,296 lekë me tvsh.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...	Komisioni për përlllogaritjen e vlerës së kontratës:	

Me shkresën nr. 106, datë 18.07.2016, drejtuar titullarit të AK, anëtari i njësisë së prokurimit ..., i propozon rishpalljen e procedurës së anuluar.

Me Urdhër Prokurimin nr. 4, datë 18.07.2016, titullari i AK ka urdhëruar rinisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, me fond limit 3,337,178 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim, me të njëjtën njësi prokurimi.

Me urdhrin nr. 64, datë 18.07.2016, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë drejtor i drejtorisë juridike, juriste, Kryetare,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të buxhetit, ekonomiste dhe
3. ... me detyrë specialiste e sektorit të prokurimeve, inxhinieri agrare anëtare.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *“Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit”*.

-KVO nuk ka në përbërje të tij ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti fushës”*.

-Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: *“Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 25.07.2016, faqe 43. Data e hapjes së ofertave do jetë data 28.07.2016.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 28.07.2016. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës se paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	... SHPK	2,983,580	Kualifikuar	1
2	... SHPK	3,294,580	Kualifikuar	2
3	...	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	
4	... SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	

Sipas procesverbalit të vlerësimit të ofertave, datë 10.08.2016, KVO vendosi të skualifikojë ofertat e OE që nuk kanë paraqitur ofertë, të skualifikojë ofertën e OE ... SHPK për arsye se mungon vërtetimi i pagesës së sigurimeve shoqërore, si dhe të kualifikojë e të shpallë fituese ofertën e OE ... SHPK me vlerë 3,294,580 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr. 19, datë 11.08.2016, protokolluar në RSU1 me nr. 690, datë 15.08.2016, OE ... SHPK ka paraqitur ankesën e tij në lidhje me vlerësimin e kryer.

Me urdhrin nr. 7, datë 16.08.2016, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës, si dhe ka ngarkuar komisionin e shqyrtimit të ankesës të përbërë nga ..., ... dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Me shkresën nr. 690/1, datë 19.08.2016, drejtuar OE ... SHPK, titullari i AK e njofton mbi pranimin e ankesës.

Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të APP, konstatohet se OE ... SHPK ka paraqitur Vërtetimin nr. 18523, datë 14.07.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, me anë të të cilit vërteton se për periudhën deri në 13.07.2016, OE ... SHPK nuk ka detyrime tatimore për TVSH, tatimin mbi fitim, tatimin e mbajtur në burim, tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për pasojë KVO e ka skualifikuar këtë operator në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 453 "*Shqyrtimi i ofertave*". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Raporti përmbledhës, mban datën 30.08.2016, si dhe është pasqyruar rivlerësimi në bazë të shkresës së mësipërme, duke shpallur fitues ofertën e OE ... SHPK me vlerë 2,983,580 lekë pa tvsh.

Në DT, janë kërkuar mostra për 15 prej materialeve të kërkuara. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe ai i gjendur në dosjen e prokurimit, nuk konstatohet dokumentacion mbi marrjen dhe dorëzimin e këtyre mostrave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 22 "*Format e komunikimit*". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

OE ... SHPK, ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës çelur pranë shoqërisë ... me nr. 0019143, datë 01.09.2016, me vlerë 358,030 lekë.

Kontrata nr. 268, datë 08.09.2016, me vlerë 3,580,296 lekë me tvsh, me afat 180 ditë nga momenti i nënshkrimit, është nënshkruar nga znj. ... për RSU1 dhe z. ... për ... SHPK.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 268/1, datë 08.09.2016, nuk konstatohet të jetë publikuar në buletin e APP, në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në lidhje me këtë kontratë, nuk është kryer asnjë pagesë për llogari të furnitorit, për arsye të vështirësive ekonomike që ka AK, specifikuar kjo dhe në pikën 18.1 të kontratës. Por lidhja e kontratës pa patur në dispozicion fondet për këtë kontratë, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se: "*Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor*".

6. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie", Qershor 2015.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 2, datë 26.06.2015
Vlera e përlogaritur e kontratës 2,166,735 lekë pa TVSH	..., kryetar	...
Procedurë "Kërkesë për propozim" Hapja e ofertave datë 10.07.2015
... SHPK. Vlera 1,886,500 lekë pa tvsh	Urdhri nr. 93, datë 26.06.2015	...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik		
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik Skualifikuar 4 operatorë ekonomik		
Kontrata nr. 371, datë 21.08.2015, me vlerë 2,263,800 lekë me tvsh.		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...	Komisioni për përlogaritjen e vlerës së kontratës:	

Me Urdhrin nr. 69, datë 28.04.2015, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e komisionit të testimit të tregut për përcaktimin e fondit limit për procedurën “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie”, bazuar në kërkesat për materiale nr. 111, datë 107.05.2015.

Sipas procesverbalit pa numër protokolli, datë 25.06.2015, komisioni i ngritur për përlogaritjen e vlerës së kontratës, e ka përlogaritur atë në vlerën 2,166,735 pa tvsh, duke marrë çmimet më të ulëta të ofertave të administruara si më poshtë:

1. ...,
2. ... dhe
3. ... SHPK.

Me Urdhër Prokurimin nr. 2, datë 26.06.2015, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozërie”, me fond limit 2,166,735 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim.

Me urdhrin nr. 93, datë 26.06.2015, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, Kryetar,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit financiar dhe
3. ... me detyrë drejtore e drejtorisë së shërbimeve studentore, anëtare.

Në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO. Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: “Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit”. Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: “Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 06.07.2015, faqe 49-50. Data e hapjes së ofertave do jetë data 10.07.2015.

Në DT të publikuara, përcaktohet se kandidatët ofertues duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në vlerën 43,334.7 lekë. Por kërkimi i sigurimit të ofertës, për procedurat nën kufirin e lartë monetar, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 49, pika 1, e cila përcakton se: “Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 18, pika 1, e cila përcakton se: “Në procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, sipas këtij neni. Në këtë rast, siguri i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 10.07.2015. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës se paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	...	1,886,500	Kualifikuar	1
2	...	2,000,000	Kualifikuar	2
3	... &	1,757,900	S`kualifikuar	
4	...	1,894,600	S`kualifikuar	
5	...	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	
6	...	Nuk ka paraqitur ofertë	S`kualifikuar	

Nga auditimi i procedurës elektronike, konstatohet se “Dorëzimi i ofertave” nuk është mbyllur në datën 10.07.2015, por në datën 21.07.2015, pra 11 ditë me vonesë, duke e lënë të hapur mundësinë për dorëzimin e ofertave të tjera pas datës së fundit. Veprim në kundërshtim me “Manualin e përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik për KVO”, të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik. **Për këtë veprim mban përgjegjësi njësia e prokurimit** (në mungesë të përcaktimit nëpunësit të autorizuar të njësive së prokurimit).

Sipas Raportit Përmbledhës datë 30.07.2015, KVO vendosi të kualifikojë OE ... dhe... SHPK, të skualifikojë OE ..., ... & , ... dhe ..., si dhe të shpallë fituese ofertën e OE ... me vlerë 1,886,500 lekë pa tvsh.

Formulari i njoftimit të fituesit datë 30.07.2015, është publikuar në buletin e APP datë 03.08.2015, faqe 147-149.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë në kualifikimin e OE ofertues.

... SHPK

Një ndër arsye se skualifikimit të ofertës së OE ... SHPK, është fakti që nuk ka sjellë mostrat e kërkuara, për arsye se në DT, janë kërkuar mostra për 12 prej materialeve të kërkuara.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe ai i gjendur në dosjen e prokurimit, nuk konstatohet dokumentacion mbi marrjen dhe dorëzimin e këtyre mostrave për asnjë prej OE



pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 22 "*Format e komunikimit*". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit (për mungesën e dokumentacionit) dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (për vlerësimin e kryer).

Bashkimi i OE ... &

Në lidhje me këtë bashkim OE, KVO e ka skualifikuar për arsyet si më poshtë:

-Nuk ka mundur të paraqesë vërtetimin që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore.

Në lidhje me këtë kriter, OE ... SHPK, ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 35265, datë 20.05.2015, me anë të të cilit vërteton se: "*...nuk ka detyrime në TVSH, Tatim Fitimi, TAP dhe Sigurime shoqërore & shëndetësore dhe detyrime të tjera*", ndërsa OE SHPK, ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 44947, datë 26.06.2015, i cili përcakton se: "*...me përgjegjësi tatimore në TVSH, Tatim Fitimi, Tatim në Burim, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe TAP, sipas verifikimeve nga sistemi tatimor rezulton se deri më datë 26.06.2015, nuk ka detyrime të papaguara*". Siç rezulton dhe nga këto vërtetime tatimore, bashkimi i OE ... & , konstatohet ti ketë sjellë vërtetimet që ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, e për pasojë nuk duhej skualifikuar për këtë kriter. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

-OE nuk ka sjellë vërtetim banke në raport me përqindjen e kontratës së bashkëpunimit.

Nga auditimi i procedurës elektronike dhe dokumentacionit elektronik, u konstatua se OE nuk ka sjellë vërtetim për plotësimin e gjendjes së kërkuar monetare në bankë. Ndërsa OE ... SHPK ka sjellë vërtetimin e bankës BKT nr. 601, datë 09.07.2015, me anë të të cilit vërteton se ka gjendje vlerën 242,000 lekë, që e tejkalon vlerën e kërkuar.

-Nuk janë përcaktuar zërat e punës në kontratën e bashkëpunimit siç është parashikuar në LPP.

Në kontratën e bashkëpunimit të datës 08.07.2015, OE ... & , kanë përcaktuar se të gjitha furnizimet do i kryejnë së bashku duke bashkuar mjetet financiare, mjetet e punës dhe burimet njerëzore, por një ndarje e tillë është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 74 "Bashkimi i OE".

OE ..., ka sjellë formularin e sigurimit të kontratës çelur pranë shoqërisë ... me nr. 0016220, datë 19.08.2015, me vlerë 226,380 lekë.

Kontrata nr. 371, datë 21.08.2015, me vlerë 2,263,800 lekë me tvsh, me afat 180 ditë nga momenti i nënshkrimit, është nënshkruar nga znj. ... për RSU1 dhe z. ... për

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 371/1, datë 21.08.2015, nuk konstatohet te jetë publikuar në buletin e APP, në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2.

Në kontratën nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, konstatohet se afati i kësaj kontrate është 180 ditë nga momenti i lidhjes deri në momentin e dorëzimit të plotë. Por në dokumentet e tenderit (DT) të publikuara, kreu I "Njoftimi i kontratës", pika 2.3 "Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin", përcaktohet se kohëzgjatja e kontratës do jetë 30 ditë, pra është zgjatur kohëzgjatja e kontratës me 150 ditë (5 muaj) më tepër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Zgjatja e afatit të kontratës me 150 ditë (5 muaj), e kryer në mënyrë të paargumentuar, duke shkelur kështu barazinë midis operatorëve ekonomikë, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 59 dhe 60. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Zbatimi i kontratës

Me Urdhrin nr. 6, datë 21.08.2015, titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e komisionit të kolaudimit të përbërë nga ... kryetare, ..., ..., ... dhe ..., anëtarë. Kolaudimi do kryhet në zbatim të Udhëzimit të titullarit të AK nr. 373/1, datë 21.08.2015.

Kontraktori ..., ka sjellë mallin e kontraktuar i cili është bërë hyrje në magazinë, me anë të fletë-hyrjeve si më poshtë vijon:

Nr.	Numri i fletë-hyrjes	Data e fletë-hyrjes	Vlera (me tvsh)
1	17	13/10/2015	808,140
2	18	13/10/2015	447,000
3	19	13/10/2015	150,480
4	21	14/10/2015	228,180
5	22	14/10/2015	198,240
6	25	14/10/2015	36,000
7	1	07/12/2015	30,960
8	2	14/01/2016	33,480
9	6	01/03/2016	38,880
10	11	30/03/2016	42,840
11	17	30/05/2016	35,280
12	18	20/06/2016	48,240
13	24	19/08/2016	41,760
14	25	19/08/2016	124,320
		Shuma	2,263,800

Në kontratën nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, konstatohet se afati i kësaj kontrate është 180 ditë nga momenti i lidhjes deri në momentin e dorëzimit të plotë. Pra data e fundit e dorëzimit të mallit do jetë data 17.02.2016. Siç shikohet dhe nga tabela e mësipërme, kontraktori ... ka sjellë mallrat për 6 fatura në vlerë 331,320 lekë, ose në masën 15% të kontratës, pas datës së fundit të afatit të ekzekutimit të kontratës.

Për pasojë AK, në zbatim të kontratës nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, neni 22 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”, duhet të llogariste dëme të likuiduara për vonesa në zbatim të kontratës. Meqë vlera kontratës e mbetur e pa realizuar, është 15% e kontratës fillestare, në zbatim pikës 24.1 “Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar”, të shtojcës 16 “Kushtet e përgjithshme”, të DT të publikuara, pjesë përbërëse e kontratës nr. 371, datë 21.08.2015, vlera mbi të cilën do llogariten kamatëvonesat është 25% i kontratës ose vlera 565,950 lekë. Nga data 17.02.2016 deri më datë 19.08.2016, kur ka ardhur partia e fundit e mallit, janë 184 ditë kalendarike. Për pasojë, **shuma e kamatëvonesave në vlerën 416,539 lekë** (565,950 lekë * 184 ditë * 4/1000), **përbën dëm ekonomik për llogari të RSU1 dhe Buxhetin e Shtetit**.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të kolaudimit, të ngritur me Urdhrin e titullarit të AK nr. 6, datë 21.08.2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në lidhje me këtë kontratë, për llogari të furnitorit, për arsye të vështirësive ekonomike që ka AK, specifikuar kjo dhe në pikën 18.1 të kontratës, është paguar vlera 1,405,620 lekë. Por lidhja e kontratës pa patur në dispozicion fondet për këtë kontratë, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 70, i cili përcakton se: *"Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor"*.

**7. Në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje karburant", viti 2015.
Procedura e zhvilluar në Gusht 2015, Anuluar.**

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 4, datë 31.08.2015		
Vlera e përlogaritur e kontratës 1,083,333 lekë pa TVSH		
Procedurë "Kërkesë për propozim" Hapja e ofertave datë 10.09.2015	..., kryetar	
Anuluar
Kanë marrë pjesë 1 operator ekonomik
Kualifikuar 0 operator ekonomik Skualifikuar 1 operator ekonomik	Urdhri nr. 114, datë 31.08.2015	...
Anuluar		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...		

Me Urdhër Prokurimin nr. 4, datë 31.08.2015, titullari i AK ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburant", me fond limit 1,083,333 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim.

Me urdhrin nr. 114, datë 31.08.2015, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, Kryetar,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit financiar dhe
3. ... me detyrë drejtore e drejtorisë së shërbimeve studentore, anëtare.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO.

-Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *"Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit"*.

-KVO nuk ka në përbërje të tij ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti fushës"*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: *“Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 07.09.2015, faqe 35. Data e hapjes së ofertave do jetë data 10.09.2015.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 10.09.2015. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas vlerësimit të dokumentacionit ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës se paraqitur	Kualifikuar ose S`kualifikuar	Klasifikuar
1	... SHA	16% marzh fitimi	S`kualifikuar	

Pas vlerësimit të kryer, KVO vendosi të skualifikojë OE ... SHA, për arsye se: *“Mungon vërtetimi i tatimeve për Sigurimet Shoqërore dhe mungon Autorizimi i tregtimit të Karburanteve nga Pushteti Lokal”*.

Në lidhje me vërtetimin e tatimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, OE ... SHA, ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 59560, datë 24.08.2015, i cili përcakton se: *“...Me përgjegjësi tatimore në TVSH, Tatim Fitimi, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore dhe TAP, Tatim në Burim. Subjekti nuk ka detyrime”*.

KVO në vlerësimin e saj nuk duhej ta skualifikonte këtë OE për këtë kriter, pasi sipas vërtetimit tatimor të sipërpërmendur, ky OE e ka plotësuar këtë kriter. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 *“Shqyrtimi i ofertave”* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Me shkresën nr. 915, datë 16.09.2015, OE ... SHA, ka paraqitur ankesën e tij në lidhje me procesin e vlerësimit. Me Urdhrin nr. 8, datë 16.09.2015, titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komisionin e përbërë nga ..., ... dhe

Me shkresën nr. 915/1, datë 18.09.2015, drejtuar OE ... SHA, titullari i AK e njofton mbi mos-pranimin e ankesës. E konkretisht:

-Nga komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk është marrë parasysh fakti që ky OE e ka plotësuar kriterin për paraqitjen e vërtetimit të pagesës së sigurimeve shoqërore e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

shëndetësore, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesës.

-Në lidhje me autorizimin, komisioni ka përcaktuar se marrëveshja e lidhur me shoqërinë ..., është në kundërshtim me LPP për arsye se ka tejkalluar masën 40% të lejuar nga ligji për nënkontraktimin, si dhe OE ... është i përjashtuar nga prokurimet publike sipas buletinit të APP.

Me anë të Raportit Përmbledhës datë 02.10.2015, titullari i AK miraton anulimin e procedurës, i cili është publikuar në buletinin e APP datë 12.10.2015, faqe 218.

Procedura e zhvilluar në tetor 2015, Anuluar.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 5, datë 05.10.2015		
Vlera e përllogaritur e kontratës 1,083,333 lekë pa TVSH		
Procedurë "Kërkesë për propozim" Hapja e ofertave datë 15.10.2015	..., kryetar	
Anuluar
Kanë marrë pjesë 0 operator ekonomik
Kualifikuar 0 operator ekonomik Skualifikuar 0 operator ekonomik	Urdhri nr. 132, datë 05.10.2015	...
Anuluar		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...		

Me Urdhër Prokurimin nr. 5, datë 05.10.2015, titullari i AK ka urdhëruar ri-nisjen e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburant", me fond limit 1,083,333 lekë pa tvsh, me procedurë kërkesë për propozim, pas anulimit të procedurës së parë. Por nga AK nuk janë analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurës së parë, përpara nisjes së procedurës së dytë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 73, pika 2, e cila përcakton se: "Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës". Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Me urdhrin nr. 132, datë 05.10.2015, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, Kryetar,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit financiar dhe
3. ... me detyrë drejtore e drejtorisë së shërbimeve studentore, anëtare.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO.

-Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: "Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit".



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-KVO nuk ka në përbërje të tij ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *“Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti fushës”*.

-Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: *“Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasys në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Formulari i njoftimit të kontratës publikohet në buletin e APP datë 12.10.2015, faqe 3395. Data e hapjes së ofertave do jetë data 15.10.2015.

Tenderi është zhvilluar me mjete elektronike në datën 15.10.2015. Në datën e hapjes së ofertave, nuk është paraqitur asnjë ofertues. Me anë të Raportit Përmbledhës datë 16.10.2015, titullari i AK miraton anulimin e procedurës, i cili është publikuar në buletin e APP datë 26.10.2015, faqe 246.

Procedura e zhvilluar në Tetor 2015, me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake të kontratës”.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi nr. 6, datë 23.10.2015		
Vlera e përlogaritur e kontratës 1,083,333 lekë pa TVSH		
Procedurë “Negocim pa shpallje paraprake të kontratës” Hapja e ofertave datë 29.10.2015	..., kryetar	...
OE ... SHA me 9% marzh fitimi
Kanë marrë pjesë 2 operator ekonomik
Kualifikuar 2 operatorë ekonomik Skualifikuar 0 operator ekonomik	Urdhri nr. 144, datë 23.10.2015	
Kontrata nr. 477, datë 02.11.2015, me vlerë 1,299,999.6 lekë me tvsh		
Titullari i Autoritetit Kontraktor: ...		

Me Urdhër Prokurimin nr. 6, datë 23.10.2015, titullari i AK ka urdhëruar ri-nisjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant”, me fond limit 1,083,333 lekë pa tvsh, me procedurë negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, pas anulimit të procedurës së dytë. Por nga AK nuk janë analizuar shkaqet që çuan në dështimin e procedurës së dytë, përpara nisjes së procedurës së tretë me negocim pa shpallje paraprake të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1" SHA, TIRANË"

njoftimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 73, pika 2, e cila përcakton se: *"Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës"*, si dhe neni 36, pika 2, germa c, e cila përcakton se: *"Në të gjitha rastet, autoriteti duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme apo situata emergjente nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij"*. Për këtë veprim mban përgjegjësi titullari i AK.

Me urdhrin nr. 144, datë 23.10.2015, ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave, i përbërë nga:

1. ... me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve, Kryetar,
2. ... me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit financiar dhe
3. ... me detyrë drejtore e drejtorisë së shërbimeve studentore, anëtare.

Gjithashtu në pikën 2 të këtij urdhri është përcaktuar që zv. drejtori i përgjithshëm ... do mbikqyrë veprimtarinë e KVO.

-Kryetari i KVO, nuk është zgjedhur ndërmjet zyrtarëve të lartë të AK, për arsye se në organikën e RSU nr. 1, janë të emëruar 3 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *"Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit"*.

-KVO nuk ka në përbërje të tij ekspertë të fushës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, i cili përcakton se: *"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona, ku të paktën njëri është eksperti fushës"*.

-Gjithashtu RPP, nuk parashikojnë detyrën e mbikëqyrësit të procedurës së prokurimit, detyrë për të cilën është përgjegjës titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK. Për këto veprime mban përgjegjësi titullari i AK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në dosjen e kësaj procedurë prokurimi, nuk u gjetën deklaratat e konfliktit të interesit për personat pjesëmarrës në këtë procedurë, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 16 dhe neni 56, i cili përcakton se: *"Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasys në emërimin e një nëpunësi prokurimi. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar"*. Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zv. Drejtori i përgjithshëm i ngarkuar për mbikëqyrjen e kësaj procedure prokurimi.

Me shkresat nr. 1108, 1109 dhe 1110, datë 23.10.2015, titullari i AK i ka dërguar ftesë për ofertë OE ... SHA, ... SHA dhe ... SHA. AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar arsyen e përzgjedhjes së këtyre ofertuesve, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 36, pika 4, e cila përcakton se: *"Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikën 2, shkronja "b", pikën 3, shkronja "b", dhe pikën 5, të nenit 33 të LPP-së, autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre. Në çdo rast, autoriteti*



kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të fitojë". Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit dhe titullari i AK. Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave, datë 29.10.2015, konstatohet se kanë marrë pjesë OE si më poshtë:

1. ... SHA me marzh fitimi 9% dhe
2. ... SHA me marzh fitimi 9.5%.

Me anë të Raportit Përmbledhës datë 29.10.2015, të miratuar nga titullari i AK, vendoset të shpallet fituese oferta e OE ... SHA Durrës me marzh fitimi 9%.

Kontrata nr. 477, datë 02.11.2015, me vlerë 1,299,999.6 lekë me tvsh, me marzh fitimi 9%, me afat deri më 31.12.2016, është nënshkruar nga znj. ... për RSU1 dhe z. ... për ... Durrës SHA.

Formulari i njoftimit të kontratës, nuk konstatohet te jetë publikuar në buletin e APP, në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 6, pika 2.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, mbi procedurat e prokurimit, sqarojmë se observacioni është pjesërisht i argumentuar nga ana dokumentare dhe ligjore, për pasojë merret pjesërisht në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me argumentet si më poshtë:

Së pari pretendimi juaj mbi përllogaritjen e fondit limit qëndron, e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Së dyti, pretendimi juaj mbi deklaratat e konfliktit të interesit nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 56, paragrafi i dytë, si dhe neni 64, pika 2.

Së treti, pretendimi juaj mbi skualifikimin e ofertës së OE ... SHPK, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 3

Së katërti, pretendimi juaj mbi kolaudatorin e punimeve nuk qëndron, për arsye se është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 12.

Së pesti, pretendimi juaj mbi përzgjedhjen e OE të ftuar në procedurën e zhvilluar me negociim, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 36, pika 4.

Së gjashti, pretendimi juaj në lidhje me kualifikimin dha shpalljen fituese të ofertës së OE ... SHPK, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me LPP.

Së gjashti, pretendimi juaj në lidhje me kualifikimin dha shpalljen fituese të ofertës së OE ... SHPK, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me LPP.

Së shtati, pretendimi juaj mbi kryetarin e KVO nuk qëndron, për arsye se në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 58, kryetari i KVO duhet të përzgjidhet midis zyrtarëve më të lartë të AK, e në këtë rast njëri nga zëvendës drejtorët e përgjithshëm, që shoqëria juaj ka 3 të tillë.

Së teti, pretendimi juaj mbi efektin negativ financiar në vlerën 1,351,571 lekë, të shkaktuar në procedurat e zhvilluara me objekt "Rikonstruksioni i sistemit elektrik në godinat 15,18,19", qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, dërguar nga OE ..., sqarojmë se observacioni nuk është i argumentuar nga ana dokumentare



dhe ligjore, për pasojë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me argumentet si më poshtë:

Së pari, pretendimi juaj mbi vonesat në dorëzim, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me kontratën nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve.

Së dyti, në kontratën nr. 371, datë 21.08.2015, të nënshkruar midis palëve, nuk përmendet pretendimi juaj mbi dorëzimin e materialeve të çimentos, rërës, granilit dhe gëlqeres.

VII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për prokurimet me vlerë të vogël

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Nga auditimi i shpenzimeve me procedurën e blerjeve me vlera të vogla, evidentojmë se ato janë të përfshira në një regjistër si dhe çdo 4/mujor janë dërguar me realizimin e tyre.

Për vitin 2015 dhe 2016, nga titullari janë nxjerrë urdhrat për krijimin e komisionit për blerjet me vlera të vogla (Urdhri nr.15, datë 26.02.2016).

Gjatë vitit 2015 shoqëria ka realizuar blerje me vlera të vogla për lëndë djegëse pellet për kaldajë, në vlerën 400,000 lekë, për dezifektimin dhe deratizimin e rezidencave në vlerën 666,637 lekë si dhe për kancelari, shtypshkrime, internet e telefon, pjesë këmbimi për makineri e pajisje, shërbime për makina në shumën 446,000 lekë.

-Në zbatim të shkresës së MASH nr.4232 datë 03.08.2015, për trajtimin e 45 studentëve të huaj dhe Urdhrit të Ministrit të Arsimit nr.266, datë 08.07.2015, “ Për hapjen e kursit veror të gjuhës shqipe për shtetasit e huaj pranë Universitetit të Tiranës, 1-30 Shtator 2015”, shoqëria ka kryer procedurën për blerjet me vlera të vogla për këtë shërbim për vlerën 200,150 lekë. Këtë procedurë e ka fituar dhe realizuar personi fizik Gjatë kontrollit të mëparshëm të kryer nga grupi i KLSH, ishte evidentuar se personi fizik ... nuk dispononte leje nga shërbimi Inspektoriatit të Kontrollit Ushqimor. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezultoi se komisioni kishte kërkuar nga subjekti nëse e dispononte këtë leje.

-Në procedurën për blerje lëndë djegëse pellet të filluar me urdhërin e prokurimit nr. 3, prot 97 datë 11.02.2015 u konstatua se komisioni pasi ka testuar tregun për përcaktimin e fondit limit dhe ka marrë tre oferta të datës 09.02.2015, dhe me proces verbalin e datës 10.02.2015 është caktuar fondi limit. Me proces verbalin e datës 11.02.2015 komisioni i prokurimit me vlera të vogla i përbërë nga z. ..., znj. ... dhe znj. ... vendosin për caktimin e fituesit duke shqyrtuar treguesit e çmimeve të paraqitura në proces verbalin e datës 10.02.2015. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” duke mos marrë më oferta të tjera për vazhdimin e procedurës së prokurimit.

Gjatë vitit 2016 shoqëria ka realizuar blerje me vlera të vogla për mbushje fikëse zjarri me pluhur ABC, për 154 copë fikëse me një vlerë 223,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se subjekti fitues nuk kishte licensë për mbushje fikëse zjarri por për kurse të formimit profesional.

Me urdhërin e prokurimit nr. 265, datë 06.09.2016 është filluar procedura e blerjes së shërbimit të dezifektimit dhe deratizimit të godinave me vlerë 666,638 lekë. Në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor kishte specifikuar se operatori ekonomik fitues duhet të paraqitet një orë pas hapjes së ofertës së bashku me mostrat e preparateve të cilat duhet të ishin prodhuar në një nga vendet e BE-së. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion



u konstatua se fotokopiet noterizuara, të faturave dhe deklaratave doganore të preparateve të kërkuara nga AK, ishin të palexueshme dhe si rrjedhojë të pavlefshme për qëllimin e kërkuar. Subjekti fitues nuk kishte sjellë një license nga QKL për shërbimin që ofronte.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit për blerjet me vlera të vogla.

VIII. Mbi auditimin me zgjedhje të shpenzimeve të kryera me anë të arkës dhe bankës

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me arkë në lekë:

Nga auditimi i veprimeve të kryera rast pas rasti, nëpërmjet arkës në lekë, për periudhën 01.10.2014-31.12.2016 rezultoi se, regjistrimet kontabile në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël, bazuar në dokumentet justifikuese. Të gjitha mandatarkëtimet dhe mandatpagesat janë plotësuar dhe firmosur në rregull, sipas të dhënave të dokumenteve justifikuese dhe për çdo muaj është kuadruar ditari i arkës me gjendjen e librit të arkës konform me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në Rezidencën Studentore Universitare Nr.1 sh.a, janë përkatësisht katër Rezidenca familjare konkretisht 15/a,15/b,18 dhe 19, ambientet e të cilave u janë dhënë me qira banorëve familjarë dhe dy Rezidenca hoteleri konkretisht 1 dhe 13. Aktiviteti i këtyre Rezidencave monitorohet dhe evidentohet në regjistrat përkatës, në bazë të dokumentacionit të arkës, në të gjitha arkëtimet e kryera nga banorët. Regjistrimi i të ardhurave nga rezidencat familjare dhe ato hoteleri bëhet në mënyrë periodike. Tarifat e aplikuar janë në përputhje me ato të miratuara në Këshillin Mbikqyres të Shoqërisë. Çdo muaj mbahen akt rakordime me administratorët respektivë të këtyre rezidencave për të ardhurat e arkëtuara gjatë muajit si dhe mbahen akt rakordime me Përgjegjësën e Planifikimit Financiar për të ardhurat e arkëtuara në arkë, për këto rezidenca. Çdo muaj raportohet për banorët familjarë debitorë në rezidencat familjare.

Viti 2015- Në vitin 2015 tarifat e aplikuar janë në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës. Kontratat e lidhura janë me afat maturimi 1 vit. Rezidencat familjare. Më 31.12.2015 rezultojnë:

Rezidenca 15/a-37 kontrata të lidhura *Rezidenca 15/b* - 48 kontrata të lidhura 1 banor pa kontratë *Rezidenca 18-73* kontrata të lidhura, 1 banor pa kontratë *Rezidenca 19-33* kontrata të lidhura, 4 banorë pa kontratë.

Gjatë këtij viti realizimi i të ardhurave të planifikuara për rezidencat familjare është 19,956,300 lekë ose 88.9 % e planifikimit, kjo si pasojë e mos arkëtimin në kohë të detyrimeve. Vlera e debitoreve për vitin 2015 deri më 31.12.2015 është 2,491,320 lekë. Gjatë vitit 2015 janë shlyer edhe detyrime të prapambetura për llogari të vitit 2014 në shumën 425,500 lekë.

-Rezidencat hoteleri.

Kapaciteti akomodues i rezidencave hoteleri është 234 persona, konkretisht Rezidenca 1 – 102 persona dhe Rezidenca 13 – 132 persona. Janë lidhur kontrata me të gjithë personat që banojnë në këto Rezidenca. Realizimi i të ardhurave të planifikuara për vitin 2105 është 19,339,943 lekë ose 100% e planifikimit.

Viti 2016-Rezidencat familjare.

Në vitin 2016, tarifat e aplikuar janë në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës Nr.1, datë 26.01.2015 “Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të qerasë në rezidencat familjare” dhe vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm Nr.1, datë 08.01.2016, Nr.1/1, datë 15.01.16 dhe



Nr.7, datë 29.01.2016, mbi tarifrat që do të aplikohen në secilën rezidencë. Kontratat e lidhura janë me afat maturimi 1 vit. Më 31.12.2016 rezultojnë:

Rezidenca 15/a-32 kontrata të lidhura 3 banorë pa kontratë *Rezidenca 15/b-44* kontrata të lidhura (1person i larguar gjatë vitit), 3 banorë pa kontratë *Rezidenca 18-58* kontrata të lidhura (6 persona të larguar gjatë vitit), 1 banor pa kontratë *Rezidenca 19-29* kontrata të lidhura, 1 banor pa kontratë.

Gjatë këtij viti realizimi i të ardhurave të planifikuara për rezidencat familjare është 13,460,500 lekë ose 87 % e planifikimit, kjo si pasojë e mos arkëtimit në kohë të detyrimeve. Vlera e debitore për vitin 2016 deri më 31.12.2016 është 2,009,250 lekë. Gjatë vitit 2016 janë shlyer edhe detyrime të prapambetura për llogari të vitit 2015 në shumën 2,026,500 lekë.

-Rezidencat hoteleri.

Realizimi i të ardhurave të planifikuara për vitin 2106 është 20,052,041 lekë ose 100% e planifikimit.

Nga dokumentacioni i arkës, që ju vu në dispozicion grupit të auditimit vihet re një numër i madh veprimesh nëpërmjet arkës me lekë në dorë, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 62-65.

Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me bankë në lekë:

Nga auditimi i veprimeve të kryera me zgjedhje, nëpërmjet bankës në lekë dhe valutë, për periudhën 01.10.2014-31.12.2016 rezultoi se, regjistrimet kontabile në ditarin e bankës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël, bazuar në dokumentet justifikuese dhe çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të bankës. Nga auditimi për kontabilizimin e veprimeve në ditarin e bankës rezultoi se, urdhërpagesat ishin pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konform me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, KREU III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/ “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”. Bashkëlidhur urdhërpagesave ka dokumentacionin justifikues si fatura, procesverbal të marrjes në dorëzim, urdhër prokurimi, kopje e fletëhyrjes etj.

Janë bërë pagesa për penalitetet për deklarim, pagesë të vonuar të Sigurimeve Shoqërore në bankën BKT me datë 04.09.2015, në vlerën **4,120,215 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, shumë e cila përbën **efekt negativ financiar** për shoqërinë dhe mban përgjegjësi ish Administratori i RSU Nr. 1 z.... dhe zj.... me detyrë ish-drejtores e departamentit ekonomik.

Nga faqja on-line e Rezidencës Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, gjoba të regjistruara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (deklarim i vonuar) në vlerën 330,000 lekë, si dhe gjoba të regjistruara për Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi në vlerën 3,400,640 lekë dhe interes i regjistruar në vlerën 526,757 lekë.

Në total është **vlera 4,257,397 lekë gjoba dhe interes** për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe për Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, shumë e cila përbën **efekt negativ financiar** për shoqërinë dhe mban përgjegjësi z. ... me detyrë ish Drejtor Drejtorja e Planifikimit Strategjik e Financiar në RSU1.

-Nga auditimi në lidhje me analizën e shpenzimeve të mjeteve të transportit.

Sektori i shërbimeve, siguron mbështetjen e veprimtarisë së institucionit me shërbimet e mjetet e vëna në dispozicion për krijimin e kushteve sa më të mira për punë të personelit të RSU Nr. 1, siguron bazën e nevojshme materialo-teknike me pajisje, inventarin e nevojshëm dhe rezervat për vazhdimësinë normale të punës, ndjek, kontrollon dhe zbaton



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

mirëadministrimin dhe mirëmbajtjen e godinave, automjeteve, pajisjeve, aparaturave, etj, në inventar të RSU Nr. 1, dhe kryerjen e shërbimeve nga të tretë në RSU Nr. 1, harton dhe zbaton programin vjetor të shpenzimeve për automjetet, mirëmbajtjen e godinave, pajisjeve dhe mjeteve në inventar të RSU Nr. 1, siguron dhe ushtron kontrollin teknik të gadishmërisë së automjeteve dhe plotësimin e dokumentacionit të qarkullimit të tyre, kujdeset për funksionimin e mjeteve të komunikimit, si dhe përmbushjen e shërbimeve të tjera të nevojshme për veprimtarinë normale të RSU Nr. 1.

Për vitin 2015. Gjatë kësaj periudhe kanë lëvizur për nevojat e shoqërisë 8 automjete. Fletë udhëtimet janë të plotësuara sipas rregullave të përcaktuara. Në to janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e makinave: data, vendi i nisjes, vendi i mbërritjes, kilometrat e përshkruara si dhe janë të firmosura nga personat të cilët kanë kryer këto lëvizje. Fletë udhëtimet janë të firmosura edhe nga përgjegjësi i parkut, i cili konfirmon edhe kilometrat e përshkruara nga këto automjete. Për këtë periudhë, në bazë të rakordimit të kryer ndërmjet fletë daljeve të magazinës së Inventarit, rezulton se është tërhequr nga magazina 6076 litra karburant + 90 lit. gjendje në serbator. Në bazë të fletë udhëtimeve rezulton të jetë harxhuar 6054.5 litra karburant. Nga sa më sipër, gjëndja në mjete në fund të kësaj periudhe është 111 litra karburant.

Automjetet janë të paisur me dokumentat e qarkullimit, leje qarkullimi, taksa të paguara, siguracion TPL. Janë kryer në kohë sipas ligjit kontrollet teknike vjetore për të gjithë automjetet. Normativa e konsumit të karburantit për çdo mjet është bërë në përputhje me rregulloren, përkatësisht me Vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm nr.80, datë 01.02.2014, nr.235, datë 13.05.2014, nr.251, datë 23.06.2014, nr.54, datë 13.03.2015, nr.79, datë 26.05.2015.

Nr	TARGA	Emërtimi i automjetit	Normativa V 2014 /15 l/100 km	Km/ Përshkruara	Furnizim + Gjendje V.2015	Harxhim V.2015	Furnizi+ Gjendje V.2016	Harxhim V.2016
1	...	Iveco kamion	19	50.76	42	9.75	31.69	20.22
2	...	Benz (bot uji)	1.2lit/dp	73dp	120	87.6	103.40	64.80
3	...	Benz Unhcr	25	344.66	88	86.17	21.84	0
4	...	Benz	10	7680.58	770	768.06	621.94	620.40
5	...	Benz furgon	14.4	230.34	39	33.17	55.83	49.13
6	...	Dum-Dum	4	2720.05	115	108.80	126.20	125.77
7	...	Skania	195lit/muaj	4823	2358	2338	2360	2358
8	...	Benz	15	17487	2634	2623.05	2370.95	2365.50
	TOTALI				6,166	6,054.59	5,691.85	5,603.8

Për vitin 2016. Gjatë kësaj periudhe kanë lëvizur për nevojat e shoqërisë 7 automjete. Për këtë periudhë, në bazë të rakordimit të kryer ndërmjet fletë daljeve të magazinës së Inventarit, rezulton se është tërhequr nga magazina 5620 litra karburant. Në bazë të fletë udhëtimeve rezulton të jetë harxhuar 5603.8 litra karburant. Krahasuar me vitin 2015 kemi një ulje të sasisë së përdorur të karburantit, nga 6054.5 litra, në 5603.8 litra karburant të harxhuar për vitin 2016. Pra kemi një ulje të sasisë së harxhuar të karburantit me 451 litra. Nga sa më sipër, gjëndja në mjete në fund të kësaj periudhe është 88 litra karburant.



IX. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në lidhjen e kontratave dhe arkëtimin e qirave për ambientet e dhëna me qira individëve dhe subjekteve.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Për periudhën 2014- 2015, janë 3 kontrata qiraje dhe 1 kontratë me miratimin e METE, me dokumentacion shoqërues, tarifa të miratuara dhe arkëtimi i detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata të shoqëruara me vendime e Këshilli Mbikqyrës të Shoqërisë. Dokumentacioni shoqërues i këtyre kontratave është në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar me VKM nr.735, datë 05.11.02014. Të gjitha tarifat e aplikuar në kontrata janë në përputhje me Vendimet e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë nr.11, datë 20.02.2014. Sipërfaqet e përcaktuara në kontrata, janë referuar genplaneve dhe planimetrisë për secilin objekt të dhënë me qira, të hartuara nga ekspertët topograf të licencuar dhe të konfirmuara Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë. Detyrimet financiare në zbatim të nenit 5, pika 5.3 të kontratës, si pasoje e shlyerjeve me vonesë janë aplikuar kamatë vonesa në masën 1% të vlerës së qerasë mujore. Sa më sipër, konkretisht:

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 960/1, datë 09.05.2014-09.05.2015 (1 vjeçare)

Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 39 m². Ndodhur në Godinën nr.18 të Qytetit Studenti

Vlera kontratë 23,400 lekë/muaj me NUIS-

... dhe ...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 960/2, datë 09.05.2014-09.05.2015 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 26 m². Ndodhur në godinën nr.18 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 15,600 lekë/muaj

me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 1198, datë 08.09.2014-08.09.2015 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 13 m². Ndodhur në ambientet e brendshme të godinës (Holle) të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 7,800 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 7578/1, datë 26.08.2010-26.08.2020 (10 vjeçare) - METE

Sipërfaqe të përgjithshme 545 m², prej nga nën objekt 374 m² dhe sipërfaqe funksionale 171 m², ndodhur në ish-Mencën nr.1 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 124,000 lekë/muaj me NUIS- ...

Për periudhën 2015-2016 janë 3 kontrata qiraje dhe 1 kontratë me miratimin e METE, me dokumentacion shoqërues, tarifa të miratuara dhe arkëtimi i detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata të shoqëruara me vendime e Këshilli Mbikqyrës të Shoqërisë dhe konkretisht:

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 244, datë 26.05.2015-26.06.2016. Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 100 m². Ndodhur si urë lidhëse ndërmjet dy objekteve të ish-kompleksit të shërbimeve të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 60,000 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “Shërbime me artikuj kancelarie, mjete mësimore, materiale ndihmëse për studentët”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Kontratë Nr.Prot. 499, datë 19.11.2015-19.11.2016 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 200 m². Ndodhur pranë lavanterisë së Qytetit Studenti. Vlera kontratë 120,000 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 357, datë 20.08.2015-20.08.2016 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 39 m². Ndodhur në Godinën nr.18 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 23,400 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 7578/1, datë 26.08.2010-26.08.2020 (20 vjeçare) – METE. Sipërfaqe të përgjithshme 545 m², prej nga nën objekt 374 m² dhe sipërfaqe funksionale 171 m², ndodhur në ish-Mencën nr.1 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 124,000 lekë/muaj me NUIS- ...

Për periudhën 2016- e në vazhdim, janë 3 kontrata qiraje dhe 1 kontratë me miratimin e METE, me dokumentacion shoqëruar, tarifa të miratuara dhe arkëtimi i detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata të shoqëruara me vendime e Këshilli Mbikqyrës të Shoqërisë dhe konkretisht:

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 54, datë 08.02.2016-08.02.2017 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 13 m². Ndodhur në ambientet e brendëshme të godinës (Holle) të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 7,800 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 55, datë 08.02.2016-08.02.2017 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 100 m². Ndodhur si urë lidhëse ndërmjet dy objekteve të ish-kompleksit të shërbimeve të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 60,000 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 247, datë 25.08.2016-25.08.2017 (1 vjeçare). Sipërfaqe të përgjithshme nën objekt prej 39 m². Ndodhur në Godinën nr.18 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 23,400 lekë/muaj me NUIS- ...

...- Objekt Kontrate “”

Kontratë Nr.Prot. 7578/1, datë 26.08.2010-26.08.2020 (20 vjeçare) – METE, përfaqësura nga z. Igli Stambolla, Drejtor i Administrimit të Pronës Publike në këtë Ministri, në autorizimit të Ministrit, nr. 7578, datë 19.08.2010. Sipërfaqe të përgjithshme 545 m², prej nga nën objekt 374 m² dhe sipërfaqe funksionale 171 m², ndodhur në ish-Mencën nr.1 të Qytetit Studenti. Vlera kontratë 124,000 lekë me NUIS- ...

Mbi territorin e RSUNR.1 dhe problematikat që ka aktualisht:

Sipërfaqja e territorit të Qytetit Studenti sipas regjistrimit fillestar, të bërë në vitin 2009 dhe të miratuar me VKM nr. 403, datë 22.04.2009 “Për miratimin e Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë anonime Trajtimi i Studentëve Nr.1”, është 248,435m², nga të cilat 27,604 m², është sipërfaqe ku janë të ndërtuara të gjitha godinat, 24,000 m² është sipërfaqja që zënë rrugët lidhëse ndërmjet godinave si dhe sheshet në brëndësi të qytetit. Sipërfaqja prej 121,174 m² është territor lulishte, fusha sportive dhe ambiente të gjelbëruara. Nga kjo sipërfaqe totale afërsisht 75,657 m² është territor i qytetit që është i zënë nga ndërtimet informale të banimit.

Objektet në administrim të “Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1” janë:

- 29 godina banimi, nga të cilat 26 janë godina banimi për studentët, aktualisht janë të ndara, 6 godina që banohen nga djem dhe 20 godina nga vajzat.
- 3 godina të tjera të cilat kanë qënë për studentët, banohen nga familjarë, të cilët janë të vendosur në këto godina prej 20 vitesh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

- Një godinë dy katëshe për administratën dhe bibliotekën.
- Një godinë tre- katëshe me objekt veprimtarie “Magazinë”.
- Një godinë dy-katëshe me objekt “Lavanteri”.
- Një godinë dy-katëshe me objekt “ Kaldajë”.

Në territorin e Qytetit Studenti është dhe godina e ish mensës, e cila ka një sipërfaqe prej 3,517 m² dhe me Vendimin nr. 526 dt.12.07.2010 të Ministrisë së Ekonomisë u bë privatizimi i saj.

Në territorin e Qytetit Studenti është dhe godina e ish-kinoklubit Studenti 1315.3 m², godinë kjo që kishte në funksionin e saj ambiente kulturore, ambiente studimi, sallë kinemaje dhe me Vendim nr. 921 dt. 28.12.2010 të Ministrisë së Ekonomisë kaloi në administrimin e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, për fakultet të Drejtësisë.

Gjendja aktuale e territorit të Qytetit Studenti është si më poshtë vijon:

Në total territori i regjistruar është 141,657 m². Nga territori i përgjithshëm prej 248,435 m² në pronësi të RSUNR.1, nga ZVRPP-ja i janë hequr 75,657 m² dhe nuk janë regjistruar në pronësi të saj. Sipas ZVRPP-së ky territor ishte i regjistruar më përpara në pronësi të subjekteve private me vendime gjyqate, ALUIZNI apo KKP-së (Komisionit Kthimit Pronave).

Nëse heqim dhe sipërfaqen 1,315.3 m², godinë kjo që kishte në funksionin e saj ambiente kulturore (ish-kinoklubi), ambiente studimi, sallë kinemaje dhe me Vendim nr. 921 dt. 28.12.2010 të Ministrisë së Ekonomisë kaloi në administrimin e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, për fakultet të Drejtësisë, atëherë **sipërfaqja totale që shoqëria RSU1 ka humbur deri më 31.12.2016, është 74,341.7 m².** Në këtë vlerë, përfshihet dhe sipërfaqja e legalizuar, për të cilën shoqëria nuk dispononte statistika mbi saktësinë e kësaj vlere.

Çmimet e fundit të miratuara për tokën truall për zonat kadastrale zk 8160 dhe zk 8190, ku është trualli i shoqërisë RSU1, janë miratuar me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe janë që për është 66,969 lekë/m² për zk 8160 dhe 33,755 lekë/m² për zk 8190. Në pamundësi të përcaktimit të saktë të sipërfaqes së humbur për secilën zonë kadastrale, grupi i auditimi ka llogaritur çmimin mesatar të pronës së truallit të shoqërisë që është në vlerën **50,362 lekë/m².**

Duke e llogaritur me vlerën që ka pasur në për metër katror në bazë të të çmimit mesatar për dy zonat kadastrale zk 8160 dhe zk 8190, të miratuara me VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, **vlera e truallit që ka ngelur jashtë pronës së shoqërisë është 3,743,996,695 lekë** (74,341.7 m² x 50,362 lekë/m²), **e cila është vlera e humbur nga kapitali i shoqërisë.**

Ky territor është i zënë nga ndërtime informale përpara viteve 2000 si dhe një pjesë e tij është i lirë por i regjistruar në pronësi të ish pronarëve.

Nga drejtimi i shoqërisë dhe departamenti i financës dhe departamentet përkatëse, nuk është kryer analiza e situatës së aseteve të shoqërisë.

RSUNr.1 ka përfunduar regjistrimin e gjithë ndërtesave dhe truallit të Qytetit Studenti pranë ZVRPP-së më datë 06.01.2015. Konkretisht trualli i Qytetit Studenti është i ndarë në dy zona kadastrale, përkatësisht zk 8160 dhe zk 8190. Trualli që i përket zonës kadastrale 8160 është regjistruar më datë 23.06.2014, ndërsa trualli që i përket zonës kadastrale 8190 ka përfunduar regjistrimin më 06.01.2015. Nga territori i përgjithshëm i zonës kadastrale nr.8160 në pronësi të RSUNr.1 është regjistruar pranë ZVRPP-së territori me sipërfaqe prej 105,669 m², ndërsa në zonën kadastrale me nr. 8190 është regjistruar territori me sipërfaqe prej 35,988 m².

Pas regjistrimit të territorit të zonës 8160, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka njoftuar për shpallje pavlefshmërie të certifikatës së pronësisë me Nr 5/611



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

vol 34 faqe 26 zk 8160 në datën 05.01.2016 nëpërmjet shkresës me Nr. Prot.5, dt. 05.01.2016. Sipas Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme pavlefshmëria e kësaj certifikate pronësie vjen si pasojë e një Vendimi Gjykate të Shkallës së Parë, Tiranë me Nr. 8235 datë 12.05.2014 në të cilin është vendosur kthim të sipërfaqes S1 - 4,900 m², S2 - 4,750 m², njohjen e të drejtës së Parablerjes për godinat Nr.3, Nr.4, Nr.5, Nr.7 si dhe kompensim të sip. 810 m² zënë me rrugë kalimi personit Duke marrë parasysh faktin që procesi gjyqësor është ndjekur në hallkat e gjyqësorit nga ana e Avokaturës së Shtetit, RSUNr.1 i është drejtuar kësaj të fundit me kërkesën për të vazhduar procedurat gjyqësore për pezullimin e veprimeve pranë Gjykatës së Lartë. Pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, dosja ka kaluar për shqyrtim pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu nëpërmjet shkresës Nr. 6472 Prot datë 03.03.2016 Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka bërë me dije RSU Nr.1 se keni mbivendosje të dy numrave pasurie për certifikatën Nr.5/611 me Rektoratin e Universitetit të Tiranës të cilët kanë paraqitur për regjistrim Vendimin Nr. 988, datë 09.12.2015 të Këshillit të Ministrave tek e cila në Nr. Rendor 19 janë shtuar terrenet sportive, të cilat janë pjesë e territorit të certifikatës në fjalë të regjistruar në pronësi të Qytetit Studenti. Sa më sipër RSUNr.1 Tiranë, ndodhen pranë situatës së mbivendosjes së dy titujve të pasurisë si dhe vendimit të gjykatës së apelit për njohjen, kthimin dhe kompensimin e një sipërfaqe të konsiderueshme trualli në brëndësi të pasurisë Nr. 5/611 zk 8160. Aktualisht është përgatitur dhe është dërguar për miratim pranë Bashkisë së Tiranës një projekt-propozim i hartuar nga një bashkëpunim i RSUNr.1, ALUIZNIT dhe AKKP-së, mbi vijën kufizuese përfundimtare të territorit të RSUNr1.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 39, i cili përcakton se: “*Ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje që, në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, cenojnë veprat kryesore të infrastrukturës publike, akset rrugore kombëtare, territorin e institucioneve publike, integritetin e monumenteve të kulturës nuk legalizohen. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*”, VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar, kreu II, pika 2, gërma c, e cila përcakton se: “*Ndërtimi informal i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi kur: c) është ngritur brenda vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike (institucione shtetërore, shkolla e kopshte publike, spitale, qendra shëndetësore publike, kampuse studentore);”.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. ... me detyrë drejtor i drejtorisë së planifikimit strategjik e financiar dhe znj. ..., drejtore e përgjithshme.

X. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Vlerësimi i funksioneve të sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Nga auditimi rezultoi se, menaxhimi financiar nuk ka funksionuar në shoqëri, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

punonjësit e saj dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pika 15, germa “a”, njësia për vitin 2015-2016, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2015, shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

-Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësisë të Sektorit Publik”, germa “a” shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Për shoqërinë Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, nëpunësi autorizues është Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik.

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit ekonomik-financiar është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar në RSU.

-Të gjitha angazhimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i institucionit.

-Në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Kap. III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

-Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 2 dhe 8.b dhe neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, germa “ç”, njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

-Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

-Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, “Monitorimi” njësia nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

-Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk



ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

-Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

-Ekziston një sistem mbrojtës për aktivet afatgjata dhe aktivet e vlefshme për institucionin, përfshirë këtu dhe të dhënat personale përballë aksesit dhe përdorimit të autorizuar.

-Të gjitha transaksionet janë të dokumentuara dhe për dokumentimin e tyre veprohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

-Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit. Në shoqërinë Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike.

-Titullari informohet në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Financiar, për gjëndjen financiare në çdo kohë. Në bazë të këtij informacioni menaxheri i institucionit shtron domosdoshmërinë e realizimit të prioriteteve që ka institucioni.

-Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Për këto veprime, mban përgjegjësi z. ... me detyrë z/Drejtor i Përgjithshëm në RSU, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, sqarojmë se observacioni nuk është i argumentuar nga ana dokumentare dhe ligjore, për pasojë merret pjesërisht (për formularët e vetëvlerësimit) në konsideratë në hartimin e këtij Projektraporti Auditimi.

Vlerësimi i funksionimit të auditit të brendshëm.

Auditimi mbi funksionimin e auditimit të brendshëm u bazua në të dhënat e nxjerra nga dosjet e auditimit vënë në dispozicion të grupit të auditimit. Në përfundim të auditimit u konstatua se:

-Organizimi dhe funksionimi i auditimit të brendshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Rezidencën Studentore Universitare Nr.1 Tiranë, funksionon si zyrë, sipas Vendimit nr.3, datë 14.11.2013 të Këshillit Mbikqyrës dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm. Sipas strukturës miratuar me vendimin e mësipërm të Këshillit Mbikqyrës, Njësia e Auditimit përbëhet nga një “specialist auditimi”. *Për pasojë, ky subjekt nuk ka të miratuar në strukturën e tij, njësi auditimi sipas kërkesave të nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pika 3 e VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, por operon me një specialist auditimi, i cili auditoron gjithë veprimtarinë.*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Në Rregulloren e Rezidenca Studentore Universitare Nr.1sh.a Tiranë, miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, me Vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr.20, datë 09.10.2014, neni 13, *Auditi i Brendshëm trajtohet si “Zyrë” duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “Sektori i Auditit të Brendshëm ka në misionin e tij realizimin e auditimit të brendshëm të të gjithë veprimtarisë ekonomike-financiare të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.* Kjo mospërputhje mes Rregullores së brendshme të shoqërisë dhe strukturës organike të miratuar nga Këshilli Mbikqyrës, në përcaktimin e njësisë së auditimit të brendshëm, *bie në kundërshtim me e nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pikës 3 të VKM-së nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.*

Bazuar në Rregulloren e Administratës neni 13, janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të auditimit. Specialisti i auditimit, ushtron veprimtarinë e tij bazuar në:

-Ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, *shfuqizuar me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,* Urdhërin e Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 “Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, shfuqizuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

-Udhëzimi i Ministrise se Financave nr.12, datë 05.06.2012 “Për procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

-Manuali Specifik dhe Karta e Auditimit të Brendshëm Publik si dhe me aktet nënligjore që e shoqërojnë atë, Statutin dhe Rregulloret e ndryshme.

-Hartimi i planeve të auditimit të brendshëm. Përgatitja dhe hartimi i programeve të auditimit, llojet e auditimit.

Për periudhën Tetor-Dhjetor 2014, vitin 2015 dhe vitin 2016, programi i punës i hartuar nga specialisti i auditimit është bazuar në organikën ekzistuese në momentin e hartimit si dhe duke patur parasysh periudhën e pa audituar. Në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 shfuqizuar me ligjin114/2015, datë 22.10.2015, Specialisti i Auditimit ka hartuar planin vjetor të auditimit për periudhën e audituar si dhe planin strategjik të auditimit, referuar kërkesave të ligjit dhe kërkesave të “Manualit të Auditimit të Brendshëm”. (Nuk është dërguar asnjëherë shkresë për drejtorinë e përgjithshme të auditimit).

Në programin e auditimit për vitin 2014 (Tetor Dhjetor), ishin parashikuar 19 auditime, nga të cilat 17 tematik dhe 2 të plota, duke përcaktuar dhe afatin e auditimit. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar të gjitha auditimet e përcaktuara.

Në hartimin e planit të auditimit për vitin 2014, specialisti i auditimit, është mbështetur në: Përfshirje në plan të subjekteve të cilët mbartin risk të lartë. Në frekuencën e auditimit prej jo më pak se një herë në tre muaj. Në renditjen kronologjike të kohës së kryerjes së auditimit, rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm dhe rekomandimeve të dërguara.

Programet e punës për misionet e auditimit (të plota dhe tematike) janë hartuar në zbatim të planit vjetor të auditimit dhe ndryshimeve të tij gjatë vitit.

Fushat prioritare në të cilat janë mbështetur misionet e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2014,vazhdojnë të jenë të njëjta me ato të vitit 2013, prokurimet me vlera të vogla, tenderat, veprimet financiare të kryera me arkë dhe llogarive bankare, magazinat, sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Rezidencat studentore, realizimi i të ardhurave nga godinat e familjarëve. Përsa i përket arkivimit të dosjeve të auditimit, konstatohet se ato janë arshivuar. Nga Specialisti i Auditimit konstatohet se janë respektuar kërkesat e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik për hartimin dhe miratimin e planeve vjetorë e strategjikë të veprimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Për vitin 2015, në programin e auditimit, ishin parashikuar 67 auditime me afatin përkatës të auditimit. Gjatë kësaj periudhe ishin realizuar në fakt 67 auditime nga të cilat, 52 janë auditime tematike dhe 15 të plota. Në hartimin e planit të auditimit, specialisti i auditimit, është mbështetur në:

- Përfshirjen në planin e auditimit të subjekteve të cilët mbartin risk të lartë.
- Në frekuencën e auditimit prej jo më pak se një herë në tre muaj.
- Në renditjen kronologjike të kohës së kryerjes së auditimit, rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm dhe rekomandimeve të dërguara.
- Ndërsa programet e punës për misionet e auditimit (të plota dhe tematike) janë hartuar në zbatim të planit vjetor të auditimit dhe ndryshimeve të tij gjatë vitit.

Fushat prioritare në të cilat janë mbështetur misionet e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për vitin 2015, kanë qenë:

- Prokurimet me vlera të vogla, tenderat, veprimet financiare të kryera me arkë dhe llogarive bankare.

- Magazinat, sektorët e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Rezidencat studentore.

- Realizimi i të ardhurave nga godinat e familjarëve.

a-Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2015, më hollësisht jepet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr.50; Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2015

Nr.	Lloji i auditimit	Parashikuar numër	Realizuar Numër	Diferenca
1.	I plotë	15	15	-
2.	Tematik	52	52	-
	Shuma	67	67	-

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH

Nga auditimi për vitin 2015, nuk janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore si dhe dëme ekonomike. Përsa i përket arkivimit të dosjeve të auditimit, konstatohet se ato janë të arkivuara konform ligjit për arkivat.

Në programin e auditimit për vitin 2016, ishin parashikuar kryerja e auditimeve në 5 fusha/sisteme, të cilët mbulojnë të gjithë aktivitetin e shoqërisë, me afatin përkatës të auditimit. Sistemet në të cilat janë kryer auditimet janë:

- Pagesat për mallra dhe shërbime
- Pagesat për pagat e personelit
- Prokurimet Publike
- Administrimi i vlerave materiale
- Mbledhja e të ardhurave

Plani i angazhimeve për vitin 2016 konsiston në tre auditime të përputhshmërisë dhe dy auditime të kombinuara (auditime të përputhshmërisë dhe auditime financiare). Gjatë kësaj periudhe janë realizuar të gjitha auditimet e planifikuara. Në hartimin e planit të auditimit për vitin 2016, specialisti i auditimit, është mbështetur në:

- Përfshirje në plan të subjekteve të cilët mbartin risk të lartë.
- Në frekuencën e auditimit prej jo më pak se një herë në tre muaj.
- Në renditjen kronologjike të kohës së kryerjes së auditimit, rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm dhe rekomandimeve të dërguara.

Ndërsa programet e punës për misionet e auditimit (të plota dhe tematike) janë hartuar në zbatim të planit vjetor të auditimit dhe ndryshimeve të tij gjatë vitit.

Fushat prioritare në të cilat janë mbështetur misionet e auditimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për vitin 2016, kanë qenë të njëjta me ato të viti 2015.

Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2016, më hollësisht jepet në pasqyrën e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Tabela nr.51; Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2016

Nr.	Lloji i auditimit	Parashikuar Numër	Realizuar Numër	Diferenca
1.	Auditime të Përputhshmërisë	3	3	-
2.	A. të kombinuara (A. përputhshmërisë dhe A. financiare)	2	2	-
	Shuma	5	5	-

Burimi i të dhënave nga grupi auditimit të KLSH

Nga auditimi për vitin 2016, nuk janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore si dhe dëme ekonomike. Përsa i përket arkivimit të dosjeve të auditimit, konstatohet se ato janë të arkivuara konform ligjit për arkivat. Janë respektuar kërkesat e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik për hartimin dhe miratimin e planeve vjetorë e strategjikë të veprimit.

-Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditit. Hartimi i Raportit final të auditimit dhe sigurimit të cilësisë.

Planifikimi dhe realizimi i auditimeve për vitin 2015-2016, të kryera nga specilisti i auditimit paraqitet si vijon:

-Nga specialisti i auditimit në Trajtimi i Studentëve Nr.1sh.a Tiranë nuk janë konstatuar dhe evidentuar shkelje me dëm ekonomik.

Masat rekomanduese lidhen kryesisht në drejtim të mbajtjes së mbylljen e aktiviteteve jofitim prurëse, reduktimin e fuqisë punëtore.

Gjithashtu konstatohet se nga Specialisti i Auditimit nuk është audituar në drejtim të zbatimit të nenit 12 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, mbi emërimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues. Gjatë auditimit të dosjeve nga Specialisti i Auditimit, mbi hartimin e raportit final u vlerësua se janë ndjekur fazat e auditimit sipas kërkesave të Manualit të Procedurave të Auditimit. Janë ndjekur hapat nga Auditi, i cili ka dërguar njoftim paraprak me shkrim në çdo subjekt për njoftim 10 ditë para se fillimit të misionit të auditimit, siç përcaktohet në kreun II, pika 1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Raporti Final i Auditimit është hartuar mbështetur në Projektraportin e Auditimit, në diskutimin dhe shqyrtimin e materialeve gjatë takimit pajtues, etj.

Hartimi i raporteve finale është bërë në përputhje me strukturat dhe kërkesat e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm.

Rishikimi i Raportit Final nuk është kryer nga Auditi pasi nuk funksionon si strukturë më vete dhe nuk është hartuar raporti i rishikimit të cilësisë me arsyetimin e sipërm..

Rekomandimi i masave është mbështetur në gjetjet dhe zbulimet gjatë auditimit dhe në dispozitat ligjore. Synimi kryesor ka qënë përmirësimi i punës në të ardhmen nga subjekti, me qëllim realizimin e objektivave dhe përdorimin me efektivitet të fondeve në përputhje me dispozitat ligjore. Pas formulimit të raportit final dhe memorandumit, janë evaduar materialet e auditimit duke adresuar përfundimet e tij. Janë dërguar Raportet e Auditimit në subjektin e audituar. Përgjithësisht raportet finale, rekomandimet paraqiten korrektë dhe në përputhje me trajtimet në p/raportin si dhe në referencë të legjisllacionit mbështetës vendosur në referencë trajtimit dhe dokumentacionit të dosjes. Rekomandimet janë bërë pjese e projektraportit referuar standardit të ri.

- Verifikimi i zbatimit të detyrave të lëna dhe masat e marra nga subjekti i audituar.

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk ka një plan të veçantë tematik të aprovuar për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportet finale për çdo subjekt, pasi rekomandimet janë të karakterit organizativ.

Ndjekja e rekomandimeve është kryer nëpërmjet konfirmimit zyrtar nga subjektet për zbatimin e tyre, si dhe duke e parashikuar zbatimin e rekomandimeve të lëna si një pikë të vecantë të auditimit në të gjitha programet e auditimit. Sikurse përcaktohet dhe në objektin e



auditimit të brendshëm, referuar nenit 7, germa a/ i të pikes 1, të Ligjit nr 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, objektivi strategjik i tij është dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit. Arritja e këtij objektivi përcaktohet nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, duke treguar gjithashtu dhe përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Përfundimisht, nga verifikimet e kryera, vlerësojmë se: Nga drejtuesit janë pranuar pjesërisht propozimet për masa dhe rekomandimet.

-Evadimi i materialeve të auditimit. Në këtë drejtim është hartuar programi i auditimit i miratuar nga titullari i institucionit. Nga auditimi të Rezidenca Studentore Universitare Nr.1sh.a Tiranë, për çdo rast janë mbajtur shënimet e nevojshme që janë bërë pjesë e sistemit inventarial të dosjes, krahas dokumenteve dhe evidencave të tjera justifikuese. Dosjet përmbajnë të dhënat për emrin e subjektit të audituar dhe kohën e përfundimit të auditimit. Për çdo dosje, inventari është vendosur në kapakun e dosjes.

Programe trajnimi për kualifikimin e audituesve: *Nga analiza e procesit të formimit profesional, përditësimit të njohurive dhe edukimit të përditësuar, vërejmë se gjatë vitit 2015, nuk janë kryer trajnimet e detyrueshme, ndërsa gjatë vitit 2016, është kryer trajnimi i detyrueshëm, që sipas normave të MAB janë 40 orë në vit, detyrim ky që rrjedh nga neni 20 i Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, shfuqizuar, dhe neni 20 i Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 ku theksohet që “Të gjithë audituesit e çertifikuar në detyrë,...i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në dy vjet.*

XI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve.

Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se:

Ndërmarrja “Trajtimi i Studentëve Nr. 1” Sha Tiranë, në pronësi të Ministrisë së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes funksionon në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Me ndryshimet e ndodhura në Statusin e shoqërisë, miratuar me shkresën nr. 3436/1, datë 14.05.2015, të Ministrit të MZHETTS, ndryshohet emërtimi i shoqërisë në “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” Sha Tiranë.

Më pas, me Statusin e shoqërisë të miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 27004, datë 08.09.2016, pronësia e shoqërisë i kalon 100% Bashkisë Tiranë, në zbatim të VKM nr. 335, datë 04.05.2016 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i studentëve nr. 2” sh.a., Tiranë dhe “Trajtimi i studentëve nr. 3” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”.

Objekti i shoqërisë, i përcaktuar dhe në status dhe në ekstraktin e QKB, është “*Trajtimi në fjetore dhe menca i studentëve të Universitetit Tiranë. Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambjente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentet. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qera të ambjenteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.”.*

Ndërsa në Statusin e miratuar nga Ministri i MZHETTS me shkresën nr. 3436/1, datë 14.05.2015, i ndryshuar me Statusin e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 731, datë 13.09.2016, në nenin 2, përcaktohet objekti i shoqërisë si vijon: “**2.1 Trajtimi në**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

fjetore dhe menca i studentëve të Universitetit Tiranë. Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambjente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentet. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qera të ambjenteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.

2.2 Shoqëria në zbatim të legjislacionit në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

2.3 Shoqëria e gjendur në kushte të zënies së katër godinave familjare prej vitesh nga rreth 200 familjarë me probleme socialë-ekonomike dhe të pastrehë, ka krijuar me këta të fundit një marrëdhënie kontraktuale, jo fitimprurëse, nëpërmjet kontratave individuale qeramarrës-qeradhënës në kushtet e pamundësisë për ti nxjerrë nga këto godina.”.

Në lidhje me familjarët e 4 godinave të zëna, shoqëria nuk ka ndjekur përfitimin nga ana e këtyre personave të statusit “Të pastrehë”, që këto persona të përfitojnë strehimin në banesat sociale të ofruara nga Bashkia Tiranë, me qëllim lirim të godinave për studentët.

Konstatuam se megjithëse është lënë detyrë dhe nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, për të ardhurat që realizohen nga dhënia me qira e ambienteve për të tretët, si edhe nga akomodimi i studentëve, edhe pse RSU1 është një shoqëri anonime, nuk aplikon fatura tatimore për shërbimet që kryhen. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 46, i cili përcakton se: “1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku regjistrohen:

a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;

b) veprimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;

c) veprimet e patatueshme;

ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit.

3. Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor, në përputhje me këtë ligj. Për këtë qëllim, tatimpaguesi detyrohet të afishojë në një vend të dukshëm, në adresën ku kryen veprimtarinë, një njoftim për blerësin në përputhje me këtë nen.”; nenin 49, i cili përcakton se: “1. Çdo shitblerje mallrash apo të drejtash, si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi, që është pjesë e veprimtarisë tregtare, është objekt faturimi.

2. Faturat për shitjen e sendeve apo kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat përfshihen në përllogaritjet e detyrimit tatimor.

3. Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit apo shërbimit, emërtimin e saktë të tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe, nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera, të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.”, nenin 54, i cili përcakton se: “1.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.

4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

5. Deri në datën 31.3.2016, për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor, të lëshuar nga pajisja fiskale, nuk duhet të tejkalojnë 10 për qind të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhë tatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. Nga data 1 prill 2016, tatimpaguesit, që kryejnë shitje me shumicë të mallrave, nuk lejohen të shesin me kupon tatimor të blerës, joushtrues të një veprimtarie tregtare (individë”).

Nga auditimi konstatohet se, pagesat e kryera nga studentët që gjenerojnë të ardhura për strehimin e tyre në bujtina, procedohet duke plotësuar mandat arkëtimet që në fillim ose gjatë vitit arsimor. Pagesat e studentëve kryhen kryesisht në bankë. Të ardhura për vitet 2014, 2015 dhe 2016, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2014 (lekë)	Viti 2015 (lekë)	Viti 2016 (lekë)
1	Të ardhura nga Studentët	231,159,723	203,335,923	209,110,514
2	Të ardhurat nga qiratë në godinat familjare	22,244,000	22,516,320	13,291,750
3	Të ardhurat nga objektet me qira	1,208,594	2,153,874	4,074,622
4	Të ardhura nga lavanderia	778,150	686,710	937,650
5	Të ardhura të tjera	682,700	445,820	3,411,800
6	Të ardhura nga subvencionet	156,020,458	155,519,178	150,000,000
	Totali	412,093,625	384,657,825	380,826,336

Në lidhje me të ardhurat që krijohen nga akomodimi i studentëve, shoqëria i kategorizon këto të ardhura, si të ardhura nga qiraja. Konkretisht, shoqëria ka lidhur me studentët “Kontrata Akomodimi”, por në bazën ligjore të këtyre kontratave përmend nenet 801, 802 të Kodit Civil, nene që i përkasin Kreut VI “Qiraja”. Por përdorimi i këtyre dispozitave është i gabuar, për arsye se:

-Sipas ekstraktit historik dhe statusit të shoqërisë, objekti i veprimtarisë është “*Trajtimi në fjetore dhe menca i studentëve të Universitetit Tiranë*”, pra kemi të bëjmë me **shërbimin e hotelierisë**.

-Shoqëria përveç trajtimit në godina, studentëve u ofron dhe shërbime të tjera të sanksionuara dhe në objektin e veprimtarisë dhe statusin e saj, si “*Prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambienteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelbërim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambjente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentet. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qera të ambjenteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.*”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 53, gërma h, përcakton se: “Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

h)dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

ii)strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelierisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;”, pra shërbimi i hotelierisë, nuk është i përjashtuar nga detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Shoqëria “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, SHA, Tiranë, në observacionet e dërguara me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, për efekte të detyrimit të tatimit të vlerës së shtuar (TVSH), pretendon se zbaton Udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “Qendrat e trajtimit të studentëve që subvencionohen me fonde shtetërore, të cilat funksionojnë posaçërisht për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të studentëve konviktet ose mensat, shërbimi i fjetjes dhe i mensës kur i ofrohet studentëve ose nxënësve është i përjashtuar nga TVSH-ja, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor. Këto qendra duhet të vërtetojnë në çdo rast që shërbimi që ato ofrojnë i është ofruar studentëve dhe jo të tretëve, me rekomandim të universitetit publik. Përndryshe shërbimi i kryer prej tyre është i tatueshëm me TVSH.” Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, të ardhurat që shoqëria përfiton nga akomodimi i studentëve janë të përjashtuara nga detyrimi për TVSH, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor, ndërsa shërbimi i akomodimit të familjarëve është i tatueshëm me TVSH, e për të duhet të llogaritet detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), detyrim i cili është sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2014 (lekë)	Viti 2015 (lekë)	Viti 2016 (lekë)
1	Të ardhurat nga qiratë në godinat familjare	22,244,000	22,516,320	13,291,750
2	Të ardhura nga lavanderia	778,150	686,710	937,650
3	Të ardhura të tjera	682,700	445,820	3,411,800
4	Shuma e të ardhurave të tatueshme	23,704,850	23,648,850	17,641,200
5	Baza e tatueshme	19,754,042	19,707,375	14,701,000
6	Shuma e detyrimit për TVSH	3,950,808	3,941,475	2,940,200
7	Shuma e detyrimit për TVSH për 3 vitet		10,832,483	

Gjithashtu, për periudhën 2014-2016, konstatohet se **nuk është zbritur TVSH e rimbursueshme në përpjestim me të ardhurat e realizuara**, për blerjet dhe furnizimet që shoqëria ka kryer për periudhën 01.10.2014-31.12.2016.

Për sa më sipër, shoqëria për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka gjeneruar të ardhura nga shërbimet në vlerën 64,994,900 lekë, por për këto të ardhura **nuk ka paguar detyrimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), në vlerën 10,832,483 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ për të ardhurat e Buxhetin e Shtetit**

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 46 “Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore për tatimpaguesit, subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit”, Ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 1,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

pika 2, neni 2, germa a, neni 10, pika 1, nenin 53, germa h, e cila përcakton se: “Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja transaksionet e mëposhtme:

h)dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, përveç:

ii)strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;”,

si dhe me Udhëzimin nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton se: “Qendrat e trajtimit të studentëve që subvencionohen me fonde shtetërore, të cilat funksionojnë posaçërisht për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të studentëve konviktet ose mensat, shërbimi i fjetjes dhe i mensës kur i ofrohet studentëve ose nxënësve është i përjashtuar nga TVSH-ja, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor. Këto qendra duhet të vërtetojnë në çdo rast që shërbimi që ato ofrojnë i është ofruar studentëve dhe jo të tretëve, me rekomandim të universitetit publik. Përndryshe shërbimi i kryer prej tyre është i tatueshëm me TVSH.”.

Në lidhje me regjistrimin si objekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, nga shoqëria u vu në dispozicion vetëm kërkesa për regjistrim nr. 311, datë 31.03.2015, me anë të së cilës drejtori i përgjithshëm znj. ..., në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, autorizon znj. ..., drejtor në drejtorinë e planifikimit strategjik dhe financiar, të kryejë veprimet për regjistrimin e shoqërisë pranë organeve tatimore, konform ligjshmërisë tatimore dhe statutit. Përveç kësaj shkresë, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion dokumentacion tjetër në lidhje me regjistrimin e shoqërisë pranë organeve tatimore.

Në zbatim të Autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 22/2, datë 13.02.2017, protokolluar në DRTT me nr. 8445, datë 15.02.2017, grupi i auditimit verifikoi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) më datë 15.02.2017, dokumentacionin dhe statusin e shoqërisë. Nga verifikimi i kryer në DRTT, sipas Aktverifikimit nr. 1, datë 17.02.2017, protokolluar në DRTT me nr. 8445/1, datë 17.02.2017, u konstatua se:

-Kërkesa për regjistrim nr. 311, datë 31.03.2015, që shoqëria RSU1 kishte dërguar në DRTT, nuk gjendej në protokollin e shoqërisë për periudhën 31.01.2015-07.04.2015.

-Në dosjen e subjektit ndodhur në arkivën e DRTT nuk u gjenden pasqyrat financiare të shoqërisë, megjithëse vërtetuar nga libri i protokollit të RSU1, pasqyrat financiare ishin dorëzuar dorazi në DRTT, firmosur dhe nga përfaqësuesi i DRTT ...

-Në sistemin elektronik të tatimeve, konstatohet se shoqëria RSU1 është e regjistruar me kodin 7511 “Aktivitete të administrimit publik”, në kundërshtim me statusin dhe fushën e veprimtarisë së kësaj shoqëria (e cila vepron në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

-Sipas të dhënave të sistemit C@TS, nuk rezultojnë të deklaruara online pasqyrat financiare të viteve 2014 dhe 2015.

-Sipas sistemit elektronik të tatimeve, shoqëria është e regjistruar për përgjegjësinë tatimore: “2200, Tatim mbi të ardhurat nga Punësimi”, “2100, Kontribute shoqërore”, “1900, Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” dhe “1500, Tatim i mbajtur në burim”. Shoqëria nuk është e regjistruar për përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi vlerën e shtuar dhe Tatimit mbi fitimin.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 40 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”.

Problemi i mos regjistrimit të shoqërisë për TVSH dhe Tatim Fitimi, megjithëse në dy vite rresht edhe ekspertët kontabël theksojnë mungesën e formalitetit të aktivitetit, tregon se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

Këshilli Mbikqyrës nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vepruar për aspektet të cilat nga ana e ekspertëve të kontraktuar dhe paguar nga shoqëria, janë sjellë në vëmendje të drejtimit.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi:

-Znj. ... me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën objekt auditimi.

-Z. ... me detyrë zv. Drejtor i Përgjithshëm i shoqërisë për periudhën objekt auditimi, i ngarkuar për mbikëqyrjen e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Financiar, në zbatim të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 20, datë 09.10.2014, neni 5.

-Znj. ... me detyrë Drejtores e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Financiar për periudhën 01.10.2014-15.04.2015.

-Z. ... me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Financiar për periudhën 15.04.2015 e në vazhdim.

Për këtë gjetje, grupi i auditimit do rekomandonte që Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Financiar, të marrin masa për regjistrimin e shoqërisë pranë organeve tatimore, në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 40 “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”. Në zbatim të shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) nr. 13530/42, datë 03.04.2017 “Njoftim për aktivizimin e TVSH dhe Tatim Fitimit”, protokolluar në RSU1 me nr. 213, datë 07.04.2017, DRTT njofton shoqërinë RSU1 që duke filluar nga periudha Mars 2017, janë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore TVSH dhe Tatim Fitimi. Kjo shkresë ju vu në dispozicion grupit të auditimit, në takimin përfundimtar të realizuar në ambientet e KLSH më datë 18.04.2017.

Në zbatim të kësaj shkrese, rekomandimi i lënë në Projektraportin e Auditimit nga KLSH, quhet i ezauruar.

Problemi i mos regjistrimit të shoqërisë për TVSH dhe Tatim Fitimi, megjithëse në dy vite rresht edhe ekspertët kontabël theksojnë mungesën e formalitetit të aktivitetit, tregon se Këshilli Mbikqyrës nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka vepruar për aspektet të cilat nga ana e ekspertëve të kontraktuar dhe paguar nga shoqëria, janë sjellë në vëmendje të drejtimit.

Në përgjigje të observacionit dërguar nga RSU1, me shkresën nr. 8/2, datë 23.03.2017, protokolluar në KLSH me nr. 22/5, datë 23.03.2017, në lidhje me Projektraportin e Auditimit, mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për lidhjen e kontratave të strehimit të studentëve dhe familjarëve, sqarojmë se observacioni është pjesërisht i argumentuar nga ana dokumentare dhe ligjore, për pasojë merret pjesërisht në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, me argumentet si më poshtë:

Së pari, pretendimi juaj se nuk jeni subjekt i regjistrimit në organet tatimore për Tatimin mbi Fitimin dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, nuk qëndron për arsye se është në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 14, 51, 54, 55, 57, 64, 65, dhe 67, 2. Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenet 16, dhe 18, Ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 2,4, 10, 12, 31, 32, 106, 114.

Së dyti, pretendimi juaj se shërbimi i ofruar ndaj studentëve është shërbime qiraje, nuk qëndron sepse është në kundërshtim me Statutin e shoqërisë, i cili për studentët nuk përcakton shërbim qiraje, por shërbimin e trajtimi në fjetore dhe menca të studentëve. Forma e kontratës që ju keni lidhur, është në kundërshtim me Kodin Civil dhe Statutin e shoqërisë, për arsye se nuk duhet të ishte kontratë qiraje por kontratë akomodimi.

Së treti, pretendimi juaj mbi mos regjistrimin për përgjegjësinë tatimore të TVSH dhe Tatim Fitimit, nuk qëndron për arsye se në zbatim të shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) nr. 13530/42, datë 03.04.2017 “Njoftim për aktivizimin e TVSH dhe Tatim



Fitimit”, protokolluar në RSUI me nr. 213, datë 07.04.2017, DRTT njofton shoqërinë RSUI që duke filluar nga periudha Mars 2017, janë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore TVSH dhe Tatim Fitimi.

Së katërti, pretendimi juaj mbi detyrimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për të ardhurat që shoqëria përfiton nga studentët, qëndron e për pasojë merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi. Por në këtë rast, sipas paragrafit të përmendur nga ju të Udhëzimit nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet se: “Qendrat e trajtimit të studentëve që subvencionohen me fonde shtetërore, të cilat funksionojnë posaçërisht për këtë qëllim, duke vënë në dispozicion të studentëve konviktet ose mensat, shërbimi i fjetjes dhe i mensës kur i ofrohet studentëve ose nxënësve është i përjashtuar nga TVSH-ja, si shërbim i lidhur dhe i domosdoshëm për shërbimin arsimor. Këto qendra duhet të vërtetojnë në çdo rast që shërbimi që ato ofrojnë i është ofruar studentëve dhe jo të tretëve, me rekomandim të universitetit publik. Përndryshe shërbimi i kryer prej tyre është i tatueshëm me TVSH.”. Në këto kushte, në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, të ardhurat që shoqëria përfiton nga akomodimi i familjarëve, janë të ardhura akomodimi dhe si të tilla për to duhet të llogaritej detyrimi për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), në vlerën 10,832,483 lekë, vlerë e cila është efekt negativ për të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

KONKLUZIONI

Përkundër angazhimit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1”, SHA, Tiranë, për uljen e shpenzimeve dhe rritjen e të ardhurave, performanca e treguesve ekonomiko-financiar ka vend të përmirësohet.

Pasqyrat financiare të shoqërisë, tregojnë se gjendja kreditore është shqetësuese. Për përmirësimin e duhur të kësaj situate veprimet e organeve drejtuese duhet të intensifikohen më tej. Organet mbikëqyrëse të saj, duhet të jenë më aktive për të shqyrtuar aktivitetet e kryera nga administrata dhe rezultatet e arritura. Mënyra se si është menaxhuar dhe drejtuar shoqëria lë hapësirë për përmirësim të vazhdueshëm.

Në përgjithësi mekanizmi i llogaridhënies nuk ka funksionuar si duhet. Rëndësi më të madhe duhet ti kushtohet marrjes së vendimeve nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, duke siguruar paraprakisht asistencën e nevojshme profesionale, administrative dhe juridike.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe i kontrollit në këtë shoqëri nuk është i zhvilluar sa duhet. Kontrollat e brendshme, nuk kanë qenë efektive në arritjen e qëllimeve të përcaktuara, ndërsa mënyra se si janë kryer procedurat e prokurimit ka vënë në rrezik arritjen e vlerës së duhur për paratë e shpenzuar.

REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për iniciimin e analizës së situatës të aseteve të shoqërisë, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative për regjistrimin e pronës së pakësuar nga legalizimi i paligjshëm brenda vijave kufizuese të pronës së Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1 Tiranë.

-Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranohet oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

1. Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike;

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente;

3. Nga Drejtori i Përgjithshëm i RSU1 t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt;

4. Nga titullari i AK të merren masat që në urdhrin e ngritjes së KVO, kryetari i KVO të jetë ndër zyrtarëve më të lartë drejtues dhe të eliminohet detyra e mbikëqyrësit e procedurave, për arsye se një detyrë e tillë nuk parashikohet në RrPP.

5. Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor;

6. Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të marrin masa që përcaktimi i audituesve ligjorë për certifikimin e pasqyrave financiare të bëhet përmes një konkurrimi të hapur, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve të shoqërisë.

-Këshilli Mbikëqyrës, të fillojë bashkëpunimin me Bashkinë e Tiranës, për strehimin në banesat sociale të familjarëve të cilët kanë zënë 4 godinat e shoqërisë, me qëllim lirim të këtyre godinave për studentët.

-Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Studentore, të marrin masa në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Tiranë, për pajisjen me kontrata individuale furnizimi me ujë, për familjarët të cilët kanë zënë 4 godinat e shoqërisë, me qëllim uljen e kostove të shoqërisë.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për ndjekjen e procedurave ligjore dhe miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve nga Ministri i MZHETTS.

-Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të shmangë praktikën e evidentuara më mangësi dhe të zhvillojë aktivitetin e tij sipas kërkesave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” i ndryshuar; Udhëzimit të ministrit të METE nr. 318, datë 8.4.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”; si dhe të Statutit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA, Tiranë.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për miratimin e Statutit të shoqërisë, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.



-Nga titullari i shoqërisë RSU1, të merren masa për për përcaktimin e limitit të veprimeve nëpërmjet arkës dhe kryerjen e këtyre veprimeve në përputhje me ligjet, udhëzimet dhe aktet në fuqi.

1. Shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Tiranë, të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave, të caktojë nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues.

2. Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, shoqëria të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

3. Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, shoqëria krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në këtë njësi. Gjithashtu, shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

4. Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masa për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

-Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të marrë masa për pajisjen e Departamentit të Planifikimit Financiar dhe Buxhetit, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit.

-Nga komisioni i blerjeve të vogla, të merren masa që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen të argumentuara dhe sipas nevojave reale të shoqërisë, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 95,388 lekë, nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave; ..., ... dhe..., si dhe anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesës ..., ... dhe ..., për skualifikimin e padrejtë të ofertës së operatorit ekonomik me ofertën më të ulët në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërtimi dhe marangozi”, viti 2016.

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 416,539 lekë, nga operatori ekonomik “...” SHPK, për vonesa në dorëzimin e mallit, sipas afateve të përcaktuara në kontratën nr. 371, datë 21.08.2015.

C. GJETJE ME IMPAKT NEGATIV NË REALIZIMIN E TË ARDHURAVE TË SHOQËRISË DHE TË SHTETIT

-Drejtorja e Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për inicimin e një kontrolli të plotë tatimor, me qëllim saktësimin e detyrimeve tatimore që shoqëria i detyrohet Buxhetit të Shtetit dhe saktësimin e shmangies fiskale të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA, Tiranë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1” SHA, TIRANË”

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit të paligjshëm nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme dhe **përbëjnë afërsisht 25% të të gjithë të ardhurave vjetore të shoqërisë**. Të merren masa që proceset gjyqësore, ku është palë administrata e RSU1 Tiranë, të ndiqen në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të kërkojnë zgjidhjen e menjëhershme ligjore në Bashkinë Tiranë dhe të vazhdojnë të insistojnë në MAS, për të parashikuar fonde nga buxheti i shtetit për të përballuar detyrimin e trashëguar ndër vite për z. ... me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm i shoqërisë, i cili vetëm për periudhën objekt auditimi, i ka kushtuar shoqërisë pagesa në **vlerën 3,587,018 lekë**.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe ta harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, proceduriale dhe ligjore në këtë drejtim, si dhe duke patur parasysh kërkesat e Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë nr. 7, datë 24.04.2003 “Për kriteret e planifikimit dhe përdorimit të subvencionit buxhetor në Ndërmarrjet e Trajtimit të Studentëve dhe Ndërmarrjet e Konvikteve dhe Mencave të Studentëve”.

-Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të shqyrtojë vlerën **8,377,612 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesa për interesa dhe penaltitete për deklarim e pagesë të vonuar të sigurimeve shoqërore, penaltitete për Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1” SHA, Tiranë dhe Buxhetin e Shtetit përbën efekt financiar negativ.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT